



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

MIRATOHET

KRYETAR I KESHILLIT

Z. EDI RAMA

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Znj. BELINDA BALLUKU

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Znj. Silvana Sotiri

Miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak

Nr. 28 Datë 26.05.2020

Kryetar i Bashkisë

Z. Pali Kolefski

PLANI I PËRGJITHSHËM VENDOR I BASHKISË PUSTEC

PLANI I ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.1, Datë 28.07.2020

DPKZHT: Z. VASKA ARGJIRI

KONSULENT: "GAIA S.A. MELETON", Dimitrios Mamounis, Nr. Liç.554



PËRMBAJTJA

1. PLANI I PROPOZUAR I PERDORIMIT TE TOKËS	5
1.1. Strukturim i territorit sipas pesë sistemeve territoriale	5
1.2. Strukturim i territorit në zona dhe njësi strukturore	7
1.3. Propozim i përdorimit të tokës sipas kategorive dhe nënkategorive	11
1.4. Zonat e rëndësisë kombëtare	14
1.5. Zonat kryesore të zhvillimit ekonomik dhe urban	17
1.6. Shpërndarja e popullësisë në territor & Plani i strehimit	18
1.7. Njësitë që i nënshtrohen hartimit të PDV-së	20
1.8. Mënyra e ndërhyrjes në territor	23
1.9. Instrumentet për drejtimin e zhvillimit.....	25
2. PLANI I SHËRBIMEVE DHE INFRASTRUKTURAVE PUBLIKE.....	26
2.1. Infrastruktura e transportit.....	26
2.2. Infrastruktura inxhinierike	28
2.3. Shërbimet sociale.....	31
3. PLANI I MBROJTJES SË MJEDISIT	35
3.1. Trajtimi i ndikimeve në ajër	35
3.2. Trajtimi i ndikimeve në ujëra	36
3.3. Trajtimi i ndikimeve në peizazh	36
3.4. Parashtrimi i varianteve për zgjidhje të problematikes të hotspot-eve	37
3.5. Parashikimet për shtimin dhe/ose zgjerimin e hapësirave të gjelbra	38
3.6. Konkluzion për trajtimin e ndikimeve mjedisore të propozimeve të Planit	39
4. PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E PPV-SË.....	40
4.1. Plani i Veprimit.....	40
4.1.1. Zhvillim i njësive strukturore sipas prioritetit	40
4.1.2. Infrastruktura publike	40
4.1.3. Projekte prioritare / Pilote të zhvillimit	42
4.2. Plani i investimeve kapitale.....	53
4.3. Ndryshimet në kuadrin ligjor dhe administrative në nivel vendor	63
4.4. Indikatorët e monitorimit për zbatimin të PPV-së	64
4.5. Evidentimi i faktorëve që mund të çojnë në nevojën e rishikimit të PPV-së.....	67
5. KAPACITETI INSTITUCIONAL	68
5.1. Vlerësimi i shpejtë i kapaciteteve institucionale të Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit Zhvillimit të Territorit (DPKZHT) të Bashkisë	68
5.2. Zhvillimi i kapaciteteve dhe marrëveshjet e zbatimit	77
ANEKS	86
1. DIREKTIVAT/TOR PËR PLANIN SEKTORIAL	86



2. DIREKTIVAT/TOR PËR PDV	89
3. RAPORTI I DËGJESËS PUBLIKE	110
4. RAPORTI I FORUMIT I BASHKËRENDIMIT PËR PLANIFIKIMIN NË NIVEL VENDOR.....	113



1. PLANI I PROPOZUAR I PERDORIMIT TE TOKËS

1.1. Strukturim i territorit sipas pesë sistemeve territoriale

Strategjia territoriale e propozuar është synimi për zhvillimin e qëndrueshëm të Bashkisë dhe që do të realizohet përmes një sërë projektsh strategjik të propozuara dhe pilot (plan i veprimit), riorganizuar formimin ekzistues hapësinor. Kjo sjell si rezultat modifikimin e kufizuar dhe specifik në vende konkrete të gjithë sistemeve territoriale (bujqësore, natyrore, urbane dhe infrastrukturore). Ndryshime të identifikuara në zonën e përdorimit Tradicional, siç përcaktohet nga Plan i Menaxhimit të Parkut Kombëtar dhe sidomos në zonat përreth vendbanimeve. Ndryshimet dhe modifikimet konsiderohen të dëshirueshme dhe të domosdoshme pasi ato synojnë:

- përmirësimin e kushteve dhe sigurimin e një standardi të lartë jetese dhe pune për të gjithë popullsinë, e cila pritet të rritet gjatë 15 viteve të ardhshme (shih Tabelën 1.1.1);
- sigurimin e infrastrukturës teknike të nevojshme për heqjen ose zvogëlimin e situatave negative që janë krijuar dhe për përmirësimin e situatës ekzistuese;
- shmangjen e konflikteve dhe sigurimin e qëndrueshmërisë së përdorimit të tokës;
- forcimin dhe pasurimin e aktiviteteve ekonomike;
- rritjen e mbrojtjes së mjedisit natyror, kulturor dhe të peizazhit.

	Popullsia 2018*	Parashikimi 2023	Parashikimi 2033
PUSTEC	3,290	3,340	3,493

* vlerësimi nga PPV

Tabela 1.1.1: Parashikimi i popullsisë për Bashkinë e Pustecit

Shpërndarja e pesë sistemeve dhe ndryshimet e detajuara nga një sistem territorial në një tjetër në territorin e Bashkisë janë paraqitur në tabelat në vijim.

Sistemi Territorial	Sipërfaqja eksistuese	Sipërfaqja e vlerësuar pas aplikimit të projekteve të propozuara	Përqindja e ndryshimit
Sistemi natyror	15,629 (72.33%)	15,677 (72.55%)	0.31%
Sistemi ujqor	4,518 (20.91%)	4,518 (20.91%)	-
Sistemi bujqësor	1,282 (5.93%)	1,210 (5.60%)	-5.63%
Sistemi urban	154 (0.71%)	173 (0.80%)	12.34%
Sistemi infrastrukturor	26 (0.12%)	31 (0.14%)	21.84%

Tabela 1.1.2: Ndryshim i sistemeve territoriale (sipërfaqe në Ha)



Sistemi territorial eksistues	Sistemi territorial i propozuar	Sipërfaqja (Ha)	Boniteti i sistemit bujqësor	Vërejtje	
Bujqësor	Infrastrukturor	2.41		Ndryshimi rezulton nga zgjerimi i rrugëve ekzistuese dhe hapja e rrugëve të reja.	
		0.44	V		
		1.97	VI		
	Natyror	63.55	0.72	IV	Ndryshimi rezulton nga krijimi i një zone mbrojtëse të liqenit dhe i përronjve dhe krijimi e plazheve.
			5.53	V	
			57.30	VI	
			25.59		
	Urban		1.55	IV	Ndryshimi rezulton nga racionalizimi i kufijve të zonave urbane dhe përcaktim i zonave të reja për strehimin, turizmin, rekreacionin.
			3.88	V	
			20.16	VI	
Natyror	Bujqësor	10.55		Ndryshimi rezulton nga krijimi i zonave për ushtrimin e aktiviteteve bujqësore (kryesisht atyre blegtorale) dhe infrastrukturës.	
	Infrastrukturor	3.16		Ndryshimi rezulton nga zgjerimi i rrugëve ekzistuese dhe hapja e rrugëve të reja.	
	Urban	4.49		Ndryshimi rezulton nga racionalizimi i kufijve të miratuara të zonave urbane.	
Urban	Bujqësor	8.73		Ndryshimi rezulton nga racionalizimi i kufijve të zonave urbane (bëhet fjalë kryesisht për sipërfaqe të instalimeve blegtorale).	
	Natyror	2.17			
	Infrastrukturor	0.22			
Infrastrukturor	Natyror	0.30		Ndryshimi rezulton nga rehabilitimi i venddepozitimit të mbetjeve.	

Tabela 1.1.3: Ndryshimet e detajuara i sistemeve territoriale

Do të shënohet një rritje e konsiderueshme e sistemit urban dhe infrastrukturor, kundrejt atij të sistemit bujqësor dhe sistemit natyror. Bashkia ka nevojë për infrastrukturë moderne, e cila sot mungon plotësisht. Gjithashtu, vendbanimet e saj duhet të pajisen në mënyrë të përshtatshme për t'u përgjigjur rolit të tyre të ri dhe të shumëfishtë brenda një zone komplekse dhe të veçantë. Në veçanti, ndryshimet i atribuohen:

- vendosje e infrastrukturës sociale të re apo/ose zgjerimi i infrastrukturës ekzistuese sociale (p.sh. qendra kulturore, terrene sportive). Fillimisht do të realizohet një përpjekje për të shfrytëzuar zonat e lira urbane apo zona që do të rezultojë pas heqjes së funksioneve të papajtueshme të tilla si ato të objektet blegtorale
- organizimi i aktiviteteve dhe infrastrukturave të reja ekonomike, të tilla si tregu i produkteve vendore
- përmirësimi dhe organizimi i plazhit

- krijimi i infrastrukturës teknike, të tilla si impiante të trajtimit alternativ të ujërave të zeza, stacion i transferimit të tyre
- restaurimi i hapësirës së grumbullimit të mbetjeve dhe rikthimi i kësaj hapësire në gjendjen e mëparshme natyrore, ku nuk do të lejohet ndërtimi
- parashikimi i hapësirës për krijimin e një kalimi kufitar dhe ndërtimi i një rruge qasjeje në të
- rikonstruksioni i rrugëve të ndryshme që lidhin vendbanimet
- racionalizimi i kufijve tashmë të miratuara të zonave urbane sipas Vendimit të KKT nr.5, datë 29.12.2014 si edhe përcaktim i zonave të reja (të pastrukturuara ose me ndërtim të dendur) për pritjen e aktiviteteve të reja turistike, rekreative dhe shërbimeve mbështetëse dhe strehim.

Ndryshimet sasimore negative në sistemin bujqësor kompensohen nga ndryshimet cilësore që do të bëhen në menaxhimin dhe shfrytëzimin e tokës së tij. Përveç kësaj, shumë nga ndërhyrjet e propozuara që shkaktojnë ndryshime do të kenë përfitime si për sistemin natyror ashtu edhe për atë bujqësor (p.sh. fermat e organizuara të bagëtive, infrastruktura e mbeturinave dhe mbetjeve, promovimi i riciklimit dhe transporti i butë). Konvertimi i zonave të sistemit bujqësor ka të bëjë me shumicën dërrmuese (afërsisht 98%) të zonave me bonitet V dhe VI. Në çdo rast, konvertimi i tokës bujqësore i secilës kategori do të bazohet në legjislacionin në fuqi.

Theksohet se çfarëdo ndryshim nuk bie ndesh me Planin e miratuar të Menaxhimit të Parkut Kombëtar të Prespës. Gjithashtu, shënohet se në dukje disa projekte mbeten të kufizuara dhe nuk merret parasysh efekti i zbatimit të tyre në sistemet territoriale. Të tilla janë projekte lokale, zakonisht të madhësive të vogla (p.sh. shpime, depozita uji, rezervuare), specifikimet teknike të cilave nuk janë finalizuar dhe si rrjedhim lokalizimi i tyre hapësinor nuk është i mundur. Vendndodhjet e sakta dhe hapësirat e projekteve teknike do të përcaktohen nga studime më specifike.

Në përgjithësi, aktivitetet përgjatë zonës bregdetare, duke marrë parasysh treguesin e zhvilluar të funksionit breglumor (shorezone functionality index -SFI- sipas projektin "Ruajtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i biodiversitetit në liqenet e Prespës, Ohrit dhe Shkodrës" - CSBL) duhet të përqëndrohen në masat e restaurimit, siç është mbjellja e pemëve duke përdorur specie që janë vendas në zonë, duke zvogëluar kullotjen në mënyrë që të lejojë restaurimin natyror dhe sigurimin e mirëmbajtja / mbrojtja e kallamishteve ekzistues.

Duke e konsideruar turizmin si sektorin kryesor të zhvillimit, të gjitha strukturat turistike duhet të planifikohen në atë mënyrë që të sigurojnë asgjësimin e duhur të mbeturinave shtesë të krijuara si rezultat i rritjes së numrit të vizitorëve.

1.2. Strukturim i territorit në zona dhe njësi strukturore

Ndarja e territorit në zona

Zonat sipas VKM nr. 686, datë 22.11.2017, "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit" ndryshuar, sipas VKM nr. 232, dt. 17.04.2019, formojnë një entitet të vetëm që analizohet në nivel të kategorisë së përdorimit të tokës. Brenda kufijve të një zone, lejohen një ose më shumë kategoritë të përdorimit të tokës që i përkasin të njëjtit sistem territorial. Kodi i çdo zone duhet të jetë unik, i dallueshëm dhe në përputhje me Shtojcën II të vendimit të lartpërmendur, kodi i zonës duhet të



përfshijë emrin e Bashkisë, pa qenë e nevojshme të duket i gjithë emri, por vetëm dy shkronjat e saj (prsh. Pustec-PS), kodi i sistemit territorial dhe kodi i kategorisë së përdorimit të tokës, i cili mbizotëron ndaj të tjerëve brenda kësaj zone dhe numri rendor i zonës. Kodet e përdorura të sistemeve territoriale dhe kategorive për këtë emërim të zonave janë siç përcaktohen nga Shtojca I e VKM nr. 686, dt. 22.11.2017, "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit" e ndryshuar, sipas VKM nr. 232, dt. 17.04.2019. Për shembull, një zonë e cila i përket sistemit urban, në të cilin kategoria kryesore e përdorimit të tokës është banimi do të ketë kod: PS_UB_A_1.

Për përcaktimin e zonave në Bashkinë e Pustecit u morrën parasysh, përveç kritereve të përmendura në nenin 76, si edhe:

- Shtrirja dhe gjendja e sistemeve ekzistuese të tokës, përdorimet ekzistuese të tokës dhe aktivitetet.
- Veprimtaria aktuale ekonomike dhe specializimi.
- Plani strategjik i propozuar me objektivat për mbrojtjen, rritjen dhe menaxhimin e qendrueshëm të zonave natyrore dhe bujqësore, të burimeve ujore dhe të territorit urban.

Në territorin e Bashkisë dallohen zonat e mëposhtme për çdo sistem territorial:

Zonat e Sistemit Urban, përfshijnë të gjitha zonat e banuara që rrethohen nga vija e gjelbër si dhe zonat turistike. Këto zona kanë një ose më shumë njësi. Kështu, në varësi të njësive të cilës i takon një zonë, propozohen zona për banim, shërbime sociale dhe argëtimi, ekonomike, arsimit, shëndetësi, infrastrukturës inxhinierike etj. Në sistemin urban ekzistojnë zona të kategorive të ndryshme. Ekzistojnë zona me karakter specifik siç janë zonat ushtarake ose zonat në të cilat përfshihen monumentet kulturore, ose shërbime shëndetësore, si dhe zona me karakter të përzier të cilat përmbajnë aktivitete të lidhura me veprimtarinë ekonomike dhe profesionale në të cilat ndodhen ndërmarrje dhe shërbime industriale etj.

Konkretisht në Bashki gjenden zonat e mëposhtme:

- Zonë me përdorim kryesisht banim, me kod PS_UB_A_1,2, 3 etc.
- Zonë me karakter të përzier, me kode PS_UB_IS_1, 2, 3 etc., PS_UB_S_1, 2, 3 etc., PS_UB_SHA_1, 2, 3 etc.
- Zonë me karakter specifik, me kode PS_UB_V_1, 2, 3 etc., PS_UB_M_1, 2, 3 etc.

Zonat e Sistemit Infrastrukturor, përfshijnë zona që propozohen për vendosjen e infrastrukturës inxhinierike për t'i shërbyer nevojave të banorëve dhe mbështetjes ekonomike të Bashkisë. Sistemi

Infrastrukturor i bashkisë përbëhet nga dy zona të infrastrukture:

- Zonë e infrastrukturës së transportit, me kod PS_IN_INT_1, 3.
- Zonë e infrastrukturës së menaxhimit të mbetjeve, me kod PS_IN_IMB_2.

Zonat e Sistemit Bujqësor, të cilat përfshijnë zonat që kultivohen në Bashki. Bëhet fjalë për zona pjellore të Bashkisë të cilat mbështesin ekonominë vendase. Propozohen aktivitete ekonomike në ndihmë të bujqësisë dhe të blegtorisë, agroturizmit dhe infrastrukturë teknike dhe strehimi me kushte të caktuara ndërtimi në tokë bujqësore duke synuar mbrojtjen maksimale dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të tokës bujqësore. Në Bashki ekzistojnë katër kategori zonash:

- Zonë me karakter bujqësor, banim dhe aktivitete ekonomike bujqësore, me kod PS_B_BA_1, 2, 3 etc.
- Zonë me karakter bujqësor, aktivitete ekonomike bujqësore dhe infrastrukturë mbështetëse, me kod PS_B_EB_1, 2, 3 etc.
- Zonë me karakter bujqësor dhe aktivitete ekonomike bujqësore, me kod PS_B_B_1, 2, 3 etc.

- Zonë me karakter bujqësor dhe infrastrukturë mbështetëse, me kod PS_B_IB_1, 2, 3 etc.

Zonat e Sistemit Natyror, përfshijnë zonat natyrore të Bashkisë, si pyjet, kullotat, shkurret dhe zonat të cilat janë të përshtatshme për zhvillimin e strukturave akomoduese dhe argëtuese në kontekstin e ekoturizmit. Në Bashki ka dy kategori zonash:

- Zonë e tokës natyrore, me kod PS_N_N_1, 3, 4.
- Zonë e plazheve, me kod PS_N_NAR_2.

Zonat e Sistemit Ujor, përfshijnë zonat ujore të Bashkisë, si liqenet, lumenjtë, burimet dhe përrrenjtë. Në sistemin ujor ekziston një kategori zone:

- Zonë e aseteve ujore, me kod PS_U_U_1, 2, 3 etc.

Ndarja e territorit në njësi

Zonat e lartpërmendura dallohen në një ose më shumë njësi, që i korrespondojnë një sistemi të vetëm territorial. Ndarja e territorit në njësi është kryer në bazë të kriterëve si p.sh. përdorime, zhvillimi i synuar, etj. Në çdo njësi përcaktohen një ose më shumë kategori përdorimesh të tokës (përdorim i përzier) sipas nënkategorive/ funksioneve përkatëse.

Kodi për çdo njësi strukturore do të duhet të jetë unik dhe i dallueshëm. Sipas përcaktimeve nga Agjensia Kombëtare e Planifikimit të Territorit kodi i njesive strukturore sipas të cilave do të ndahen zonat është: "Kodi i bashkisë_Kodi i Sistemit_Kodi i Nënkatëgorisë së Përdorimit të Tokës_Nr i zonës/Nr i njësisë". Kodet e nënkategorive të përdorimit të tokës të cilat janë përdorur për emërtimin e njesive përcaktohen nga Shtojca I e VKM nr.686 dt. 22.11.2017, "Miratimi i rregullores së planifikimit të territorit" e ndryshuar, sipas VKM nr. 232, dt. 17.04.2019. Për shembull, një njësi e cila i përket sistemit urban ku kategoria themelore e zonës të së cilës i përket është banimi dhe nënkategoria kryesore është banimi me shërbimedhe zona në të cilën përket është zona 1, do të marrë kod: PS_UB_A2_1/1.

Sistemi Urban përfshin të gjitha zonat e banuara. Bëhet fjalë për zonat që rrethohen nga Vija e Gjelbër si dhe zonat turistike. Kështu, në varësi të njësisë së cilës i përket një zonë, propozohen aktivitetet qëndrore të qytetit, të banimit, të shërbimeve, aktiviteteve sociale dhe rekreative, dhe ekonomike, të arsimit, të shëndetit, të kulturës, të hapësirave të gjelbëruara, të infrastrukturës inxhinierike, etj. Në sistemin urban bëjnë pjesë 3 kategori zonash të cilat grupohen në kategori njësi si më poshtë:

«Zonë me karakter të përzier» kjo zonë përbëhet nga 7 kategori njësie të cilat paraqesin një karakter të përzier. Përdorimet më të rëndësishme që hasim në këtë zonë janë banimi, përfshirë shërbimet që i shërbejnë nevojave të përditshme të banorëve, hapësira publike dhe sportive, objekte të arsimit primar dhe mirëqenies sociale, shërbime publike dhe objekte fetare, aktivitete tregtare, objekte rekreacioni dhe akomodimi. Në njësitë në të cilat janë propozuar për të funksionuar si zona shërbimesh propozohen si aktivitete prodhuese jo shqetësuese. Në këto zona gjenden njësi me kode:

- PS_UB_A2_nr.zone/nr.njësie,
- PS_UB_AR1_nr.zone/nr.njësie,
- PS_UB_AR2_nr.zone/nr.njësie,
- PS_UB_AR3_nr.zone/nr.njësie,
- PS_UB_IS2_nr. zone/nr.njësie,
- PS_UB_IS6_nr. zone/nr.njësie,
- PS_UB_S1_nr. zone/nr.njësie.



«Zonë me karakter *specifik*» përbëhet nga njësi dhe secila prej tyre ka një karakter të veçantë. Nënkatëgoritë kryesore të përdorimeve të tokës që gjenden në këtë zonë janë të përbashkëta dhe terrene sportive, njësi të arsimit primar, rekreative dhe të akomodimit, objekte varreza dhe monumente të kulturës. Në këto zona gjenden njësi me kode:

- PS_UB_AS1_nr.zone/nr.njësie,
- PS_UB_AS2_nr.zone/nr.njësie,
- PS_UB_M1_nr.zone/nr.njësie,
- PS_UB_SH1_nr.zone/nr.njësie,
- PS_UB_V1_nr.zone/nr.njësie,

Sistemi infrastrukturor përbëhet nga 2 kategori të zonave të organizuara në njësi si më poshtë:

«Zonë e infrastrukturës të transportit» është 1 kategori njësi dhe përfshin përdorime që lidhen me infrastrukturën e transportit rrugor dhe ujor. Në këto zona gjenden njësitë me kode:

- PS_IN_INT1_nr. zone/nr. njësi.
- PS_IN_INT3_nr. zone/nr. njësi.

«Zonë e infrastrukturës së menaxhimit të mbetjeve» përfshin përdorime që lidhen me infrastrukturën e depozitimit dhe transferimit të mbetjeve. Në këto zona gjenden njësi me kod PS_IN_IMB2_1/1.

Sistemi Bujqësor përbëhet nga katër kategori zonash bujqësore. Këto zona përfshijnë zona që kultivojnë dhe mbështesin ekonominë vendase. Janë propozuar përdorime që lidhen me aktivitetet bujqësore të kombinuara me banimin, infrastrukturën inxhinierike, si dhe njësitë për përpunimin e produkteve bujqësore dhe projektet e rikuperimit të tokës që synojnë mbrojtjen maksimale dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të tokës bujqësore. Zonat e sistemit bujqësor ndahen në njësi si më poshtë:

«Zonë me karakter bujqësor, banim dhe aktivitete ekonomike bujqësore» kjo zonë përfshin një kategori njësi, me përdorimin mbizotërues banimin, bujqësi dhe infrastrukturën e nevojshme mbështetëse për ekonominë rurale. Në këto zona gjenden njësitë me kode:

- PS_B_BA1_nr.zone/nr. njësi,

«Zonë me karakter bujqësor, aktivitete ekonomike bujqësore dhe infrastrukturë mbështetëse» kjo zonë përfshin njësi, me përdorime mbizotëruese që mbështesin aktivitetet ekonomike rurale dhe infrastrukturën rurale si rrjetet e ujitjes dhe kullimit dhe agroturizmi. Në këto zona gjenden njësi me kode:

- PS_B_EB1_nr. zone/nr. njësi.
- PS_B_EB2_nr. zone/nr. njësi.

«Zonë me karakter bujqësor dhe aktivitete ekonomike bujqësore» është kategorizuar në 1 kategori njësi e cila ka përdorim kryesor tokëne me qëllim mbështetjen e aktiviteteve ekonomike rurale. Në këto zona gjenden njësi me kod PS_B_B1_nr. zone/nr. njësi, PS_B_B2_nr. zone/nr. njësi.

«Zonë me karakter bujqësor dhe infrastrukturë mbështetëse» kjo zonë përfshin një kategori njësi, e cila përfshin infrastrukturën e nevojshme për mbështetjen e kulturave bujqësore. Në këto zona gjenden njësi me kod PS_B_IB3_nr. zone/nr. njësi.

Sistemi Natyror përfshin 2 kategori zonash të cilat janë të organizuara në pesë kategori njësi. Kategorizimi i njësisë është realizuar me qëllim menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve dhe zonave me vegetacion të ulët dhe grupohen në kategori njësi si më poshtë:



«Zonë e tokës natyrore» është kategorizuar në dy kategori njësishe, përdorimet e të cilëve mbizotëruese janë pyjet, kullotat, shkurret dhe tokë pa fruta. Në këto zona gjenden njësi me kode:

- PS_N_N1_nr.zone/nr.njësie,
- PS_N_N3_nr.zone/nr.njësie,
- PS_N_N4_nr.zone/nr.njësie.

«Zonë e plazheve» është kategorizuar në një kategori njësi. Kjo zonë lejon aktivitete sociale dhe aktivitete rekreative (si hotelet, kampet, fermat e ekoturizmit, infrastrukturat e veçanta turistike nën liçensimin mjedisor). Në këto zona gjenden njësi me kode:

- PS_N_NAR2_nr. zone/nr. njësie.

Sistemi i ujit përfshin një zonë që kategorizohet në dy kategori njësi të cilat kanë si përdorim liqene, lumenj, përranj dhe burime. Në këto zona gjenden njësi me kode:

- PS_U_U4_nr. zone/nr. njësie,
- PS_U_U6_nr.zone/nr. njësie.

1.3. Propozim i përdorimit të tokës sipas kategorive dhe nënkategorive

Bazuar në neni 76 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 686 dt. 22.11.2017, "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit" e ndryshuar, sipas VKM nr. 232, dt. 17.04.2019, zona është pjesë përbërëse e sistemit territorial që detajohet në nivelin e kategorisë së përdorimit të tokës dhe mund të përmbajë disa kategori përdorimi toke, pjesë të një sistemi të vetëm territorial. Gjatë procesit të zonimit do të përcaktohen kategoritë përdorimit të tokës, që do të lejohen në secilën zonë, një ose më shumë, (përdorim të përzier). Zonimi merr parasysh, sipas nenit 79, kriteret si më poshtë:

- Harmonizimin e përdorimeve të tokës, brenda një zonë ose midis zonave fqinjë.
- Ruajtjen dhe përmirësimin e karakterit të një zonë dhe harmonizimin e interesave publike dhe private në zhvillimin e saj.
- Përmirësimin e lëvizshmërisë, rregullimin e trafikut dhe sigurimin e aksesit të barabartë për të gjithë.
- Zhvillimin e qëndrueshëm të gjithë territorit.

Territori i Bashkisë së Pustecit u nda në zona, ku secila zonë u nda në njësitë përkatëse. Në çdo njësi do të lejohet një ose disa kategori bazë e përdorimit të tokës (përdorim të përzier). Të gjitha kategoritë bazë të përdorimit të tokës, prej të cilave do të zgjidhen, parashikohen në nenin 80 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr 686, dt. 22.11.2017 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit" e ndryshuar, sipas VKM nr. 232, dt. 17.04.2019 me kodet dhe përmbajtjen përkatëse si më poshtë:

- Kategoria "Banim (A)", përfshin territore dhe struktura ku kryhen funksione dhe aktivitete të banimit.
- Kategoria "Shërbime (S)", përfshin territore dhe struktura ku kryhen funksionet dhe aktivitetet e shërbimeve tregtare, akomoduese dhe zyre.
- Kategoria "Industri ekonomi (IE)", përfshin territore dhe struktura ku kryhen funksionet dhe aktivitetet e industrisë së lehtë e të rëndë, si dhe funksione ekonomike komplekse.



- Kategoria **“Institucione (IS)”**, përfshin territore dhe struktura ku kryhen funksionet dhe aktivitetet e administrimit publik, shërbimeve publike, sociale, diplomatike, financiare dhe fetare.
- Kategoria **“Arsim (AS)”**, përfshin territore dhe struktura ku kryhen funksionet dhe aktivitetet e arsimit në të gjitha nivelet: parashkollor, i ulët, i mesëm dhe i lartë, sipas legjislacionit përkatës.
- Kategoria **“Shëndetësi (SH)”**, përfshin territore dhe struktura ku kryhen funksionet dhe aktivitetet e shërbimit ambulator dhe spitalor, sipas legjislacionit përkatës.
- Kategoria **“Aktivitete shoqërore dhe argëtimi (SHA)”**, përfshin territore dhe struktura në shërbim të aktiviteteve kulturore e sportive, parqe dhe hapësira publike.
- Kategoria **“Monumente kulturore (M)”**, përfshin territore dhe struktura, pjesë të trashëgimisë kulturore dhe historike.
- Kategoria **“Zona ushtarake (ZU)”**, përfshin territore dhe struktura ku kryhen funksionet dhe aktivitetet ushtarake, sipas legjislacionit përkatës.
- Kategoria **“Varreza (V)”**, përfshin territoret dhe strukturat në shërbim të varrezave.
- Kategoria **“Infrastrukturë transporti (INT)”**, përfshin infrastrukturat e transportit rrugor, hekurudhor, ujqor, ajror dhe multimodal; rrjetet e përbëra nga linjat, stacionet dhe struktura të tjera në shërbim të tyre.
- Kategoria **“Infrastrukturë energjitike (IEN)”**, përfshin infrastrukturat e prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike nga burime hidrike, lëndë djegëse, eolike e diellore, si dhe infrastrukturat e gazifikimit, përfshirë linjat dhe strukturat mbështetëse.
- Kategoria **“Infrastrukturë telekomunikacioni (ITK)”**, përfshin rrjetet, antenat dhe strukturat që mundësojnë telekomunikacionin.
- Kategoria **“Infrastrukturë e ujësjellës – kanalizimeve (IUK)”**, përfshin rrjetet dhe strukturat në shërbim të furnizimit me ujë, kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të zeza.
- Kategoria **“Infrastrukturë menaxhimi mbetjesh (IMB)”**, përfshin strukturat në shërbim të grumbullimit, depozitimit dhe trajtimit të mbetjeve të ngurta.
- Kategoria **“Bujqësi (B)”**, përfshin tokat bujqësore me kultura të përhershme apo sezonale bujqësore, si dhe tokat djerrë, sipas legjislacionit përkatës.
- Kategoria **“Infrastrukturë bujqësore (IB)”**, përfshin infrastrukturën në shërbim të aktivitetit bujqësor që mundëson vaditjen dhe kullimin e tokave bujqësore.
- Kategoria **“Ekonomi bujqësore (EB)”**, përfshin strukturat dhe infrastrukturat në funksion të ekonomisë bujqësore e blegtorale, si dhe shërbimet e agroturizmit.
- Kategoria **“Bujqësi - Banim (BA)”**, përfshin banimin në funksion të aktivitetit bujqësor.
- Kategoria **“Tokë natyrore (N)”**, përfshin territoret natyrore, si: pyje, kullota, livadhe, shkurre e të tjera, të paprekura nga aktiviteti njerëzor.
- Kategoria **“Natyrë dhe argëtim (NAR)”**, përfshin territoret natyrore, infrastrukturat ekologjike në funksion të aktivitetit njerëzor në natyrë, si: parqe, plazhe, shtigje dhe strukturat në funksion të ekoturizmit.
- Kategoria **“Ujëra (U)”**, përfshin të gjithë trupat ujorë: dete, laguna, kënetë, liqene, lumenj, përrrenj e burime ujore, sipas legjislacionit përkatës.



Për disa prej kategorive të lartpërmendura u përcaktuan nënkategoritë, të cilat propozojmë të zbatohen në njësitë e formuara nga ky plan, në përputhje me karakterin, veçoritë dhe qëllimin për mbrojtje ose mënyrën e zhvillimit të tyre.

Nënkategoritë, dallojnë në përmbajtjen e tyre, pra, nëse lejohen apo ndalohen disa përdorime të kategorisë bazë apo vendosen disa kufizime. Në tabelën e mëposhtme parashtrihen kategoritë dhe nënkategoritë e përdorimit të tokës të cila lejohen në territorin e bashkisë të Pustecit:

Nr. rendor	Kategori	Nënkategori
1	A.Banim	A2-Banim dhe Sherbime
2	SHA.Aktivitete Shoqerore & Argetimi	AR1-Hapesira Publike
		AR2-Aktivitete Kulturore
		AR3-Aktivitete Sportive
3	AS.Arsim	AS1-Arsim Parashkollor
		AS2-Arsim i Ulet
		AS3-Arsim i Mesem
4	B.Toke Bujqesore	B1-Kultura te Perhershme
		B2-Kultura Sezonale
5	BA.Bujqesi + Banim	BA1-Bujqesi - Banim
6	EB.Ekonomi Bujqesore	EB1-Struktura ne Funkcion te Bujqesise
		EB2-Struktura ne Funkcion te Blegtorise
7	IMB.Infrastruktura Menaxhimi Mbetjesh	IMB2-Depozitim Mbetjesh
8	INT.Infrastruktura Transporti	INT1-Infrastruktura Rrugore
		INT3-Infrastruktura Transporti Ujor
9	IS.Institucione	IS2-Sherbim Publik
		IS6-Institucione Fetare
10	M.Monumente	M1-Monument Kulture
11	N.Toke Natyrore	N1-Pyje
		N3-Livadh
		N4-Shkurre
12	NAR.Natyre dhe Argetim	NAR2-Plazh
13	S.Sherbime	S1-Sherbime Akomodim dhe Argetimi
		S2-Sherbime Tregtare dhe Biznesi
14	SH.Shendetesi	SH1-Sherbim Ambulator
15	U.Ujera	U4-Liqen
		U6-Perrua
16	V.Varreza	V1-Varreze

Tabela 1.3.1: Shpjegimi i kodevetë përdorura për nënkategoritë

Më konkretisht nënkategoritë e lartpërmendura janë të shpërndara në territorin e Bashkisë si më poshtë:

- Njësitë me nënkategori kryesore A2-Banim dhe Sherbime, S1-Sherbime Akomodim dhe Argetimi, S2-Sherbime Tregtare dhe Biznesi gjenden kyesisht brenda zonave urbane të bashkisë.



- Njësitë me nënkategori kryesore AR1-Hapesira Publike gjenden në qendrën e Pustecit dhe përgjatë rrugës nacionale SH79 në afërsi me vendbanimet Goricë e Vogël dhe Goricë e Madhe.
- Njësitë me nënkategori kryesore AR2-Aktivitete Kulturore gjenden në qendrën e Pustecit.
- Njësitë me nënkategori kryesore AR3-Aktivitete Sportive gjenden në afërsi me vendbanimet e Pustecit, Lajthizës, Goricës së Vogel.
- Njësitë me nënkategori kryesore AS1-Arsim Parashkollor gjenden kyesisht brenda zonave urbane të bashkisë.
- Njësitë me nënkategori kryesore AS2-Arsim i Ulet gjenden në afërsi me vendbanimet e Pustecit dhe Goricës së Vogel.
- Njësitë me nënkategori AS3-Arsim i Mesem gjenden në afërsi me vendbanimin e Pustecit.
- Njësitë me nënkategoritë kryesore B1-Kultura te Perhershme gjenden dhe B2-Kultura Sezonale në tokat bujqësore në afërsi me vendbanimet e Bashkisë.
- Njësitë me nënkategori kryesore BA1-Bujqesi - Banim gjenden në afërsi me vendbanimet e Bashkisë.
- Njësitë me nënkategoritë kryesore EB1-Struktura ne Funkcion te Bujqesise dhe EB2-Struktura ne Funkcion te Blegtorise gjenden në tokat bujqësore afërsi me vendbanimet e Bashkisë.
- Njësitë me nënkategori kryesore IS2-Sherbim Publik gjenden në afërsi me Pustecin dhe me vendbanimet e Goricës të Madhe dhe të Vogël.
- Njësitë me nënkategori kryesore IS6-Institucione Fetare gjenden në afërsi me vendbanimet e Bashkisë
- Njësitë me nënkategori kryesore NAR2-Plazh gjenden në afërsi të vendbanimeve Kallamas, Gollomboc, Goricë e Vogël, Pustec dhe Zaroshkë.

1.4. Zonat e rëndësisë kombëtare

Sipas Ligjit 107/2014 dhe nenit 30 të VKM nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit" e ndryshuar, sipas VKM nr. 232, dt. 17.04.2019, objektet dhe zonat me rëndësi kombëtare në Bashkinë Pustec përfshijnë:

- zonat e mbrojtura dhe monumentet e mjedisit natyrore
- zonat e mbrojtura dhe monumentet kulturore
- burimet ujore
- shërbime publike
- zonat me prioritet për zhvillimin e turizmit
- infrastruktura inxhinierike.

1. Zonat të mbrojtura natyrore:

Në vijim listohen zonat e mbrojtura të mjedisit natyror në territorin e Bashkisë. Territori i Bashkisë të Pustecit i përket Parkut Kombëtar të Prespës (kategoria II) e miratuar me VKM nr. 80, datë 18.02.1999 "Për shpalljen Park Kombëtar të Prespës dhe peisazh i mbrojtur tokësor/ ujqor të Pogradecit". Plani i Menaxhimit të Parkut Kombëtar "Prespa" u miratua me Urdhër nr. 1972,

datë 09.05.2014 të Ministrisë së Mjedisit. Ky mjedis kufizohet direkt me Peisazhin e Mbrojtur të Liqenit të Pogradecit (kategoria V), miratuar me VKM nr. 80, datë 18.02.199.

Dy zonat e mbrojtura të lartpërmendura janë kandidatë për anëtarësim në rrjetin Emerald (respektivisht kodet AL0000003 dhe AL0000019). Gjithashtu, një numër monumentesh natyrore janë shpallur të mbrojtura në Bashki, në bazë të VKM nr.303, dt. 10.05.2019 "Për miratimin e listës së rishikuar, të përditësuar, të monumenteve të natyrës shqiptare". Në tabelën më poshtë janë paraqitur monumentet natyrore të kategorisë III që kanë zonë buferike deri në 200m.

Nr. rendor	Emërtimi	Vrejtje
1	Ishulli i Malligradit	Sipas Ligjit 81, datë 4.5.2017 "Për zonat e mbrojtura", monumentet natyrore i përkasin kategorisë III dhe kanë zone buferike deri në 200m. (neni 17)
2	Vënjat e Kallamasit	
3	Zgavra e Zaverit	
4	Dushqet e Manastirit	
5	Manat e kishës Shen Vangjelizmo - Gollomboc	
6	Pylli i Shen Vasilit - Leska (Lajthizë)	
7	Shkembia "Zarezata Stena" (Shkembia i Prerë) - Zaroshkë	

Tabela 1.4.1: Monumentet natyrore në Bashkinë Pustec (burimi: VKM nr.303, datë 15.05.2019)

2. Monumentet kulturore të Bashkisë së Pustecit janë arkitektonike dhe arkeologjike dhe i përkasin kategorisë I-rë të mbrojtjes (Ligji Nr. 27, datë 2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë"). Paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr. rendor	EMËRTIMI I MONUMENTIT	KATEGORIA	QYTETI / FSHATI	INSTITUCIONI/ NR. VENDIMIT/ DATA
1	Kulla në fshatin Shulin	I	Shulin	Ministria e Arsimit dhe Kulturës / Vendim nr.1886, dt.10.06.1973
2	Kulla në fshatin Goricë	I	Goricë	Ministria e Arsimit dhe Kulturës / Vendim nr.1886, dt.10.06.1973
3	Kulla në fshatin Gollomboç	I	Gollomboç	Ministria e Arsimit dhe Kulturës / Vendim nr.1886, dt.10.06.1973
4	Bazilika Paleokristiane (Rrënojë)	I	Goricë e Madhe (Lagja e Re)	Ministria e Kulturës / Vendim nr.368, dt.09.12.2014
5	Kisha e Shën Mërisë në fshatin Gollomboç	I	Gollomboç-Prespë	Urdhër i Komitetit të Kulturës dhe Arteve nr. 8, dt. 18.12.1987
6	Kisha e Shën Mërisë në Ujdhesën e Maligradit të Prespës pranë fshatit Pustec		Maligrad, Prespë e Madhe	Rektorati i Universiteti Shtetëror të Tiranës / Vendim nr. 6, dt.15.01.1963
7	Shpella e Shën Mërisë në Ujdhesën e Maligradit	I	Maligrad	1. Institutit i Shkencave botuar në Gazetën Zyrtare nr. 95, dt.16.10.1948. 2. Rektorati i Universitetit Shtetëror të Tiranës/ Vendim nr. 6, dt.15.01.1963 3. Ministria e Arsimit dhe Kulturës / Drejtoria e Kulturës / Vendim nr. 68/7, dt. 30.05.1970 4. Ministria e Arsimit dhe Kulturës/ Vendim nr.1886, dt.10.06.1973
8	Kisha e Shën Mitrit në fshatin Bezmisht	I	Bezmisht	1. Ministria e Arsimit dhe Kulturës Drejtoria e Kulturës / Vendim nr. 68/7, dt.30.05.1970



				2.Ministria e Arsimit dhe Kulturës / Vendim nr.1886, dt.10.06.1973
9	Shpella e Shën Mërisë në fshatin Bezmisht	I	Bezmisht	1. Rektorati i Universitetit Shtetëror të Tiranës/ Vendim nr. 6, dt.15.01.1963 2. Ministria e Arsimit dhe Kulturës / Drejtoria e Kulturës / Vendim nr. 68/7, dt.30.05.1970 3. Ministria e Arsimit dhe Kulturës / Vendim nr.1886, dt.10.06.1973

Tabela 1.4.2: Monumentet kulturore në Bashkinë Pustec (burimi: Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore)

Janë aprovuar zonat e mbrojtjes të disa nga monumentet kulturore, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	EMËRTIMI I ZONES	QYTETI / FSHATI	INSTITUCIONI/ NR. VENDIMIT/ DATA
1	Zona e Mbrojtur e Bazilikës Paleokristiane (Rrënojë)	Goricë e Madhe (Lagja e Re)	Ministria e Kulturës/ Vendim nr.368, dt. 09.12.2014
2	Zona e Mbrojtur e Kishës së Shën Mërisë	Gollomboç	Ministria e Kulturës/ Vendim nr.275, dt. 09.10.2014
3	Zona e Mbrojtur e Kishës së Shën Mërisë, Ishulli Maligrad	Ishulli Maligrad, Prespë e Madhe	Ministria e Kulturës/ Vendim nr.274, dt. 09.10.2014
4	Zona e Mbrojtur e Kishës së Shën Mitrit	Bezmisht	Ministria e Kulturës/ Vendim nr.273, dt. 09.10.2014
5	Zona e Mbrojtur e Shpellës së Shën Mërisë	Prespë e Madhe	Ministria e Kulturës/ Vendim nr.272, dt. 09.10.2014

Tabela 1.4.3: Lista e zonave të mbrojtura për monumenteve në Bashkinë Pustec (burimi: Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore)

Për sa i përket propozimeve për pasurimin e rrjetit të monumenteve kulturore dhe zonave me rëndësi kombëtare, propozohet që Ishulli i Maligradit, të shpallet si rrjet arkeologjik e ndërsa Pikturat shkëmbore, të ishullit të Maligradit të shpallen si monumente kulturore. Gjithashtu propozohen gërmime në Bazilikën Paleokristiane sepse në mbetjet arkeologjike në fshatin Kallamas janë zbuluar gjurmë vendbanimesh që nga periudha e neolitit (pjesë poqesh apo gurësh të përpunuar), duke dëshmuar për lashtësinë e këtij vendbanimi.

- Burimet ujore përfshijnë Liqenin e Madh të Prespës dhe disa përrenj të shkurtër. Mbrojtja e tyre përcaktohet nga statusi i mbrojtjes së Parkut Kombëtar, nga konventat ndërkombëtare të cilave i takon dhe Plani i Menaxhimit.
- Pika e kalimit kufitar Gorica e Madhe në kufi me Maqedoninë e Veriut përbën një infrastrukturë që i shërben lidhjes me vendin fqinj, si dhe rruga nacionale SH79 e cila përshkon të gjithë territorin e Bashkisë, duke qënë intinerari lidhës midis Bashkisë dhe Bashkive fqinje dhe Shqipërisë me Maqedoninë Veriut. Gjithashtu pika kufitare e propozuar në Cerje, do të jetë një pikë e rëndësishme e nivelit kombëtar, pasi do të jetë një portë hyrëse nga Greqia në Shqipëri, gërtoruar në këtë mënyrë bashkëpunimin ndërkombëtar dhe lehtësimin e aksesueshmërisë së vizitorëve në Parkun e Prespës.
- E gjithë Bashkia është një zonë që i jep përparësi zhvillimit të turizmit, pasi Parku Kombëtar Prespa dhe Peisazhi i Mbrojtur i Liqenit të Pogradecit është një nga 16 zonat prioritare për zhvillimin e turizmit sipas Projekt Vendimit të KKT nr.1, datë 26.07.2018 "Për shpalljen e zonave me përparësi zhvillimin e turizmit në territorin e Republikës së Shqipërisë ". Gjithashtu, fshati Zaroshkë është inkuadruar në Programin e Integruar për Zhvillimin Rural (PIZHR - Programi i 100 fshatrave), miratuar me VKM nr.21, datë 12.01. 2018, "Për disa shtesa në Vendimin nr. 709, datë 29.10.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Zhvillimin

Rural dhe Bujqësor 2014-2020". Ndër të tjera, PIZHR synon për përmirësimin e potencialit turistik në hapësirat rurale, agroturizëm dhe turizëm rural. Sipas këtij vendimi, programi i 100 fshatrave synon të koordinojë ndërhyrjet zhvillimore në hapësirën rurale të 100 fshatrave, sipas qasjes ndërsektoriale dhe me shumë aktorë, duke u shkëputur nga ndërhyrjet e copëzuara dhe me qasje strikte sektoriale, që po ndodhin apo pritet të ndodhin në vend. Gjatë Akademisë "100 fshatrat" organizuar nga AKPT, konkretisht me këtë zonë është marrë Lot-i nr. 12. Në kuadër të këtij programi (PIZHR) janë përcaktuar 3 projekte strategjike të cilat synohen të zbatohen me prioritet të lartë: Krijimi i rrjetit të agroturizmit shqiptar, Rrjeti i inkubatorëve të produkteve tradicionale dhe Rrjeti i markatave/dyqaneve të produkteve shqiptare dhe tradicionale. Në fshatin Zaroshkë ndodhet zona e malit të Osojës, si dhe plazhi ranor e shkëmbor buzë liqenit të Prespës. Përgjithësisht fshati Zaroshkë dallohet për turizëm rastësor, kryesisht kulinar, por paraqet potencial të lartë të pjesëmarrjes në itinerar turistik ndërqytetas.

6. **Infrastruktura Inxhinierike:** Sipas Planit të Përgjithshëm Kombëtar 2015-2030, Pusteci përcaktohet si qendër terciare dhe parashikohet të jetë pjesë e rrjetit të përforcuar të linjave elektrike, si dhe përmirësimit të rrugëve peisazhiste. Gjithashtu parashikohet lidhja rrugore Pogradec-Tushemisht-Stenjë.

1.5. Zonat kryesore të zhvillimit ekonomik dhe urban

Rol vendimtar në realizimin e vizionit dhe zbatimin e objektivave strategjike luajnë zonat e zhvillimit ekonomik dhe urban kryesor, që krijojnë mundësi të reja dhe përbëjnë bazën për rivitalizimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të Bashkisë.


Propozohet që këto zona të jenë të shumëllojshme, me karakter dhe intensitet të ndryshëm dhe të shpërndara në hapësirë, të orientuara sipas karakteristikave të çdo vendi, me qëllim që të sigurohet një formë më fleksibile dhe më e qëndrueshme e zhvillimit të përshtatur për sfidat e ardhshme dhe ndryshimet e mëdha të mundshme (p.sh. mjedisore, ekonomike).

Organizimi hapësinor i propozuar i Bashkisë bazohet në zonimin e Planit të Menaxhimit të Parkut Kombëtar të Prespës dhe e specifikon atë, duke vënë theksin (a) në zonat që janë nxitëse të zhvillimit dhe pole tërheqjeje të investimeve, (b) në nyjet që janë pika hyrëse në rajon dhe (c) në qarkun e ndërlidhjes të burimeve dhe infrastrukturave brenda dhe jashtë nyjave.

Këto lloj zonash që mbështesin dhe promovojnë zhvillimin ekonomik të Bashkisë janë:

- zonat me mundësi zhvillimi të formave alternative të turizmit.
- parqet blegtorale

Bashkia Pustec bie pothuajse tërësisht në zona me regjim të veçantë mbrojtjeje: Parku Kombëtar i Prespës (kategoria II) sipas VKM nr. 80, datë 18.02.1999 dhe Peisazhi i Mbrojtur i Liqenit ië Pogradecit (kategoria V) që është miratuar me VKM nr. 80, datë 18.02.1999. Çdo ndërhyrje duhet të respektojë kuadrin e mbrojtjes dhe është në përputhje të plotë me rregulloret dhe kushtet që rrjedhin prej saj. Interes të veçantë jep dhe pozita gjeografike për shkak të karakterit ndërkufitar (lidhje direkte me Maqedoninë e Veriut, potenciale me Greqinë) dhe afërsisë direkte me qendrën primare të Korçës. Si rrjedhojë, *i tërë territori është potencialisht një zonë tërheqëse dhe me mundësi të shumta të zhvillimit të formave alternative të turizmit, edukimit dhe kërkimit e bashkëpunimit mjedisor si në nivel rajonal dhe në nivel ndërkombëtar. Aktivitetet shumë dimensionale (p.sh.*



akomodim, ushqim, vëzhgim i zogjve, hipizëm, shëtitje me varkë, provimi dhe shitja e produkteve lokale, pjesëmarrje në evene, guida dhe eskursione në natyrë dhe në ferma) do të lidhen dhe do të plotësohen përmes një strategjie të unifikuar dhe programeve të integruara nën koordinimin e Bashkisë dhe në bashkëpunim me Autoritetin Drejtues, komunitetit lokal dhe bizneset, si dhe OJQ-të dhe organizatat që aktivizohen në këta sektorë në zonë.

Vendbanimi Zaroshkë, i cili është pjesë e 100 fshatrave të PIZHR, do të shërbejë si një pikë e promovimit të prodhimit lokal dhe vend i zhvillimit pilot të agroturizmit. Nevojitet përmirësimi i imazhit dhe funksionimit të vendbanimit, përmirësimi i rrjetit rrugor dhe infrastrukturave të tjera teknike, krijimi i hapësirave të gjelbra dhe argëtimit në natyrë, organizimi i një plazhi, listimi i burimeve dhe dizajni i materialeve informuese.

Së fundmi si zona të posaçme të burimeve të shfrytëzueshme mund të karakterizohen monumentet kulturore dhe natyrore ekzistuese dhe të propozuara. Nëpërmjet menaxhimit të qëndrueshëm dhe integritit në rrjetet turistike (rajonale dhe kombëtare), ato mund të jenë pika tërheqëse për vizitorët dhe grupet e specializuara për edukim, studim dhe kërkime shkencore.

Krijimi i një parku blegtoral promovon qëndrueshmërinë dhe zhvillimin e veprimtarisë blegtorale, kontribuon në përmirësimin e të ardhurave të fermerëve, jep mundësi për marrëdhënie të reja bashkëpunimi midis tyre dhe zgjidh një problem të madh të konflikteve të përdorimeve të tokës.

Ndërlidhja e poleve të lartpërmendura dhe e të gjitha burimeve të mundshme dhe infrastrukturave të veçanta arrihet përmes kalimeve dhe tureve që vazhdojnë në Bashkitë fqinje dhe japin qasje në rrjetet e tyre. Këto akse janë:

- Aksi rrugor SH79 që përshkon bashkinë duke lidhur shumicën e vendbanimeve dhe me pjesën tjetër të vendit dhe Maqedoninë e Veriut.
- Aksi rrugor që lidh SH79 me Cerje, Prespën e Vogël dhe në të ardhmen me Greqinë (stacioni kufitar i propozuar)

Zhvillimi urban bazohet në Pustec dhe së dyti në rrjetin Goricë e Vogël dhe Goricë e Madhe e re. Zona urbane e Pustecit vazhdon të jetë poli kryesor i zhvillimit të banimit. Hyn në kategorinë qendër terciare dhe mbledh shërbimet më të rëndësishme dhe funksionet e bashkisë. Ndërhyrjet e propozuara synojnë përmirësimin e imazhit dhe funksionimit të hapësirës urbane, mbrojtjen e integruar dhe menaxhimin e trashëgimisë natyrore dhe kulturore dhe përmirësimin e infrastrukturës dhe shërbimeve, duke krijuar nga njëra anë kushte më të mira jetese për banorët e përhershëm dhe nga ana tjetër kushte të favorshme për rritjen e vizitueshmërisë dhe punësimit.

Një pol po aq i rëndësishëm për zhvillimin e banimit është Goricë e Vogël së bashku me Goricë e Madhe re, që u zhvillua në SH79 si qendër shërbimi për vendbanimet në pjesën veriore të bashkisë. Propozohet përmirësimi i infrastrukturave sociale, përmirësimi i estetikës dhe pasurimi i infrastrukturës së turizmit dhe argëtimit.

1.6. Shpërndarja e popullësisë në territor & Plani i strehimit

Megjithëse vitet e fundit, për Bashkinë Pustec, por edhe për Qarkun Korçë regjistrohet një tendencë rënije e popullsisë, vlerësohet se zbatimi i Strategjisë territoriale të propozuar, nëpërmjet realizimit të veprave të programit të veprimit, do të çojë në përmirësimin e kushteve sociale dhe ekonomike, në tërheqjen e vizitorëve dhe të investitorëve, në krijimin e vendeve më të mira dhe të reja të punës dhe si përfundim në forcimin e ekonomisë vendas dhe në përmirësimin e kushteve sociale dhe

ekonomike. Në këtë mënyrë, vlerësohet se do të arrihet zhvillimi i Bashkisë dhe mirëqenia e popullsisë së saj dhe për pasojë tendenca e sotme e rënies do të ndryshojë, jo vetëm do të mbahet popullsia aktuale por pritet të rritet gradualisht nëpërmjet tërheqjes së banorëve të rinj. Për më tepër, pritet përmirësim i karakteristikave cilësore të popullsisë (psh. përqindja e popullsisë aktive, treguesi i varësisë) si edhe ndryshim në përbërjen familjare (familje me numër më të ulët anëtarësh).

Parashikimet e popullsisë që janë bërë gjatë fazës së mëparshme të studimit parashikonin një rritje mesatare vjetore prej 0.30%. Për rrjedhojë, hartimi i zonës do të realizohet në bazë të totalit të popullsisë prej 3,493 banorëve. Më analitikisht, për çdo Njësi Administrative popullsia e ardhshme e Bashkisë vlerësohet se do të ndahet si më poshtë vijon:

BASHKIA PUSTEC	Parashikimi i popullsisë 2034
	3,493

Popullsia e vlerësuar do të vazhdojë të banojë në fshatrat e sotëm, ku përdorimet kryesore të tokës do të jenë ato të banimit dhe të shërbimeve që do t'u shërbejnë nevojave të popullsisë (psh. tregti, argëtim, administratë, arsimim, shëndet, kulturë, sport), dhe paralelisht shërbimet në favor të turistëve – vizitorëve (psh. mikëpritje, strehim), ndërsa e gjithë Bashkia përbën një zonë me rëndësi kombëtare me prioritet zhvillimin e turizmit.

Hierarkia e sotme dhe struktura e vendbanimeve ruhen, ashtu edhe numri i tyre. Kufijtë e fshatrave janë përcaktuar në bazë të Vendimit të KKT nr.5, datë 29.12.2014 dhe korrigjohen në vend, duke marrë parasysh elementët ekzistues të mjedisit, ata natyrorë dhe artificialë (psh. rrugë, përrenj, kanale, kufij troje). Për më tepër, futen sipërfaqe të kufizuara, të pastrukturuara apo të ndërtuara aty-këtu, me qëllim që të organizohen për pranimin e banesave të reja dhe infrastrukturave agro-ekoturistike, por edhe të infrastrukturave të reja sociale. Në qendrën e Bashkisë, ku nevojat janë më të mëdha dhe për më tepër ku synohet riorganizimi i qarkullimit, rritja e zonës së banuar është më e madhe. Gjithashtu, organizohen dy zona, të cilat në pjesën më të madhe të shtrirjes së tyre disponojnë një strukturim ekzistues, si pjesë e Goricës së Vogël, megjith se ka në distancë nga fshati.

Përsa i përket rezervës së ndërtesave, edhe pse ajo ekzistuese është e mjaftueshme nga aspekti sasior, pritet të ekzistojë nevoja si për ndërtimin e ndërtesave të reja ashtu edhe për përmirësimin apo zëvendësimin e atyre ekzistuese, sipas gjendjes dhe vlerës së tyre. Do të kërkohen banesa të reja për shkak të vendosjes së familjeve të reja që do të vijnë të banojnë në Bashki për herë të parë (psh. për punë), por edhe për shkak të shpërnguljes së anëtarëve të familjeve ekzistuese (anëtarë të brezave të ndryshëm që deri më sot bashkëjetonin në të njëjtën banesë do të kërkojnë një të re, psh. për shkak të përmirësimit të gjendjes ekonomike). Do të kërkohen ndërtesa të reja edhe për mikëpritjen e përdorimeve të tjera si infrastrukturave sociale, funksionet ekonomike, shërbimet turistike. Për përmirësimin dhe rehabilitimin e zonave të banuara propozohen strategji të përshtatshme dhe ndërhyrje të zhvillimit urban (shiko. Kapitulli 1.8).

Për më tepër, vlerësohet se një numër shumë i vogël banorësh do të vendoset edhe në sistemin rural, në ato zona ku do të lejohet përdorimi "banesë dhe bujqësi" (BA). Bëhet fjalë për zona përreth vendbanimeve, ku tashmë janë ngritur ndërtesa brenda sipërfaqeve bujqësore, me qëllim përdorimin e tyre si banesë e përhershme apo sezonale.



Përsa i përket strehimit social, edhe pse ekzistojnë të dhëna të disponueshme konkrete dhe aktuale, vlerësohet se nuk ekzistojnë nevoja përkatëse në Bashkinë Pustec. Nëse në të ardhmen do të rezultojnë këto nevoja, propozohet qoftë krijimi i apartamenteve ose/dhe banesave që do t'u jepen përfituesve në qendrën e Bashkisë, qoftë dhënia e huave me kushte të favorshme apo subvencionit. Ndërkohë, një problem i përgjithshëm është mungesa e burimeve ekonomike të mjaftueshme dhe e tokës bashkiake (apartamente, troje) për zhvillimin dhe mbështetjen e programeve të strehimit. Nga njëra anë, zgjidhje mund të jetë sigurimi i financimit (psh. EKB, grante) dhe nga ana tjetër shfrytëzimi i mjetit të intensitetit të ndërtimit me kushte në zona konkrete, në zona të caktuara të Pustecit (shiko gjithashtu Kapitullin 1.9).

1.7. Njësitë që i nënshtrohen hartimit të PDV-së

Bazuar në Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.7.2014, "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar; dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 686, datë 22.11.2017, "Për Miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit" e ndryshuar, sipas VKM nr. 232, dt. 17.04.2019, janë përcaktuar njësitë ose grupet e njësive, për të cilat duhet të hartohet Plani i Detajuar Vendor (PDV). Këto plane hartohen me nismë publike ose private në zona të cilat janë:

- a. një njësi strukturore;
- b. disa njësi strukturore bashkë;
- c. çdo zonë me prioritet për zhvillim, e përcaktuar si e tillë në planin e përgjithshëm vendor të territorit.

Plani i Detajuar Vendor hartohet me qëllim¹:

- a. zhvillimin dhe/ose rizhvillimin e një njesie;
- b. rigjenerimin/ripërtëritjen urbane;
- c. ndërtimin e infrastrukturave publike;
- d. ndryshim të përdorimit të tokës dhe kushteve të zhvillimit;
- e. investime publike që ndikojnë në infrastrukturë apo shërbimet publike që ndikojnë në ndryshimin ose rishpërndarjen e treguesve të zhvillimit;
- f. programe të transferimit të së drejtës për zhvillim dhe të intensitetit me kushte.

Në përgjithësi, PDV propozohet në njësitë, ku presioni i zhvillimit pritet të rritet, përmes ndërhyrjeve hapësinore kryesisht në formën e rizhvillimit, rigjenerimit dhe urbanizimit. PDV konsiderohet si mjete më i përshtatshëm për organizimin e hapësirave të qëndrueshme urbane dhe sigurimin e infrastrukturës së nevojshme dhe i integritit normal në rrjetin urban dhe ndërlidhjen me funksionet e tjera urbane. Madhësia e zonës për PDV varet nga lloji dhe kushtet e zhvillimit të planifikuar: përdorimet, dendësia, intensiteti i ndërtimit, morfologjia urbane. Propozohet që njësitë për PDV të kenë madhësi të ndryshme, madje edhe të vogla, që të jenë fleksibël dhe të lehtë për t'u menaxhuar. Për përcaktimin e kufijve të tyre duhet të ndiqen kufij sa më të qartë dhe të qëndrueshëm (ekzistues ose të propozuar), përgjithësisht elemente natyrore si rrugë, vija ujore, zona pyjore etc.

Veçanërisht zhvillimi nëpërmjet PDV është zgjedhur në zonat e Bashkisë ku janë vendosur funksione të reja, duke krijuar pole të reja të zhvillimit ekonomik. Këto janë:

¹ Pikat a, b, c: janë bazuar në nenin nr. 22 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.7.2014, "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar / Pikat ç, d, dh: janë bazuar në nenin nr. 68 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 686, datë 22.11.2017, "Për Miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit" e ndryshuar, sipas VKM nr. 232, dt. 17.04.2019

- zonat natyrore buzë liqenit që do të organizohen si plazhe si dhe zonat e moleve (pier) të propozuara të rrethuara nga infrastruktura-implante ndihmëse.
- zonat e zhvillimit të infrastrukturave të reja sociale dhe ekonomike në Pustec: hapësira sportive, qendra kulturore, tregu i produkteve lokale
- zonat për zhvillimin e një parku blegtoral
- zona e re e kalimit kufitar për në Greqi në Çerje.
- stacioni i transferimit të mbeturinave

Së fundi, propozohet që zhvillimi nëpërmjet PDV-së së zonës së re të banimit në jug të fshatit Pustec, me qëllim që të sigurohet një planifikim i integruar mjedisor dhe karakter uniform si dhe lidhje harmonike me rrjetin ekzistues të banimit.

Akset drejtuese të zhvillimit të bashkisë janë padyshim rritja ekonomike dhe rigjenerimi urban, duke ruajtur profilin e veçantë rural dhe mjedisor të saj. Në këtë kontekst, përzgjidhet zhvillimi përmes PDV në zona të bashkisë ku vendosen funksione të reja, duke krijuar akse të reja të rritjes ekonomike, promovimit të turizmit dhe rigjenerimit urban.

Në veçanti:

Propozohet zhvillimi përmes hartimit dhe zbatimit të PDV, me projekt bazë organizimin e fronteve bregdetare në njësitë bashkiake Zaroshkë dhe Kallamas. Konfigurimi i plazheve do të bëhet në njësitë me numër:

- PS_N_NAR2_44/1
- PS_N_NAR2_39/1

Në zonën e Zaroshkës, njësia ndodhet në pjesën bregdetare verilindore të vendbanimit. Është një zonë e pashfrytëzuar me sipërfaqe prej 1.8 km, e cila është me interes të veçantë estetik dhe mjedisor. Sipas situatës aktuale, vendi nuk strehon ndonjë aktivitet, ndërsa përdorimi i tokës është përcaktuar si livadh. Shtrirja e plazhit është pjesë e programit të projektit PIZHR 100 fshatrat, ndërsa gjithashtu përfshin infrastrukturën plotësuese për aktivitetet e agroturizmit dhe sportit.

Zhvillimi i aktiviteteve dhe shërbimeve mbështetëse, përveç formimit të plazhit do të realizohet në mënyrë natyrale pa ndryshuar bimësinë dhe fizionominë ekzistuese të zonës. Krijimi ndodhet në pjesën jugore të liqenit të Prespës së Madhe, e cila është gjithashtu veçori mbizotëruese e Bashkisë, e cila synon të promovohet.

Si rrjedhim, gjykohet i rëndësishëm hartimi i një studimi PDV për zonën dhe hapësirën që do të instalohet parku i agroturizmit i vendbanimit, duke marrë parasysh hapësirat e gjelbra, zonat sportive dhe rekreative. Objektiv kryesor është përmirësimi i potencialit turistik i zonës rurale dhe promovimi i agroturizmit. Në kuadër të kësaj ndërhyrjeje zhvillohet një qasje ndërsektoriale, me veprimtari të shumëfishta paralele në sektorin rural, turistik dhe atë kulturor. Me zhvillimin e turizmit alternativ, propozohet promovimi paralel dhe mbështetja me infrastrukturën e duhur, aktivitetet e përkatëse të kohës së lirë. Në këtë mënyrë, bëhet e mundur arritja e objektivave themelore për të përmirësuar rajonin dhe për të forcuar dhe zhvilluar ekonominë lokale, duke përfshirë:

- forcimin e ekonomisë së rajonit
- tërheqjen e turistëve
- pasurimin dhe përmirësimin e shërbimeve të turizmit dhe të kohës së lirë në bashki
- rritjen e konkurrencës së destinacioneve turistike alternative

Në zonën e Kallamas, njësia ndodhet në jug të vendbanimit përgjatë bregdetit. Është e mbuluar nga një sistem natyror, dhe sipas situatës aktuale nuk ka asnjë shfrytëzim të përparësive mjedisore që



kjo zonë ofron. Ajo përbën një ekosistem natyror të shquar, i cili kërkon menaxhim të duhur gjatë krijimit të zonës së plazhit.

Studimi konsiderohet kritik në këto zona, pasi së bashku me ridefinimin e bregut të liqenit, promovohen aktivitete turistike të rëndësishme që do të promovojnë vet bashkinë. Parashikohet që rikonfigurimi i kësaj njësie do të ndikojë në zhvillimin e ekonomisë së rajonit dhe për të tërhequr vizitorë të jashtëm të rëndësishëm për vet rajonin.

Qëllimi është nga njëra anë për të zhvilluar dhe për të ofruar infrastrukturë moderne dhe të përshtatshme për zhvillimin e turizmit alternativ dhe nga ana tjetër për të përmirësuar gjendjen fizike të zonës ripariane.

Në të njëjtën kohë, përfitimet që rrjedhin nga zhvillimi dhe zbatimi i PDV lidhen me:

- përmirësimin e marrëdhënies liqen - tokë dhe marrëdhënies ndërmjet banorëve dhe vizitorëve me elementin ujor,
- pasurimin dhe përmirësimin e shërbimeve të turizmit dhe kohës së lirë në bashki
- përforcimin e identitetit të bashkisë
- menaxhimin e qëndrueshëm të mjedisit natyror.

Propozohet organizimi përmes zhvillimit dhe implementimit të PDV për ferma blegtorale në territorin e bashkisë. Vendosja e këtyre parqeve do të bëhet në njësitë me numër:

- PS_B_EB2_17/2
- PS_B_EB2_50/1
- PS_B_EB2_68/1

Propozohet të organizohet në mënyrë pilot një fermë blegtorale në veri të bashkisë. Është vendosur në një distancë të shkurtër nga autostrada SH79 duke e bërë rajonin lehtësisht të arritshëm si për punonjësit ashtu edhe për transportin e produkteve dhe lëndëve të para. Në të njëjtën kohë, ngjendet ngjitur me stacionin kufitar duke krijuar kushte të favorshme për bashkëpunim dhe marketing. Njësia është e pashfrytëzueshme sipas të dhënave të situatës aktuale, edhe pse siç u përmend, disponon avantazhe të ndryshme rajonale. Zhvillimi i parkut nëpërmjet studimit PDV do të ofrojë përfitime të rëndësishme në rajon, pasi blegtoria është një aktivitet tradicional ekonomik për vet këtë bashki, e cila po përballet me disa probleme dhe çështje. Roli i fermave blegtorale është shumëdimensional dhe i një rëndësie të madhe, pasi nxit zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë në përgjithësi dhe të blegtorisë në veçanti në kombinim me menaxhimin racional të kullotave dhe në ekuilibër me zonat e mbrojtura. Në këtë mënyrë, mund të arrihen objektivat themelore të përmirësimit të situatës në rajon dhe të forcimit dhe zhvillimit të ekonomisë lokale, ku përfshihen:

- Sigurimi i kushteve më të mira për kafshët
- Kushte më të mira të punës për fermerët blegtoralë
- Bashkëpunimi i mbarështuesve në nivelin e përdorimit të parkut të përbashkët blegtoral
- Mbrojtje më efektive mjedisore
- Përmirësimi estetik i peizazhit urban
- Menaxhimi i plotë shkencor, shfrytëzimi dhe përmirësimi i kullotave
- Prodhimi i produkteve blegtorale më të mira dhe më cilësore
- Krijimi i vendeve të reja të punës
- Përmirësimi i të ardhurave të fermerëve blegtoral, nga operimi i organizuar i parkut blegtoral,
- Përmirësimi i kushteve të jetesës dhe higjienës



Së fundi, është propozuar zhvillimi, përmes hartimit dhe implementimit të PDV, i infrastrukturës së re sociale dhe ekonomike në selinë e Bashkisë Pustec. Këto infrastruktura të reja duhet të vendosen në njësitë e mëposhtme:

- PS_UB_AR2_11/1.

Njësitë në të cilat do të kryhen aktivitetet e reja do të vendosen në pjesën verilindore të qytetit të Pustec. Janë brenda kufijve të vendbanimit dhe zonës urbanistike të qytetit. Në mënyrë të veçantë, parcelat nën gjendjen ekzistuese i përkasin sistemit urban. Objektet e reja do të përfshijnë krijimin e një qendre kulturore dhe krijimin e një infrastrukture të përshtatshme për krijimin e një tregu për produktete lokale.

Rizhvillimi i parcelave përmes hartimit të PDV është pjesë e krijimit të një qendre multifunkionale urbane për bashkinë. Në qytet është e nevojshme vendosja e shërbimeve për nevojat e përditshme të qytetarëve dhe zhvillimin e aktiviteteve tregtare. Në veçanti, qendra kulturore do të organizojë aktivitete që do të nxisin veprimtari publike, ndërsa paralelisht do të rritet identiteti kulturor i rajonit. Krijimi i një tregu për produktet lokale duhet të ketë një rol mbështetës në ekonominë lokale. Më në përgjithësi, përfitimet që do të rrjedhin nga zhvillimi dhe zbatimi i PDV për zhvillimin e këtyre infrastrukturave të reja sociale dhe ekonomike përfshijnë:

- promovimin e prodhimeve vendore
- Zbatimin e aktiviteteve të marketingut
- promovimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore
- krijimin e shërbimeve të papërfunduara kulturore
- krijimin e një marke tregtare
- krijimin e vendeve të reja të punës.

1.8. Mënyra e ndërhyrjes në territor

Mënyrat e ndërhyrjes paraqesin rrugën që do të ndiqet për ruajtjen, përmirësimin apo ndryshimin e gjendjes ekzistuese të Bashkisë në fjalë (ringjenerimin, dendësimin, rihvillimin, konsolidimin, konservimin dhe urbanizimin), duke u mbështetur në elemente sasiore dhe cilësore. Plani i Zhvillimit përmban terma të krijuara sipas përkufizimit ligjor dhe rregullores së planifikimit. Më konkretisht, përkufizimet për mënyrat e ndërhyrjeve paraqiten më poshtë:

Rizhvillim: është procesi i zhvillimit dhe i rindërtimit të një territori, i cili është i ndërtuar, por i degraduar dhe kryesisht me mungesa të funksioneve kryesore.

Dendësim është procesi i rritjes së dendësisë së ndërtimit brenda një territori të caktuar. Mbushje Urbane është një formë e dendësimit ku procesi kryesor është ai i mbushjes së parcelave bosh/të pandërtuara me ndërtime të reja dhe me tregues zhvillimi të ngjashëm me ato që ekzistojnë në zonë. Pra, treguesit në nivel zone do të rriten, por treguesit në nivel parcele mbeten të njëjtë me ata të parcelave që kanë ndërtime në momentin e mbushjes. Përgjithësisht, ruhet karakteri apo tipologjia e ndërtimit dhe ajo urbane. Ndërhyrjet infrastrukturore janë përmirësuese, por jo thelbësore.

Urbanizim është procesi i ndërhyrjes në territor nëpërmjet zhvillimeve të reja, i cili sjell ndryshime të strukturës së popullsisë dhe territorit, në funksion të rritjes së sistemit urban.



Konsolidim është procesi i zhvillimit të territorit, i cili ka për qëllim përmirësimin dhe forcimin e infrastrukturës së zonës së urbanizuar ekzistuese dhe të propozuar, duke nxitur ndërtimin brenda zonave të urbanizuara. Në veçanti, koncepti i konsolidimit specifikohet në disa raste si më poshtë:

Zhvillim është procesi i ndryshimit të territorit përmes ndërtimeve të reja, të shoqëruara edhe me infrastrukturën përkatëse. Në raste të veçanta, zhvillimi mund të përfshijë vetëm programin e pajisjes së zonës me infrastruktura, duke tërhequr kështu investitorë për ndërtime private. Zhvillimi ndikon në ndryshimin e vlerës së tokës dhe, përgjithësisht, e ngre atë.

- Një nënkategori e cila përfshihet në konsolidim është ristrukturimi. Ristrukturimi për infrastrukturën, ku janë të degraduara ose të dëmtuara dhe riparimi nuk është i mjaftueshëm. Veç ndërhyrjeve strukturore, mund të ndryshohen edhe parametrat e infrastrukturës në fjalë. Rruga, për shembull, mund të zgjerohet dhe të pajiset me elemente sigurie shtesë etj.
- **Pastrim** i zonave nga ndotës me metoda fizike & biologjike, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe krijesave të tjera.

Rigjenerim: është procesi i përmirësimit të kushteve ekonomike, fizike, sociale dhe mjedisore të një territori apo ndërtimi. Në këtë kategori i nënshtrohen nënkategoritë si mëposhtë:

- **Trajtim peisazhistik** mund të realizohet në zona urbane, natyrore dhe bujqësore. Ky instrument përdoret jo vetëm për evidentimin, por edhe përmirësimin e vlerave ekologjike e estetike të zonave peisazhistike. I shërben funksionit kryesor të zonës, por ka vlerë ekologjike, përpos asaj estetike. Në çdo rast, ky trajtim modifikon karakteristikat e dukshme të zonës, si: paraqitjen e bimësisë dhe elementeve ujore, formave të tokës dhe trupave ujorë, efektet e motit apo mikroklimës etj. Metodatat që përdoren janë: krijim i korridoreve biologjike, ripyllëzime, mbjellje bimësh në një formacion të caktuar, rehabilitim dhe restaurim mjedisor, zbutje ose eliminim i fragmentimit të matricës natyrore ose komponentëve të ekosistemit, rikrijim ose restaurim i zonave ripariene dhe brigjeve ujore në tërësi, kombinime të elementeve bimë me ato ujore dhe historike për të krijuar një mesazh apo atmosferë të caktuar.

Konservim parashikon rregullorja e planifikimit, e miratuar me VKM nr. 686 , datë 22.11.2017 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit” e ndryshuar, sipas VKM nr. 232, dt. 17.04.2019. Në këtë rregullore ky term thellohet edhe më tej si: Proçesi i mbrojtjes/ruajtjes së burimeve natyrore, ekosistemeve dhe funksioneve e shërbimeve të tyre, si dhe zonave e objekteve historike/kulturore/arkeologjike nga zhvillimet e natyrave të ndryshme dhe/ose efektet e zhvillimit në to. Proçesi i konservimit nuk nënkupton ngrirje, por shmangie nga aktivitetet dëmtuese/ndotëse. Zonat/objektet të cilat janë subjekt i konservimit mund të përdoren, por në mënyrë inteligjente. Masat që merren mund të përfshijnë si vendosje të barrierave e brezave mbrojtëse, ashtu edhe disa nga mënyrat e mësipërme (së bashku ose jo), konkretisht: zbutje, rehabilitim, restaurim, reklamim dhe riparim. Në raste të tjera, ekosistemet lihen thjesht në gjendjen e tyre natyrore për t’i mbrojtur nga ndërhyrjet me karakter dëmtues/ndotës.

Në rastin e trashëgimisë kulturore (monumente të kulturës dhe zona arkeologjike, sipas legjislacionit përkatës) është vlerësimi i thelbit origjinal të monumenteve nëpërmjet ndërhyrjeve për ndalimin e degradimeve të mëtejshme dhe nxjerrjes në pah të vlerave të tyre. Mund të përfshihen edhe



procese restaurimi ose rigjenerimi pa ndryshuar karakterin dhe vlerat e zonës historike në përputhje me legjislacionin në fuqi.

1.9. Instrumentet për drejtimin e zhvillimit

Ligji nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” formulon një kornizë gjithëpërfshirëse për menaxhimin e tokës, siguron instrumentat e planifikimit (p.sh. PDV, plane sektoriale, plane të zonave të rëndësishme kombëtare), mjetet rregullatore (p.sh. rregullat e zhvillimit, përcaktimi i përdorimit të tokës, intensitetet e ndërtimit etj.) dhe mjetet ekonomike për realizimin e tyre. Në veçanti, në nenet 30-36 të këtij Ligji përshkruhen instrumentet për drejtimin e zhvillimit, si:

- Intensiteti i ndërtimit me kushte
- Transferimi i së drejtës për zhvillim
- Zhvillimi i detyrueshëm i tokës
- Pezullimi i zhvillimit
- Servituti publik
- E drejta e transferimit
- E drejta e preferimit

Mënyra dhe procedura e zbatimit të dy pikave të para analizohet më tej në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” (ndryshuar me VKM nr.672, datë 29.7.2015; nr.1043, datë 16.12.2015; nr.271, datë 6.4.2016; nr.231, datë 21.3.2017; nr.355, datë 19.4.2017); përkatësisht neni 41 flet për Intensitetin e ndërtimit me kushte dhe neni 42-44 për Transferimin e të drejtës për zhvillim.

Të gjithë instrumentet e sipërpërmendura janë të ndryshëm midis tyre, por mund të funksionojnë së bashku.

Dy nga instrumentet e para të lartpërmendura lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me hartimin e PPV-së duke qenë se parashikojnë kushte të caktuara zhvillimi për njësi strukturore të veçanta .

Në Bashkinë e Pustecit evitohet instrumenti i intensitetit të ndërtimit me kushte, duke qenë se nuk është e dëshirueshme rritja e intensitetit në një rajon sensibil nga ana mjedisore dhe me ekuilibër delikat. Përjashtim përbën një zonë në Pustec, ku ky instrument mund të përdoret vetëm për krijimin e banesave sociale. Kjo zonë nuk mund të specifikohet në kontekstin e studimit aktual.

Instrumenti i transferimit të së drejtës për zhvillim mund të përdoret (a) në njësi të ndryshme të Bashkisë për mbrojtjen e monumenteve kulturore (instrumenti aplikohet në zonën e mbrojtjes siç është aprovuar dhe jo në të gjithë zonën e njërive) përmes menaxhimit të përdorimeve të tokës brenda zonave të miratuara të mbrojtjes, dhe (b) në njësitë e vendbanimit Pustec për krijimin e hapësirave të gjelbërta dhe të kohës së lirë. Këto janë njësitë: PS_UB_AR1_9/1, PS_UB_AR1_11/1, PS_UB_B2_52/1, PS_UB_B2_59/1, PS_UB_BA1_52/1 dhe PS_UB_BA1_59/1.



2. PLANI I SHËRBIMEVE DHE INFRASTRUKTURAVE PUBLIKE

Integrimi hapësinor i Bashkisë dhe shpërndarja e balancuar e flukseve brenda territorit të saj dhe përmirësimi të efikasitetit kohor, uljes së kostos dhe shkurtimeve të distancave. Një nga komponentët kryesorë të kësaj faze të studimit është programi i shërbimeve dhe infrastrukturës publike dhe ndikimi që ato kanë në territorin e Bashkisë. Planifikimi dhe menaxhimi i tyre është kompleks dhe për këtë arsye, pozicionim i tyre është parashikuar për të shmangur ndërveprimet negative ndërmjet rrjeteve të ndryshme infrastrukturore dhe ndikimeve negative mjedisore. Qëllimi i studimit është të plotësojë nevojat aktuale dhe të ardhshme, në varësi të popullsisë së vlerësuar për vitin 2033.

Objektivat themelore për sigurimin e infrastrukturës adekuate dhe efikase publike janë:

- Shpërndarja hapësinore e balancuar e përdorimeve të tokës.
- Vendosja e duhur në mënyrë që të shmangen ndërveprimet e pafavorshme midis rrjeteve.
- Plotësimi i nevojave të tanishme dhe të ardhshme (bazuar në parashikimet e vlerësimit për zhvillimin e popullsisë dhe synimin e zhvillimit) me çdo zgjerim të nevojshëm.
- Përmirësimi i cilësisë dhe modernizimi i infrastrukturave ekzistuese.
- Sigurimi i mbrojtjes së mjedisit.
- Sigurimi i lidhjes dhe aksesueshmërisë.

Nevojitet një qasje e integruar që optimizon efikasitetin e rrjetit, mbulon në mënyrë adekuate nevojat, përmirëson standardet e jetesës dhe redukton ndikimet mjedisore.

Infrastruktura teknike publike përfshin të gjithë zonën e bashkisë së Pustecit, objektet ekzistuese dhe të propozuara dhe synon zbatimin e shërbimeve publike në fushat e mëposhtme.

2.1. Infrastruktura e transportit

Është i nevojshëm një sistem gjithëpërfshirës dhe miqësor mjedisor transporti, i përshtatur me modelin e ri të propozuar të zhvillimit hapësinor. Qëllimi kryesor është të sigurojë qasjen dhe lidhjen me të gjithë territorin e Bashkisë dhe të forcojë lidhjen e Bashkisë me Bashkitë e tjera dhe veçanërisht me ato fqinje. Ndërhyrjet e propozuara bazohen në gjashtë akse:

1. Përmirësimi i infrastrukturës rrugore ekzistuese me masa të përshtatshme, të tilla si përmirësimi i karakteristikave gjeometrike (p.sh. zgjerimi, ndërtimi i bazamentit, rregullimi i nyjeve), mirëmbajtja, asfaltimi, ndriçimi, sinjalistika, instalimi i barrierave mrojtëse etj., të cilat rrisin sigurinë rrugore.

Propozohen:

- mirëmbajtja e rrugës kombëtare SH79 dhe aranzhimi i nyjave në pikat e takimit të saj me 7 rrugët që lidhin vendbanimet (Lajthize, Pustec, Diellas, Gollomboc, Gorica e Vogel, Kallamas, Gorica e Madhe).
- asfaltimi i rrugëve në 5 vendbanime (Gollomboc, Gorica e Vogel, Cerje, Zaroshke, Lajthize).
- përmirësimi i karaxhatave të rrugëve, sigurisë në rrugë dhe sinjalistikës rrugore në 3 seksione Zaroshkë – Cerje.

2. Zgjerimi i rrjetit rrugor atje ku është i nevojshëm, me ndërtimin ose përfundimin e lidhjeve të reja rrugore dhe ndërtimin e veprave teknike të nevojshme, siç është pika kufitare e propozuar dhe unaza e Pustecit.

3. Krijimin e rrugëve të përshtatshme për lëvizjen e biçikletave dhe këmbësorëve.
Më specifikisht, propozohet:
 - përshtatje e rrjetit rrugor (sinjalistika horizontale dhe vertikale) dhe organizimi i rrugëve brenda Parkut Kombëtar për qarkullimin e biçikletave.
 - krijimi i itinerarit për këmbësorë anës liqenit dhe ndërtim i shëtitores përgjatë rrugës lidhëse të plazhit.
4. Zhvillimi/forcimin e transportit publik bashkiak dhe ndërbashkiak.
Propozohet:
 - organizim më optimal i shërbimeve në bashkëpunim midis Bashkisë dhe kontraktuesit privat që ofron shërbime transporti publik. Lidhjet e rregullta në mes të qyteteve kryesore (si Korça, Bilishti, Maliqi) janë gjithashtu të përshtatshme për të rritur tregtinë dhe lëvizjet e banoreve dhe vizitorëve.
 - organizim i terminalit në Pustec dhe stacionet e përcaktuara gjatë itinerarit të linjës për hipjen apo zbritjen e udhëtarëve.
5. ndërtimi dhe pajisja e moleve në pikat e përshtatshme (Pustec, Zaroshkë, Goricë e Vogël, Gollomboc, Kallamas). Ndërlidhja me mënyrat e tjera të transportit publik (varkat) mundet në të ardhmen të shërbejnë përveç intinerarëve turistikë dhe transportin e banorëve midis shteteve fqinjë.
6. Organizimi i përshtatshëm i trafikut, kryesisht në selinë e Bashkisë dhe në vendbanimet e tjera, duke synuar shërbimin optimal të përdorimeve të tokës / aktiviteteve dhe përmirësimin e kohës dhe cilësisë të lëvizjeve dhe promovimin e lëvizjes së qëndrueshme.

Organizimi i trafikut duhet të marrë parasysh të gjitha të dhënat e nevojshme, si madhësinë dhe karakterin e cdo vendbanimi, karakteristikat gjeometrike të rrjetit rrugor ekzistues, përdorimet e tokës, hapsirat ekzistuese dhe të propozuara të veprimtarive të interesit publik, elementet e vyer natyrore dhe kulturore, etj.

Përveç kësaj, duhet të bëhet kujdeset për promovimin dhe lehtësimin e lëvizjes së këmbësorëve, çiklistëve, fëmijëve dhe grupeve vulnerabël, duke përfshirë njerëzit me lëvizshmëri të reduktuar, për udhëtime të përditshme (p.sh. në punë, shkollë, kohë të lirë). Është e dëshirueshme që të organizohen mjedise parkimit në natyrë, në vende të përshtatshme, ku objektet e interesit dhe të përdorimit publik janë pole tërheqëse për lëvizje.

7. Lehtësimi i udhëtimit ndërkufitar dhe përshpejtimi i operacioneve të kontrollit të identitetit në dogana dhe pikat hyrëse / dalëse në kuadër të bashkëpunimit të trepalshëm në territorin e 2 liqeneve të Prespës. Kjo ndërhyrje duhet të kufizohet dhe të jetë në përputhje me natyrën e zonës dhe parashikimet e Planit të Menaxhimit të Parkut Kombëtar. Mund të për referohet shembull tek makinat e pasagjerëve, për të stimuluar turizmin dhe për të rritur volumin e transaksioneve ditore, dhe jo për udhëtimet tregtare.

Gjatë plotësimit - zgjerimit - përmirësimit të sistemit të transportit, duhet të merren të gjitha masat e nevojshme për të qenë në përputhje me Planin e Menaxhimit të Parkut Kombëtar të Prespës, për të minimizuar ndikimet mjedisore dhe për të ruajtur dhe përmirësuar peizazhin.



2.2. Infrastruktura inxhinierike

Propozimet për përmirësimin e infrastrukturës inxhinierike publike përfshijnë të gjithë zonën e bashkisë së Pustecit, objektet ekzistuese dhe të propozuara dhe synon zbatimin e shërbimeve publike në fushat e mëposhtme:

- Infrastruktura e ujësjellës-kanalizimeve
- Infrastruktura e trajtimit të ujërave të ndotura
- Infrastruktura e menaxhimit të mbetjeve
- Infrastruktura e telekomunikacionit

Infrastruktura e energjisë dhe komunikimit kanë rëndësi të veçantë pasi ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejt në vendosjen, zgjerimin dhe lidhjen kohore të një zhvillimi të qëndrueshëm të Bashkisë. Infrastruktura e ujësjellësit dhe kanalizimeve, trajtimi i ujërave të përdorura, depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve janë të nevojshme të vendosen në përputhje me përqëndrimin e popullsisë dhe në plotësim të kërkesave për arritshmëri të përshtatshme.

Infrastruktura e ujësjellësit

Aktualisht Bashkia e Pustecit siguron furnizimin me ujë për pjesën më të madhe të territorit të saj nëpërmjet rrjetit të ujësjellësit. Gjithsesi në të ardhmen konstatohet nevoja për përmirësimin e nivelit të matjes, rikuperimin e kostos së operimit dhe arritje e furnizimit të pandërprerë 24 orë. Për sa i përket zonave rurale të Bashkisë ka nevojë për investime në shërbimin e furnizimit të ujit në vendbanimet Zaroshkë, Pustec, dhe në fshatra të ndryshme. Sa i përket cilësisë së ujit të pijshëm, ato duhet të jenë në përputhje të plotë me kushtet që përcakton VKM nr. 379, datë 25.5.2016 "Për miratimin e rregullores cilësia e ujit të pijshëm".

Pajisja e zonave të banuara me sisteme të kanalizimeve, për largimin e ujërave të ndotura urbane, është një domosdoshmëri sanitare, sociale dhe mjedisore. Kjo ndikon direkt në shëndetin dhe cilësinë e jetës së qytetarëve. Përveç largimit në mënyrë të organizuar, një kërkesë tjetër e Direktivës Kuadër të Ujit të BE-së, e cila është traspozuar edhe në legjislacionin shqiptar, është trajtimi i këtyre ujërave, përpara shkarkimit në trupat ujorë. Kjo ndikon, jo vetëm në afërsi të zonës ku bëhet shkarkimi, por krijon ndotje, e cila transferohet edhe në zonat e poshtme të basenit ujëmbledhës. Për trajtimin e ujërave të ndotur urbane ka tre kategori të trajtimit të cilat janë niveli primar, niveli sekondar dhe niveli terciar. Por sipas kësaj direktive kërkohet që për zona me popullsi ekuivalente më të mëdha se 2000 banorë të ndërtohen impiante trajtimi, ndërsa për komunitete me popullsi ekuivalente më të vogël se 2000 banorë rekomandohet akomodimi i impjanteve alternative individuale, apo kolektive, kur është e pamundur të bëhet lidhja me impiantin e trajtimit më të afërt.

Infrastruktura e kanalizimeve

Sistemet e kanalizimeve duhet të jenë të ndara, në mënyrë që të ndahen ujërat e ndotura urbane më vete dhe ujërat e shiut më vete. Kjo do të lehtësonte trajtimin e ujërave të ndotura urbane në impiant dhe do të ulte kostot e operimit të këtyre impianteve në të ardhmen. Duke qenë se sistemet e kanalizimeve të ujërave të ndotura urbane dhe sistemet e ujërave të shiut shoqërojnë në të shumtën e rasteve infrastrukturën rrugore, është e rëndësishme që këto investime të jenë të integruara edhe me hartimin e projekteve për ndërtimin apo rehabilitimin e rrugëve brenda zonave të banuara.

Ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve dhe trajtimi i ujërave të ndotura urbane përpara shkarkimit në trupat ujore është një domosdoshmëri për të gjithë territorin e Bashkisë Pustec. Për këtë është bërë planifikimi i zonave të banuara, ku duhet të ndërtohen rrjetet e kanalizimeve. Vendbanimet në të cilat propozohen ndërhyrje në rrjetin e kanalizimeve janë Pusteci, Zaroshka, Gorica e Vogël, Lajthiza, Gollomboçi dhe Kallamasi.

Infrastruktura e trajtimit të ujërave të ndotura

Mbrojtja e statusit ekologjik të ujit siç kërkohet nga DKU (Direktiva Kuadër të Ujit të BE-së) është objektivi kryesor për identifikimin e infrastrukturës së duhur për trajtimin e ujërave të ndotura. Gjithashtu, pozicionimi i impianteve të trajtimit duhet të planifikohet në zonat periferike të qendrave të banuara dhe pranë trupave ujorë, për të ulur kostot e largimit të ujit. Gjithashtu, një nga kriteret që kushtëzon pozicionimin është konfigurimi topografik i zonave të banuara, duke vendosur impiantet mundësisht në pika më të ulta se ato të qendrave të banuara. Kjo do të mundësonte dërgimin e ujërave të ndotura me vetë rrjedhje deri në impiant. Në zonat ku është e mundur nga konfigurimi dhe kushtet mjedisore rekomandohet të përdoret trajtimi natyral me ligatina. Këto zona mundet të jenë vendbanimet në vijim: Lajthiza, Diellasi, Gorica e Vogël, Gorica e Madh, Gollomboçi dhe Kallamasi.

Infrastruktura e menaxhimit të mbetjeve

Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve (Strategjia) është dokumenti kryesor planifikues në fushën e menaxhimit të mbetjeve bashkiake, jo-bashkiake dhe të rrezikshme në Shqipëri. Dokumenti aktual, përfaqëson Strategjinë e rishikuar dhe mbulon periudhën 2018-2033. Kjo Strategji ka si qëllim kryesor të përditësojë politikat dhe Planin Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, si dhe të përshtasë drejtimit strategjike për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe mbrojtjes së mjedisit në përgjithësi, si në nivelin qendror ashtu edhe atë vendor.

Parimi kryesor për menaxhimin e mbetjeve është hierarkia e mbetjeve. Strategjia merr parasysh dhe rëndësinë e menaxhimit të mbetjeve sipas parimit të ekonomisë qarkulluese për të mundësuar mbrojtjen sa më të plotë të burimeve natyrore dhe rritjen e efijencës së përdorimit të produkteve. Siç përcaktohet dhe në ligjin Nr.10463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar, menaxhimi ndjek radhën e mëposhtme, në zbatim të hierarkisë për Parandalimin (i gjenerimit të mbetjeve), ripërdorimin, riciklimin, rikuperimin dhe asgjësimin e mbetjeve. Bashkia e Pustecit duhet të përqendrohet kryesisht në realizimin e objektivave dhe afateve ashtu si ato përcaktohen në VKM nr. 418, datë 25.06.2014 "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim" të rrymave të mbetjeve për të reduktuar sasinë e mbetjeve që do të depozitohen përmes:

- optimizimit të grumbullimit të mbetjeve
- sigurimit të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve në burim
- promovimit të ripërdorimit të produkteve
- përgatitjes së veprimtarive të ripërdorimit
- përmirësimit të cilësisë së riciklimit të mbetjeve.

Gjithashtu, sipas të njëjtit vendim, përcaktohet se Njësitë e qeverisjes vendore, brenda datës 31 Dhjetor 2020, duhet që, për përgatitjen, ripërdorimin dhe riciklimin e mbetjeve të ngurta, të përfshihen letra, metali, plastika dhe qelqi) të arrijnë objektivin, minimumi në 50% të peshës së përgjithshme të mbetjeve të gjeneruara në vitin 2014.



Zhvillimi i qëndrueshëm i menaxhimit të integruar të mbetjeve nënkupton se burimet natyrore do të përdoren me efikasitet, duke nxitur zvogëlimin e gjenerimit të mbetjeve, ripërdorimin e materialeve të riciklueshme, përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë, duke shkaktuar ndikimin më të vogël të mundshëm mbi mjedisin. Shkarkimet nga objektet e trajtimit të mbetjeve dhe landfill-et, duhet të zvogëlohen maksimalisht dhe në mënyrën më eficiente në aspektin teknik dhe ekonomik.

Përsa i përket depozitimit të tyre, Bashkia Pustec nuk zotëron landfill sanitar të vetin, por i depoziton mbetjet në afërsi të vendbanimit Pustec. Prandaj propozohet një stacion transferimi që do depozitohen mbetjet dhe më pas do transferohen tek landfilli sanitar i Maliqit i cili shërben për të gjithë qarkun e Korçës. Fillimisht, rekomandohet aplikimi në nivel pilot i sistemit të grumbullimit të mbetjeve me 3 kosha, për mbetjet e riciklueshme të thata, mbetjet organike dhe mbetjet e tjera (të përziera). Pas pilotimit, fillimisht në zonat urbane, qendrat e njësive administrative dhe zonat me zhvillim turistik, do të vijojë gradualisht shtrirja e këtij sistemi në të gjithë zonat e shërbimit sipas përcaktimeve në Planin Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve.

Infrastruktura e telekomunikacionit

Bazuar tek Strategjia ndërsektoriale "Axe Dixhitale e Shqipërisë 2015-2020" teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) luajnë një rol të veçantë në zhvillimin e një ekonomie konkurruese të bazuar në njohuri dhe inovacion. Kjo teknologji mundëson sigurimin e një cilësie më të lartë të jetës për qytetarët, ndihmon në lehtësimin dhe efikasitetin e proceseve të biznesit si dhe në rritjen e efektivitetit dhe transformimin e qeverisjes. Zhvillimi i sektorit TIK konsiderohet si një politikë horizontale pasi efektet dhe ndikimet e zbatimit të tij shtrihen mbi të gjithë sektorët sociale dhe ekonomike të vendit.

Gjithashtu, Plani i Përgjithshëm Kombëtar shikon zhvillimin e infrastrukturës dixhitale dhe broadband-in si një prioritet madhor dhe propozon parashikimin e projekteve konkrete në nivel rajonal e vendor, që përfshijnë vendosjen e rrjetit me fibra optike në qytete, të cilat do t'i shërbejnë një zhvillimi afatgjatë të ekonomisë dixhitale. PPK mbështet investimet në rrjetin kombëtar të kërkimit, me qëllim të promovimit të komunikimit me shpejtësi të lartë, që lidh të gjitha institucionet e edukimit dhe institucionet kërkimore shtetërore me rrjetet më të mëdha të kërkimit ndërkombëtar.

Infrastruktura e zhvilluar e komunikimit do të ndihmojë në tërheqjen e kapitaleve fizike dhe intelektuale në vend. Infrastruktura e komunikimeve elektronike është sot një infrastrukturë e rëndësishme për të gjithë sektorët e tjerë të ekonomisë së vendit dhe i shërben zhvillimit të një ekonomie dixhitale. Parimi i shtrirjes së kësaj infrastrukture shkon në linjën e përshkruar më lart: të integrimin të korridoreve infrastrukturë. Kjo nënkupton se në hapësirat e parashikuara për infrastrukturë rrugore apo elektrike duhet të merren parasysh edhe hapësirat e nevojshme për akomodimin aktual apo në të ardhmen, të linjave të teknologjisë së inovacionit dhe komunikimit.

Konkretisht në Bashkinë e Pustecit fibrat optike janë të shtrira në nivel të pranueshëm në territorin e Bashkisë por nuk mbulojnë të gjithë zonat e urbanizuara. Ky material konsiston në zhvillimin e rrjetit informativ dhe të komunikimit në nivel lokal. Kështu janë përcaktuar akset kryesore rrugore, sheshet, parqet, qendrat urbane, zonat e banuara, etj., të cilët kanë nevojë për këtë shërbim. Për të gjitha akset kryesore rrugore të cilat do të rikonstruktohen në bazë të Planit të Veprimit dhe të parashikimeve të këtij Plani propozohet paralelisht me to të shtrihen dhe fibra optike. Me shtrirjen e

infrastrukturës së komunikimit elektronik do shërbejnë qendrat e urbanizuara si qyteti i Pustecit, qendrat e njësive administrative dhe zonat me drejtim zhvillimin ekonomik (zonat ekonomike dhe tregëtare) dhe turistik (zonat me përparësi zhvillimin turistik malor në jug dhe liqenor në veri të Bashkisë, në Zaroshkë, që është përfshirë në Programin e Integruar të Zhvillimit Rural “100 fshatrat”). Në këtë mënyrë zonat kryesore dhe dytësore të bashkisë në vijim me zhvillimin ekonomik dhe demografik do të kërkohet infrastruktura e rrjetit të telekomunikacionit e veçantë dhe e përcaktuar vetëm për këto shërbime.

2.3. Shërbimet sociale

Çështjet në fushën e mbrojtjes sociale, shërbimet e kujdesit shoqëror ekzistuese dhe ato të propozuara dhe zbutja e varfërisë janë çështje shumë më të gjera se sa vetëm mbrojtja sociale, e cila nuk lidhet vetëm me pagesat dhe me shërbimet e kujdesit shoqëror, por edhe me një gamë të gjerë politikash të tjera, duke përfshirë, në veçanti ato të lidhura me kujdesin shëndetësor dhe me arsimin. PPV-ja do të punojë ngushtë në zbatimin e strategjive ndërsektoriale, në mënyrë që të adresojë çështjet e varfërisë dhe përjashtimit social, siç është dokumenti për politikën e përfshirjes sociale.

Politikë kyçe e Mbrojtjes Sociale është përmirësimi i cilësisë së jetesës së personave me aftësi të kufizuara. Qeveria Shqiptare ka ndërmarrë një reformë të procesit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar, i cili synon të përqendrojë pagesat për personat me aftësi të kufizuar më rëndë. Objektivi i përgjithshëm i reformës është krijimi i një sistemi të përgjegjshëm të pagesave të aftësisë së kufizuar, me qëllim vlerësimin e përshkallëzuar të aftësisë së kufizuar, në varësi të shkallës së sëmundjes dhe kushteve sociale. Reforma e shërbimeve të kujdesit social do të ofrojë mbështetje për personat me aftësi të kufizuar për të mbështetur nevojat shtesë që dalin dhe kostot e tyre të mundshme.

Shërbimet e përkujdesit shoqëror luajnë një rol kyç në përmirësimin e cilësisë së jetesës të individëve, familjeve dhe komuniteteve në nevojë. Bazuar në analizën e nevojave për infrastrukturën sociale e cila përmban strukturat arsimore, shëndetësore, strukturat për përkujdesin e fëmijëve dhe të të moshuarve. Plani i Përgjithshëm propozon ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës së lartpërmendur që të shërbejë të gjithë banorëve në territorin e Bashkisë së Pustecit. Në kontekst të Planit të Përgjithshëm propozohet një drejtim me afat të shkurtër për përmirësimin e strukturës arsimore në bashki, me qëllim të shërbeje të gjithë fëmijët e bashkisë së Pustecit në nivel të lartë arsimorë. Në kuadër të përmirësimit të strukturës arsimore propozohet rikonstruksion i kopshteve në fshatrat e bashkisë, rikonstruksion i shkollave 9-vjecare në vtndbanimet e Pustecit dhe Goricës së Vogël si dhe rikonstruksion i shkollës e mesme në Pustec. Më specifikisht në kuadër të përfortimit të shërbimeve sociale propozohen projektet si më poshtë:

1. Infrastruktura arsimore

Në kontekst të forcimit të infrastrukturës arsimore, propozohen projekte për rindërtimin e objekteve shkollore ekzistuese në vendbanimet Pustec, Lajthizë, Zaroshkë, Goricë e Madhe dhe Gollomboc. Shumë nga shkollat, sot i shërbejnë një numri të vogël nxënësish, si rrjedhojë rindërtimi dhe përmirësimi i ndërtesave ekzistuese do të sjellë që ato të jenë në gjendje të plotësojnë nevojat e ardhshme të popullsisë, duke pritur një numër më të madh nxënësish dhe në një nivel më efikas. Në konkretisht, një përmirësim i vazhdueshëm në infrastrukturën sociale të Bashkisë është edhe



rindërtimi dhe sigurimi i infrastrukturës dhe pajisjeve plotësuese në njësitë arsimore konkrete, me qëllim krijimin e strukturave arsimore të nivelit sa më të lartë..

Përveç kësaj, parashikohet ndërtimi i objekteve të reja shkollore në vendbanime ku ka nevojë për shkolla të reja bashkëkohore. Më konkretisht, propozohet ndërtimi i objekteve parashkollore në vendbanimin Gollomboç. Të gjitha shkollat e reja do të ndërtohen sipas strukturave arsimore të përcaktuara dhe do të shoqërohen me objekte të përshtatshme si palestra, terrene sportive etj. Krijimi i kopshtit të fëmijëve synon rritjen e mundësive të grave të komunitetit për të punuar dhe për tu angazhuar në aktivitete ekonomike.

Së pari, në lidhje me infrastrukturën ndërtimore, objektet shkollore ekzistuese dhe jo, do të transformohen në mënyrë të përshtatshme për të përmbushur dispozitat e nevojshme të sigurisë dhe higjenes, si të personelit arsimor ashtu edhe të nxënësve. Në këtë kontekst, rindërtimi i shkollave, lidhet me përmirësimin e ndërtesave ekzistuese dhe modernizimin e pajisjeve shkollore dhe infrastrukturës logjistike të njësive shkollore. Më konkretisht, është e dëshirueshme të krijohet numri i nevojshëm i klasave në secilën njësi shkollore, si bibliotekë, klasë muzike dhe laboratorë teknologjie. Në të njëjtën kohë, është i dëshirueshëm përmirësimi i plotë i objekteve dhe aktiviteteve sportive, në të gjitha nivelet e arsimit, në përputhje me standardet ndërkombëtare të aktiviteteve fizike.

Po aq të rëndësishme janë disa ndërhyrje në shkallë më të vogël, të cilat kontribuojnë për sigurinë dhe cilësinë më të mirë të jetës. Disa nga projektet e propozuara janë riparimi i dyerve, dritareve dhe dyshemeve, heqjes së shkrimeve nga muret, vendosja dhe rehabilitimi i sistemit të ngrohjes. Ndërhyrjet e tjera kanë të bëjnë me mikro-ndërhyrje që plotësojnë infrastrukturën e ndërtimit, vendosja e kangjellave, lidhja e sistemit të kanalizimeve, ndërrimi i pllakave dhe dyshemeve të dëmtuara, mirëmbajtja, përmirësimi i mjedisit përreth, mbjelljet etj.

Përveç kësaj, theksi i veçantë është vënë në investimet në teknologji bashkëkohore. Ndër ndërhyrjet më të përgjithshme të rehabilitimit të shkollave, një pjesë e pajisjeve të reja ka të bëjë me teknologjinë bashkëkohore. Shkollat do të pajisen me kompjutera, aparatura për zyrat, pajisje audio dhe video, dërrasa interaktive dhe më shumë.

Së fundi, një parametër po aq shtrëngues për cilësinë e shërbimeve sociale në fushën e arsimit, përtej pasurimit të infrastrukturës, është shqetësimi për sigurinë. Ekzistojnë çështje të thksuara lidhur me sigurinë e nxënësve nga kriminaliteti i jashtëm, prandaj është e rëndësishme të merren masat e duhura për të kontrolluar dhe parandaluar hyrjen e njerëzve të rrezikshëm dhe tregtarëve të

drogës.

2. Infrastruktura shëndetësore

Përveç të tjerave, janë parashikuar ndërhyrje të rëndësishme në fushën e infrastrukturës shëndetësore, në kontekst të përmirësimit dhe integritetit të infrastrukturës sociale. Infrastruktura ekzistuese ka mangësi të mëdha dhe pamundësi për të plotësuar nevojat e banorëve. Për këtë arsye, propozohet rindërtimi i qendrës shëndetësore në Pustec, si dhe ndërtimi i ambulancave në vendbanimet që kanë nevojë, midis të cilave edhe në Kallamas dhe në Zaroshkë. Gjithashtu propozohet rindërtimi i qendrës shëndetësore të selisë me një sërë projektesh përmirësimi dhe nën-projektsh, si dhe mbështetja e saj me personelin e nevojshëm mjekësor.

Projektet sociale që lidhen me ndërtimin dhe përmirësimin e infrastrukturës shëndetësore kanë për qëllim krijimin e një sistemi shëndetësor efikas dhe ekonomikisht të qëndrueshëm, duke ofruar shërbime cilësore dhe të personalizuar për qytetarët dhe duke u fokusuar në përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve të parandalimit dhe të kujdesit. Në veçanti, përfshihet krijimi i njësive të specializuara shëndetësore dhe të kujdesit të hapur, i cili do të mbështetet nga pajisje të specializuara, si dhe modernizimi dhe përmirësimi operacional i ambulancave ekzistuese.

Projektet për përmirësimin e infrastrukturës shëndetësore kanë të bëjnë me përmirësimin e stokut të ndërtesave ekzistuese, furnizimin me pajisje dhe mbështetjen me personel për të ofruar shërbimet e nevojshme shëndetësore. Më konkretisht, në kontekstin e përmirësimit të objekteve, parashikohen punime në brendësi të ndërtesave për amortizimet e shumta si dhe funksionimin e normal të mjeteve elektromekanike. Kategoritë kryesore të ndërhyrjeve janë shtrimi i dyshemeve, veshjet e mureve, ndërtimi i tavaneve të varura, rinovimi i sistemit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve dhe të tjera. Po aq i rëndësishëm është furnizimi i plotë i ambulancave me të gjitha pajisjet e nevojshme mjekësore, mekanike dhe jo-mekanike.

Zbatimi i projektit siguron funksionimin bashkëkohor dhe të sigurtë të ambulancave, ekzistuese dhe të reja, dhe qendrës shëndetësore në aks drejt përmirësimit të efikasitetit të sistemit shëndetësor.

3. Kënde lojërash dhe parqe argëtimi

Përfundimisht, në drejtim të ofrimit të një rrjeti të integruar të infrastrukturave dhe objekteve sociale për Bashkinë, një aspekt veçanërisht i rëndësishëm është ndërtimi i mjediseve të hapura për argëtim dhe kënde lojërash në zona të ndryshme urbane në të gjithë territorin e Bashkisë. Konkretisht, ndërhyrje të tilla propozohen në Pustec dhe në Zaroshkë.

Ndërkohë që një komunitet zhvillohet, rivitalizohet dhe ndryshon, hapësirat publike urbane mund të sigurojnë një lidhje të përhershme midis identitetit të komunitetit dhe funksioneve evoluese të vendbanimeve. Është një faktor shtypës në kuadrin e rindërtimit dhe rigjallërimit të pëlurës urbane, pasi parqet dhe këndet e lojërave forcojnë strukturën shoqërore. Në të njëjtën kohë, promovohen aktivitete alternative, lëvizja e këmbësorëve dhe një rrymë e re vizitorësh. Hapësirat që do të zhvillohen në Bashki janë planifikuar të përfshijnë elementin e gjelbër, duke përmirësuar cilësinë e mjedisit si estetikisht edhe ekologjikisht.

Parqet dhe këndet e lojërave që do të krijohen, do të karakterizohen nga shtigje për ecje, mjedise çlodhje dhe rekreacioni, ndërsa disa sugjerime përfshijnë objekte të aktiviteteve të tjera të kohës së lirë. Përveç kësaj, këndet e lojërave do të jenë të pajisura me lodra të certifikuar (kolovajse, rrëshqitës, rrotullues, vegla të përbëra, etj), shtroje sigurije, gardhe të përshtatshme dhe të tjera. Gjithashtu, një nga nënprojektet e përfshira në përmirësimin e mjediseve të hapura publike ka të bëjë me vendosjen e elementeve si stola dhe bangove.

Parqet e çlodhjes dhe këndet e lojërave të Bashkisë do të jenë të hapura dhe të arritshme nga të gjithë qytetarët, dhe qasja do të sigurohet nga të gjitha zonat. Ato pritet të presin veprime pilot, inovative dhe ciklike (ripërdorim, ndarje në burim, rimëkëmbje materiale, energji, autonomi energjetike, bashkëjetesë industriale) së bashku me promovimin e aktiviteteve të vizitorëve në natyrë (lojra, rekreacion i butë) dhe shtigjeve për shëtitje dhe biçikleta.



4. Krijimi i Shesheve në Zonat Urbane

Përveç kësaj, në kuadër të hapësirave publike të hapura në Bashki, propozohet krijimi i shesheve në vendbanime. Në mënyrë të veçantë, projekti është propozuar si një parametër bazë i rivitalizimit urban të Bashkisë dhe lidhet me vendbanimet Lajthizë, Diellas, Cerje, Goricë e Madhe dhe Kallamas. Si një pjesë përbërëse e zhvillimit të infrastrukturës sociale, sheshet do të veprojnë për çdo vendbanim, si një zonë qendrore e përqendrimit të shërbimeve dhe aktiviteteve dhe si një pikë referimi. Për më tepër, do të lidhin një qendër energjitike të përdorimeve të përziera me zonat e banimit, duke u ndarë nga përdorimet komerciale të qendrës së qytetit. Me dizajnin dhe vendodhjen e duhur, do të jenë të arritshëm nga të gjitha zonat dhe do lidhen me shtigjet e këmbësorëve dhe të biçikletave atje ku ato ekzistojnë. Gjithashtu është e rëndësishme që të unifikohen të gjitha hapësirat publike të çdo vendbanimi me njëra-tjetrën. Mjedisi i hapur do të organizohet dhe do të pajiset në mënyrë të përshtatshme me pajisjet urbane të nevojshme, ndërsa do të realizohen mbjelljet e pemëve për të siguruar që të mos mungojë elementi i gjelbër.



3. PLANI I MBROJTJES SË MJEDISIT

Bazuar në strategjinë për zhvillimin e qëndrueshëm të Bashkisë, propozohet Plani i Mbrojtjes së Mjedisit (PMM). PMM do të jetë një mjet i dobishëm për qasjen e integruar të çështjeve kritike mjedisore, të analizuara dhe të vlerësuara gjatë fazave të mëparshme (peizazhi, mjedisi i ndjeshëm natyror dhe kulturor, zonat e gjelbra, ajri, burimet ujore, hotspot) dhe për arritjen e objektivave mjedisore siç përcaktohen nga kornizat dhe strategjitë gjithëpërfshirëse. Masat e propozuara përbëjnë një kornizë udhëzuese për menaxhimin e ndikimeve negative që do të lindin gjatë rrjedhës së zhvillimit të Bashkisë dhe jo një listë shteruese e masave për adresimin dhe zbutjen e ndikimeve mjedisore nga çdo ndërhyrje dhe projekt individual. Masat më të hollësishme do të përfshihen në studimet e VNM që do të përgatiten për çdo projekt të veçantë, gjatë fazës së licencimit.

3.1. Trajtimi i ndikimeve në ajër

Burimet kryesore të ndotjes së ajrit pritet të jenë:

- transporti, kryesisht në aksin rrugor SH79 dhe së dyti në aksin SH79-Cerje, i cili pritet të shtohet për shkak të rritjes së fluksit të vizitorëve dhe turistëve.
- djegia e druve për ngrohje ose prodhimi i energjisë. Nevojat për ngrohje do të rriten si rezultati i rritjes së banorëve të përhershëm dhe vizitorëve, por edhe për shkak të përmirësimit të pritur të standardit të jetesës.

Sfidat dhe prioritetet kryesore për parandalimin e ndotjes së ajrit nga të gjitha burimet e më sipërme janë:

- Përfundimi i miratimit dhe zbatimit të standardeve evropiane për cilësinë e ajrit në nivel kombëtar.
- Krijimi dhe funksionimi i një sistemi të monitorimit të cilësisë së ajrit në nivel lokal (ose edhemëefektiv për tejkufijve).
- Promovimi i mobilitetit të qëndrueshëm, duke përfshirë përdorimin e biçikletave sa më shumë që të jetë e mundur dhe lëvizjen e sigurt dhe tërheqëse të këmbësorëve për mes një rrjeti të këmbësorëve.
- Nxitja e burimeve të ri për të ritshme të energjisë në një shkallë të vogël që do të përshtaten me mjedisin edhe në dhe peizazhin dhe kanë përfitimet e shumta: kursime parash për banorët, një mjedis më të pastër, identitet të fortë bashki. Kështu, është propozuarin stalimi i një parku fotovoltaik dhe e olik të vogël për prodhimin e energjisë për përdorim të brendshëm, plotësimin e nevojave të banorëve.
- përmirësimi i transportit publik.
- reduktimi i udhëtimeve të pa nevojshme duke përmirësuar dhe zhvilluar infrastrukturën elektronike për trajtimin në distancë të çështjevetë qytetarëve.
- pyllëzimi, mbjellja dhe krijimi i hapësirave të gjelbra.
- kontrolli i materialeve të djegies për ngrohje dhe informacioni përkatës i banorëve.
- prodhimi dhe përdorimi i zëvendësues vetë lëndës djegëse të biomasës, të tilla si briketat nga kallamat, të cilat janë të disponueshme për menaxhimin e qëndrueshëm të Parkut Kombëtar.



3.2. Trajtimi i ndikimeve në ujëra

Burimet ujore pritet të ndikohen negativisht nga: promovimi i agroturizmit, ekoturizmit, rekreacionit dhe zhvillimi i prodhimit bujqësor.

Intensifikimi i konsumimit të ujit nga zhvillimi i aktiviteteve të turizmit dhe agroturizmit, rezulton nga vaditja në njësitë e agroturizmit, si dhe konsumi i ujit të pijshëm që do të përdoret nga turistët dhe shërbimet që do të ofrohen nga të gjitha njësitë turistike. Për ujitjen, mund të zbatohen masat e renditura më poshtë për sektorin primar. Për ujin e pijshëm, efektiv është reduktimi i konsumit të tij nëpërmjet zbatimit të sistemeve të kursimit p.sh. në mjediset sanitare, në kuzhinë etj. Gjithashtu është i dobishëm sensibilizimi i vizitorëve me informacion të kujdesshëm, me vendosjen e tabelave në dhoma etj., në mënyrë që të mos e shpërdorim ujit që përdorin. Rëndësia veçantë ka mbrojtja dhe mbikëqyrja strikte e zonave ujore të cilat disponojnë kushtet e përshtatshme për riprodhimin e organizmave ujorë.

Intensifikimi i konsumit të sasive të mëdha të ujit për vaditje nga fuqizimi i prodhimit primar, mund të parandalohet kryesisht me anë të:

- Zbatimit të një plani për menaxhimin e qëndrueshëm të ujit për vaditje.
- Mbështetjes të fermerëve nga agronomë dhe punonjës të tjerë shkencorë, për të zgjedhur kulturat që nuk kërkojnë sasi të mëdha ujitje.
- Ndërtimit të rrjeteve moderne të ujitjes kolektive, për të minimizuar sasinë e ujit për ujitje, të humbur përmes avullimit dhe për të maksimizuar efikasitetin e sistemeve të ujitjes (p.sh. vaditja e bimëve direkt në rrënjë).
- Mirëmbajtjes dhe përmirësimit të lagunave dhe digave, për të minimizuar abstraksionin e ujërave nëntokësore.
- Kontrollit të shpimeve të puseve nga fermerët, në mënyrë që të realizohet një plan realist i menaxhimit të ujit për vaditje.

3.3. Trajtimi i ndikimeve në peizazh

Peizazhi nuk pritet të ndikohet negativisht nga programi i propozuar i punës pasi të gjitha ndërhyrjet janë të përmasave të vogla dhe kanë të bëjnë kryesisht me përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese. Rrugët e reja dhe ndërtesat e reja janë të kufizuara në numër dhe madhësi dhe kanë të bëjnë me zonat e banuara. Stacioni kufitar, impiantet e trajtimit të ujërave të zeza dhe fermat blegtorale pritet të ndikojnë më shumë. Megjithatë, të gjitha janë të vendosura në zona të përshtatshme në përputhje me Planin e Menaxhimit të Parkut Kombëtar, ndërsa kihet parasysh dhe jepen udhëzime për zbatimin e objekteve alternative dhe miqësore me mjedisin dhe zbatimin i masave të arkitekturës bioklimatike dhe metabolizmit ciklik.

Peizazhi urban do të përmirësohet në mënyrë të konsiderueshme përmes aplikimit të PPV dhe në veçanti nëpërmjet rigjenerimit, krijimit të hapësirave të lira publike dhe të gjelbra, mbjelljes përgjatë rrugëve, përmirësimit të ndërtesave të caktuara (p.sh. shkolla, ambulanca) dhe masave për mbrojtjen dhe monitorimin e gjendjes mjedisore të liqenit të Prespës së Madhe. Ndërhyrje me ndikime pozitive në peizazhin më të gjerë janë ripyllëzimi me specie vendase që mund të rriten në kushtet e dhëna, promovimi i Brezit të Gjelbër Evropian dhe kryesisht ruajtja dhe krijimi, aty ku mungojnë, të zonave të përrenjve dhe liqenit. Bëhet fjalë për një zonë kritike me rol

shumëfunktional pasi kontrollon inputet (përbërsit ushqyes dhe sedimenteve) që përmirësojnë cilësinë e ujit, mbron tokën nga erozioni dhe ndotja, kontribuon në mbrojtjen nga përmytjet, ndihmon në përmirësimin e mikroklimës dhe cilësisë së ajrit dhe vepron si një habitat për faunën dhe në përgjithësi si një bio-korridor.

Mbrojtja e natyrës së Bashkisë do të lehtësohet dhe përmirësohet nëpërmjet krijimit të monopateve dhe korridoreve për këmbësorët dhe çiklistët, vendosjen e tabelave informuese dhe funksionimi i integruar i qendrave të informacionit dhe informimit

Gjithashtu, peizazhi duhet të jetë një parametër i veçantë dhe i rëndësishëm gjatë licensimit mjedisor të projekteve në zona të veçanta.

3.4. Parashtrimi i varianteve për zgjidhje të problematikes të hotspot-eve

Në Bashkinë Pustec, pikat kryesore të nxehta (pika të nxehta) kanë lidhje me reshjet e shumta dhe të dendura, përmytjet dhe shfaqjes së brejtësve. Këto fenomene kanë një ndikim të rëndësishëm në mjedis, ekonomi dhe shoqëri pasi degradojnë cilësinë e jetës dhe rrezikojnë shëndetin e banorëve, dëmtojnë cilësinë e tokës dhe çojnë në ndryshimin e peizazhit.

Rënia e borës

Rëniet e dendura të dëborës çojnë në një sërë problemesh (të tilla si ndërprerje të furnizimit me energji elektrike dhe ujë, jit, pamundësia për të lëvizur e brenda vendbanimeve), të cilat pengojnë në masë të madhe jetën të përditshme të banorëve. Gjithashtu rrezikon shëndetin publik, pasi temperaturat e ulëta mund të jenë një shkak i vdekjes, si edhe të ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme dhe në aktivitetin bujqësor dhe blegtoral, me shembull karakteristik shkatërrimin e kulturave bujqësore. Më poshtë përmenden masat për parandalimin dhe trajtimin e reshjeve të dëborës:

- Përmirësimi i rrjetit rrugor ekzistues dhe përmirësimi i lidhjes së vendbanimeve me aksin rrugor kryesor SH79
- Restaurim dhe modernizimi rrjeteve të furnizimit me ujë.
- Zhvillimi i sistemeve paralajmëruese në rast të kushteve të rrezikshme të motit. Informimi mund të bëhet për mes televizionit dhe spoteve radiofonike, tabelave sinjalizuese paralajmëruese elektronike përgjatë aksit rrugor dhe mesazheve paralajmëruese në përmjet operatorëve celularë.
- Informimi dhe edukimi i qytetarëve në lidhje me vetë-mbrojtjen, menaxhimin e duhur dhe trajtimin e rasteve të rreshjeve të dendura të dëborës
- Marrja e masave parandaluese nga organet kompetente për menaxhimin e tërëzshmërisë dhe mbrojtjes së banorëve (për të siguruar objektet e cilat mund të dëmtohen nga kushtet ekstreme të motit, veprime nga makina borë-pastruese etj).

Përmytje

Përmytjet janë një problem i madh për Bashkinë. Kanë një ndikim negativ në shëndetin e njeriut, në mjedisin më të gjerë dhe në aktivitetet ekonomike. Ato çojnë në një përkeqësim të vlerës së tokës dhe produktivitetit bujqësor të Bashkisë. Përveç kësaj, ato kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në burimet e turizmit për shkak të dëmtimit të tokës dhe infrastrukturës. Mëposhtë përmenden ndërhyrjet që do të ndihmojnë në eliminimin e efekteve të fenomenit:



- Ndërtimi i projekteve të infrastrukturës siç janë projektet e mbrojtjes nga përmbytjet.
- Zhvillimi i rrjetit rezidencial në zonat e përshtatshme që nuk janë në rrezik të përmbytjeve.
- Informimi dhe edukimi i banorëve për menaxhimin dhe përbalimin e përmbytjeve.
- Mbikëqyrja dhe kontrolli për menaxhim dhe parandalim të duhur në zonat e prirura për ngjarjet e përmbytjeve.
- Planifikimi duhur i projekteve në zonat me rrezik të përmbytjes.

Brejtësit

Shfaqja e brejtësve rrezikon shëndetin publik, pasi ata mbajnë një numër patogjenësh, baktere dhe mikrobe të tjera që mund të transmetohen tek njerëzit. Kështu, ekziston një nevojë urgjente për t'i monitoruar ato në mënyrë që të parandalohet rreziku në kohë. Veprime të tilla arrihen nëpërmjet:

- inventarizimit të popullsisë së tyre.
- Monitorimi i zakoneve të tyre dhe kontrollimi i vazhdueshëm i pikave të jetesës dhe shpërhapjes së tyre.
- Marrja e mostrave për të zbuluar patogjenët në kohën e duhur dhe për të eliminuar popullsinë infektive të tyre
- Informimi i banorëve dhe marrja e masave për mbrojtjen e shëndetit publik
- aplikimi i masave të veçanta për mbrojtjen kundër insekteve (rrjeta kundër mushkonjave, mizave).

Së fundi, vlen të përmendet se masat e sipërpërmendura për zonat e nxehta duhet të specializohen dhe të përshtaten me kushtet e veçanta të bashkisë. Gjithashtu parametër i rëndësishëm është roli dhe përgjegjësitë për çdo veprim që kërkohet të jetë shpërndarë në mënyrë të qartë, pa mbulime dhe konflikte.

3.5. Parashikimet për shtimin dhe/ose zgjerimin e hapësirave të gjelbra

Masat dhe ndërhyrjet për shtimin dhe/ose zgjerimin e hapësirave të gjelbra përfshijnë:

- Mbjelljen e pemëve të përshtatshme në zonat e përbashkëta të të gjitha vendbanimeve.
 - Krijimin e zonave të reja të gjelbra dhe përmirësimi i atyre ekzistuese.
 - Formimi i elementëve të rinj pemësh dhe zëvendësimi i atyre ekzistuese me të reja përgjatë rrugëve, kryesisht me pemë që nuk mund të përdoren si dru zjarri. Një shembull tipik është pema që i përkasin gjinisë së blirit, e cila në të njëjtën kohë krijon kushte ideale edhe për zhvillimin e bletarisë.
- Promovimi dhe rizhvillimi i plazheve në liqen, të lidhura me njëri-tjetrin nga një rrjet i propozuar i platformash. Në kuadër të këtyre zonave ndërhyrjet do të jenë të kufizuara në mënyrë që të mos ndryshohet karakteri i tyre natyror, dhe do të kufizohen me monopate dhe shtigje këmbësorësh, duke krijuar hapësira të gjelbra, pemë dhe pajisje shërbimi për mysafirë-përdorues të hapësirës (p.sh. stola, tabela sinjalizuese informative, rregullime pikashshikim dhe pamjeje pikëpamje shikimi).
- Rizhvillim të zonave të degraduara ose për shkak të aktivitetit njerëzor (deponi mbetjesh, kullotje) ose për shkak të shkaqeve natyrore (vërshime, përmbytje), duke kontribuar në përmirësimin dhe promovimin e zonës dhe për të mbrojtur atë nga përmbytjet dhe erozioni i tokës.



- Ripyllëzime në zona të veçanta të degraduara me lloje endemike të pemëve dhe bimëve karakteristike të vendit.
- Forcimi i zonave ripariane të përrenjve dhe bregut të Liqenit të Madh të Prespës.

Qëllimi i këtyre masave është përmirësimi estetik i peizazhit urban dhe rural, krijimi i aktiviteteve të reja rekreative dhe zhvillimi i aktiviteteve të kohës së lirë, përmirësimi i kushteve të mikroklimës dhe mjedisore, rritja e shëndetit mendor dhe fizik të banorëve, rritja e biodiversitetit dhe pasurimi i aquiferit.

3.6. Konkluzion për trajtimin e ndikimeve mjedisore të propozimeve të Planit

Zbatimi i masave të përmendura më lart do të kontribuojë në menaxhimin e integruar të problemeve mjedisore të identifikuara në Bashki dhe në përmirësimin e gjendjes së përgjithshme të mjedisit dhe cilësinë e jetës . PMM rekomandon që ajo kornizë, së bashku me rekomandimet e VSM, të cilat Bashkia duhet t'i marrë në konsideratë në përgjithësi dhe Vlerësimet e Ndikimit në Mjedis, në veçanti, që do të përgatiten në të ardhmen për projekte të ndryshme të propozuara të infrastrukturës teknike dhe sociale, ose për projekte zhvillimore në Bashki, të jenë më efektive në identifikimin, parashikimin dhe vlerësimin e ndikimit mjedisor të projekteve si dhe në formulimin e masave për adresimin e tyre.



4. PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E PPV-SË

4.1. Plani i Veprimit

4.1.1. Zhvillim e njësive strukturore sipas prioritetit

Prioritetet e zhvillimit të njësive strukturore ndahen në tre kategori: i lartë, i mesëm dhe i ulët dhe ka në të bëjë me:

- a. zonat dhe elementët me rëndësi kombëtare, siç për shkruhet në kapitullin 1.4 më lart. Si rrjedhim, nëse i përkasin këtyre zonave ose përmbajnë elementë të tillë, prioriteti është i lartë.
- b. zonat e zhvillimit kryesor ekonomik dhe urban, siç përshkruhet në kapitullin 1.4 më lart. Nëse ato përfshihen të rëndësishme ose pjesërisht, përparësia e tyre e zhvillimit është e lartë.
- c. mënyrën e zhvillimit të tyre. Nëse propozohet të bëhet përmes PDV, prioritet është i lartë.
- d. projektet që kryhen bazuar në Planin e Veprimeve. Njësitë strukturore që nuk janë klasifikuar bazuar në kriteret e mëparshme si të prioritetit të lartë: kanë prioritet zhvillimi të lartë kur projektet i përkasin fazës së parë edhe të dytë, prioritet të mesëm kur projektet i përkasin fazës së tretë dhe prioritet të ulët, kur projektet i përkasin fazës së katërt.

Vërehetse lloji i zhvillimit përcaktohet nga mënyra e ndërhyrjes.

4.1.2. Infrastruktura publike

Pjesa më e madhe e Planit të Veprimeve përbëhet nga ndërhyrjet në infrastrukturën publike, të cilat kanë të bëjnë me të gjitha rrejet kryesore, si infrastrukturën teknike edhe atë sociale. Në vijim paraqitet lloji i ndërhyrjes së propozuar.

- Rrjeti I transportit
- Rikonstruksioni i rrugëve ekzistuese, me veprime të tilla si përmirësimin e karakteristikave gjeometrike (p.sh. zgjerim, ndërtim të anëve mbështetëse), mirëmbajtjen, shtrimin me asfalt, ndriçimin, sistemim etj. Për sa më sipër propozohet:
 - Rikonstruksioni dhe përmirësimi i 12 seksioneve rrugore.
 - Përmirësimi i kryqëzimeve të rrugës SH79.
- Ndërtim I rrugëve të reja për shmangie të kalimit nga Pusteci.
 - Krijimin e rrugëve të përshtatshme për levizjen e biçikletave dhe këmbësorëve dhe zhvillimin/forcimin e transportit brenda vendbanimeve. Më specifikisht, propozohet:
 - Përshtatje e rrjetit rrugor (sinjalistika horizontale dhe vertikale) dhe krijimi i rrugëve brenda Parkut Kombëtar për qarkullimin e biçikletave.
 - Krijimi i itinerarit për këmbësorë anës liqenit dhe ndërtim i shëtitores përgjate rrugës lidhëse të plazhit.
 - Krijim i rrjetit të transportit publik që do shërbejë të gjitha zonat e urbanizuara.
- Organizimin të trafikut në qendrën e Bashkisë, me qëllim që ti shërbejë në mënyrë optimale përdorimeve të tokës/aktiviteteve dhe të përmirësojë kohën dhe cilësinë e lëvizjeve dhe të promovojë lëvizshmërinë e qëndrueshme. Përveç kësaj, vëmendje i kushtohet promovimit të rregullave dhe planifikimit për të lehtësuar lëvizjen e këmbësorëve, çiklistëve, fëmijëve dhe grupeve vulnerabël duke përfshirë dhe personat me aftësi të kufizuar për shërbimin e nevojave të tyre të përditshme.

- Rrjeti i ujësllësit
 - a. Ndërtim i rrjeteve të reja dhe bashkëkohore të ujësllësit, të brendshme dhe të jashtme, që mbulojnë gjithë vendbanimet.
 - b. Ndërtimi i puseve për sigurim të sasive të mjaftueshme për ujë të pijshëm.
- Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza
 - a. Ndërtim i njësive të përpunimit t[ujërave të zeza i cili do të mbulojë nevojat e gjithë vendbanimeve.
 - b. Rikonstruksion – zgjerim i rrjetit KUZ në Zaroshkë.
- Rrjeti i ujitjes
 - a. Ndërtimi i rrjetit të kanaleve vaditës në pjesën e prishur si dhe rikonstruksioni i pjesës së dëmtuar.
- Rrjeti i energjisë elektrike
 - a. Ndërtim i rrjetit të ri të transmetimit të energjisë elektrike në Bashki.
 - b. Rrjeti i telekomunikacionit
 - c. Përmirësim i rrjetit ekzistues i telekomunikacionit, me qëllim që të mbulohen gjithë vendbanimet si edhe polet e zhvillimit turistik.
 - d. Ndërtim i rrjetit të fibrave optike përgjatë rrjetit kryesor rrugor që do të lidhë gjithë vendbanimet dhe polet e zhvillimit turistik.
- Rrjeti i menaxhimit të mbetjeve
 - a. Ndërtim i stacionit të ngarkimit të mbetjeve.
 - b. Zbatimi i programit të riciklimit.
- Rrjeti i arsimit
 - a. Ndërtimi i kopshtit në Gollomboc.
 - b. Rikonstruksioni i shkollës në fshatra të ndryshme.
- Rrjeti i shëndetësisë
 - a. Rikonstruksion e qendrës shëndetësore në Pustec.
 - b. Ndërtimi i ambulancave nëpër fshatra.
- Rrjeti i kulturës
 - a. Ndërtimi i qendrës kulturore në Pustec.
 - b. Restaurimi i shtëpisë së shkrimtarit Sterjo Spase dhe kthimi i saj në muze.
 - c. Rikonstruksion i Muzeut të Vatrës së Luftës.
- Rrjeti sportiv
 - a. Përmirësim i ambjenteve sportive në fshatin Goricë e Vogël.
 - b. Ndërtimi i hapësirave sportive në Pustec dhe Zaroshkë.
- Rrjeti i ambjenteve të gjelbërta
 - a. Ndërtim i hapësirave të gjelbëruara në Pustec dhe Zaroshkë.



4.1.3. Projekte prioritare / Pilote të zhvillimit

Nr. rendor	Titulli	1.	Organizimi i bregut liqenor në Zaroshkë
Tipologjia		Turizëm	
Vendndodhja e projektit		Zaroshkë	
Përshkrim i shkurtër		Kthimi i vijës liqenore në plazh të frekuentueshëm nga implementimi i tij. / Sinjalistika e tabelave informuese. Vendosje e koshave të mbeturinave. Projekt në kuadrin e "PIZHR-100 fshatra". Krijimi i shtigjeve të këmbësorëve dhe biçikletave. / Gjatësia rreth 1.8 km.	
Qëllimi kryesor dhe rëndësia		Konsolidimi i atraksionit dhe ekonomisë së zonës. Atraksioni i turistëve.	
Në përputhje me:	Objektivi Strategjik	OS1: Rritje e konkurrencës së destinacioneve turistike alternative OS3: Zhvillim i qëndrueshëm i zonave të urbanizuara	
	Programi Strategjike	PS 1.1 Hartim dhe zbatim i politikave për promovimin e turizmit. PS 3.3 Rigjenerim të zonave urbane	
Kodi i Programit (sipas kategorizimit të COFOG-ut)		041 - Çështjet e përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës	
Sistemi territorial që ndikohet		Nuk preken sistemet territoriale.	
Kosto e përafërt		10,000,000 ALL	
Burimet e mundshme të financimit		Bashkia / FSHZH / Donatorë të ndryshëm	
Treguesi i vlerësimit/ ndjekjes		Përfundimi i projektit/ Rritja e vizitueshmërisë dhe e aktiteteve në zonë.	
Palët e interesuara (partnerët)		Bashkia	
Gatishmërinë e projektit për zbatim		Projekt Ide	
Veprimet për implementimin e ty		Hartimi i Studimit	
Kohëzgjatja		4 Muaj	
Fazat e Zbatimit	I: 2020	X	
	II: 2021-2022		
	III: 2023-2029		
	IV: 2030-2034		
Avantazhet/ Rezultatet e pritshme		Rritje e numrit të turistëve. Promovim i pasurisë natyrore të zonës. Rigjallërim i zonës.	
Rreziqe të mundshme		Pamundësi për përfundimin e projektit. Vonesa për shkak të vizitueshmërisë së lartë.	
Ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore		Nuk ka nevojë për ndryshime.	



Nr. rendor	Titulli	2.	Sistemim urban i Zaroshkës
Tipologjia		Zhvillim urban - turizëm	
Vendndodhja e projektit		Zaroshkë	
Përshkrim i shkurtër		Rikualifikimi dhe përmirësim e qendrës. Përmirësim dhe krijim i hapësirave publike, psh. sheshe dhe kënde lojërash për fëmijë. Rritje e gjelbërimit në zonë. Vendosi e ndriçimit, stolave dhe vargjeve të pemëve. Shtrim me asfalt dhe ndriçim i rrugëve kryesore të brendshme. Shtrim me gurë dhe rregullim i trotuarëve. Përmirësim i hyrjes në fshat.	
Qëllimi kryesor dhe rëndësinë		Përmirësimi i cilësisë së jetës. Rritja e vizitueshmërisë dhe e aktiteteve në zonë. Promovim i trashëgimisë natyrore dhe kulturore.	
Në përputhje me:	Objektivi Strategjik	OS1: Rritje e konkurrencës së destinacioneve turistike alternative OS3: Mbështetje e zhvillimit të qëndrueshëm të zonave të urbanizuara	
	Programi Strategjike	PS 1.1 Hartim dhe zbatim i politikave për promovimin e turizmit PS 3.2 Përmirësim dhe modernizim i infrastrukturës inxhinierike PS 3.3 Rigjenerim të zonave urbane	
Kodi i Programit (sipas kategorizimit të COFOG-ut)		062 - Zhvillimi i komunitetit	
Sistemi territorial që ndikohet		Preken sistemet territoriale.	
Koston e përafërt		40,000,000 ALL	
Burimet e mundshme të financimit		Bashkia / FSHZH / Donatorë të ndryshëm	
Treguesi i vlerësimit/ ndjekjes		Përfundimi i projektit/ Vizitueshmëri më të madhe	
Palët e interesuara (partnerët)		Bashkia	
Gatishmërinë e projektit për zbatim		Projekt Ide	
Veprimet për implementimin e ty		Hartimi i Studimit, Ndërtimi i Projektit	
Kohëzgjatja		6 Muaj	
Fazat e Zbatimit	I: 2020	X	
	II: 2021-2022		
	III: 2023-2029		
	IV: 2030-2034		
Avantazhet/ Rezultatet e pritshme		Përmirësimi i mjedisit jetësor të banorëve. Përmirësim i infrastrukturës rrugorë. Përmirësim i imazhit dhe funksionimit të vendbanimeve. Rritja e vizitueshmërisë. Mundësi për të zhvilluar mundësi dhe vende të reja pune.	
Rreziqe të mundshme		Pamundësi për përfundimin e projektit. Degradim për shkak të vizitueshmërisë së lartë. Funksionim konkurrues ndaj hapësirave të reja të lira të qytetit	
Ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore		Nuk ka nevojë për ndryshime.	



Nr. rendor	Titulli	3.	Restaurim i monumentit kulturor në Maligrad dhe rehabilitim-promovim të ishullit
Tipologjia		Kulturë - Turizëm	
Vendndodhja e projektit		Ishulli i Maligradit	
Përshkrim i shkurtër		Sinjalistikë informuese në pikat e interesit. Mbështetje dhe personel i specializuar për promovimin e politikave historike dhe trashëgimisë fetare. Veprime të vazhdueshme kontrolli për mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e hapësirës dhe të gjetjeve. Përmirësim i korridorit lidhës midis molit dhe monumentit.	
Qëllimi kryesor dhe rëndësinë		Promovimi i pasurisë natyrore të zonës. Promovimi dhe konsolidimi i turizmit. Promovimi i monumenteve fetare dhe monumenteve të tjera kulturore.	
Në përputhje me:	Objektivi Strategjik	OS1: Rritje e konkurrencës së destinacioneve turistike alternative OS5: Ruajtja, mbrojtja dhe promovimi i mjedisit natyror dhe kulturor	
	Programi Strategjike	PS 1.1 Hartim dhe zbatim i politikave për promovimin e turizmit. PS 5.3. Sensibilizim mjedisor i komunitetit lokal dhe i vizitorëve	
Kodi i Programit (sipas kategorizimit të COFOG-ut)		082 -Shërbimet kulturore	
Sistemi territorial që ndikohet		Nuk preken sistemet territoriale	
Koston e përafërt		45,000,000 ALL	
Burimet e mundshme të financimit		Bashkia / FZHR / DRKK / Donatorë të ndryshëm / universitete të ndryshme të vendit dhe jashtë shtetit	
Treguesi i vlerësimit/ ndjekjes		Përfundimi i projektit/ Vizitueshmëri më të madhe	
Palët e interesuara (partnerët)		Bashkia / DRKK / Universitete	
Gatishmërinë e projektit për zbatim		Projekt Ide	
Veprimet për implementimin e tyre		Hartimi i Studimit , Ndërtimi i Projektit	
Kohëzgjatja		1 Vit	
Fazat e Zbatimit	I: 2020	X	
	II: 2021-2022		
	III: 2023-2029		
	IV: 2030-2034		
Avantazhet/ Rezultatet e pritshme		Rritje e numrit të vizitorëve. Promovim i vlerës historike dhe fetare të monumenteve. Konsolidim i ekonomisë vendase.	
Rreziqe të mundshme		Degradim për shkak të vizitueshmërisë së lartë. Pamundësi për marrjen e masave dhe vendimeve për mirëmbajtjen dhe ruajtjen e ishullit.	
Ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore		Nuk ka nevojë për ndryshime.	



Nr. rendor	Titulli	4.	Ndërtimi i sistemit alternativ të kanalizimeve të ujërave të zeza në Pustec
Tipologjia		Zhvillim Urban	
Vendndodhja e projektit		Pustec	
Përshkrim i shkurtër		Krijimi i rrjetit të kanalizimeve me njësi përpunimi të ujërave të zeza që do të përfundojnë në facilitetet e pastrimit me procedura biologjike. Veprimet do të jenë miqësore për mjedisin.	
Qëllimi kryesor dhe rëndësinë		Konsolidimi i infrastrukturës inxhinierike/ Kushte më të mira jetese	
Në përputhje me:	Objektivi Strategjik	OS3: Mbështetje e zhvillimit të qëndueshëm të zonave të urbanizuara	
	Programi Strategjike	PS 3.2 Përmirësim dhe modernizim i infrastrukturës inxhinierike	
Kodi i Programit (sipas kategorizimit të COFOG-ut)		052 - Menaxhimi i ujërave të zeza	
Sistemi territorial që ndikohet		Nuk preken sistemet territoriale.	
Koston e përafërt		15,000,000 ALL	
Burimet e mundshme të financimit		Bashkia / Donatorë të ndryshëm	
Treguesi i vlerësimit/ ndjekjes		Përfundimi i projektit	
Palët e interesuara (partnerët)		Pustec UK sha	
Gatishmërinë e projektit për zbatim		Projekt Ide	
Veprimet për implementimin e ty		Hartimi i Studimit , Ndërtimi i Projektit	
Kohëzgjatja		6 Muaj	
Fazat e Zbatimit	I: 2020	X	
	II: 2021-2022		
	III: 2023-2029		
	IV: 2030-2034		
Avantazhet/ Rezultatet e pritshme		Cilësi e lartë jetese. Kufizim në shpërdorimin e ujërave.	
Rreziqe të mundshme		Pamundësi për përfundimin e projektit.	
Ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore		Nuk ka nevojë për ndryshime.	



Nr. rendor	Titulli	5.	Organizimi i festivalit vjetor dhe eventeve
Tipologjia		Turizëm – mjedis natyror dhe kulturor	
Vendndodhja e projektit		Bashkia Pustec	
Përshkrim i shkurtër		Riorganizimi dhe mbështetje e grupit dhe festivalit Folklorik. Organizimi i panairove për promovimin e produkteve, punimeve të grave. Promovim i dokeve dhe zakoneve të zonës dhe promovimi i produkteve vendase.	
Qëllimi kryesor dhe rëndësinë		Rivitalizimi i jetës kulturore. Zhvillimi kulturor i komunitetit. Forcimi i identitetit kulturor. Rritje e atraktiviteteve të zonës, rritje e numrit të vizitorëve	
Në përputhje me:	Objektivi Strategjik	OS1: Rritje e konkurrencës së destinacioneve turistike alternative OS5: Ruajtja, mbrojtja dhe promovimi i mjedisit natyror dhe kulturor	
	Programi Strategjike	PS 1.2 Implementim i aktiviteteve të marketingut PS 5.4. Promovim dhe mbrojtje e trashëgimisë kulturore	
Kodi i Programit (sipas kategorizimit të COFOG-ut)		082 -Shërbimet kulturore	
Sistemi territorial që ndikohet		Nuk preken sistemet territoriale.	
Koston e përafërt		13,000,000 ALL	
Burimet e mundshme të financimit		Bashkia / Donatorë të ndryshëm / Sipërmarrje private / AZHBR	
Treguesi i vlerësimit/ ndjekjes		Përfundimi i projektit	
Palët e interesuara (partnerët)		Bashkia/ Sipërmarrje private	
Gatishmërinë e projektit për zbatim		Projekt Ide	
Veprimet për implementimin e ty		Hartimi i Studimit	
Kohëzgjatja		1 Vit	
Fazat e Zbatimit	I: 2020	X	
	II: 2021-2022		
	III: 2023-2029		
	IV: 2030-2034		
Avantazhet/ rezultatet e pritshme		Rritje e prodhimit të produkteve vendase. Krijimi i organizimit të fermerëve. Krijimi i markës tregtare vendase - brand name. Vende të reja pune. Atraksion i vizitorëve. Konsolidim i ekonomisë vendase.	
Rreziqe të mundshme		Promovim dhe reklamim i pamjaftueshëm me pjesëmarrje shumë të ulët. Mungesë bashkëpunimi.	
Ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore		Nuk ka nevojë për ndryshime.	



Nr. rendor	Titulli	6.	Krijimi i sistemit të transportit publik që do t'u shërbejë të gjithë fshatrave
Tipologjia	Zhvillim Urban		
Vendndodhja e projektit	Bashkia Pustec		
Përshkrim i shkurtër	Përfshin një planifikim afatgjatë (psh. linja, orari i linjave) dhe realizim të veprave përkatëse (psh. aplikacion elektronik, stacione në vendetë caktuara). Propozohet përdorimi i autobusëve që janë miqësorë (ekologjik) ndaj ambjentit. Nëpërmjet sistemit do të realizohet lëvizja e (a) nxënësve të njësisë veriore në shkollën 9-vjeçare në Goricë e Vogël / (b) të njësisë jugore në shkollën 9-vjeçare në Pustec.		
Qëllimi kryesor dhe rëndësia	Përmirësimi i aksesueshmërisë në vendbanime. Sistemi funksional i transportit. Përmirësimi i cilësisë së jetës së banorëve. Promovimi i lëvizshmërisë së qëndrueshme.		
Në përputhje me:	Objektivi Strategjik	OS3: Mbështetje e zhvillimit të qëndrueshëm të zonave të urbanizuara OS4: Sigurimi i kohezionit social	
	Programi Strategjike	PS 3.2 Përmirësim dhe modernizim i infrastrukturës inxhinierike PS 4.5 Organizim dhe aktivizim i komunitetit	
Kodi i Programit (sipas kategorizimit të COFOG-ut)	045 -Transporti		
Sistemi territorial që ndikohet	Nuk preken sistemet territoriale		
Koston e përafërt	100,000,000 ALL		
Burimet e mundshme të financimit	Bashkia /		
Treguesi i vlerësimit/ ndjekjes	Përfundimi i projektit		
Palët e interesuara (partnerët)	Bashkia		
Gatishmërinë e projektit për zbatim	Projekt Ide		
Veprimet për implementimin e ty	Hartimi i Studimit		
Kohëzgjatja	15 Vjet		
Fazat e Zbatimit	I: 2020	X	
	II: 2021-2022		
	III: 2023-2029		
	IV: 2030-2034		
Avantazhet/ Rezultatet e pritshme	Kushte më të mira jetese dhe përmirësim i aksesit në shërbimet dhe të mirat. Marrëdhënie bashkëpunimi ndërmjet vendbanimeve. Konsolidim i ekonomisë.		
Rreziqe të mundshme	Pamundësi për përfundimin e veprave.		
Ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore	Nuk ka nevojë për ndryshime.		



Nr. rendor	Titulli	7.	Ndërtimi i rrjetit të moleve
Tipologjia		Turizëm	
Vendndodhja e projektit		Pustec, Ishulli Maligradit, Zaroshkë, Gollomoboç, Goricë e Vogël	
Përshkrim i shkurtër		Ndërtimi i moleve me qëllim lidhjen e vendbanimeve ndërmjet tyre në përmjet liqenit. Ekzekutimi i linjave me varka. Shfrytëzimi i tyre për aktivitete turistike, duke theksuar njëkohësisht pasurinë natyrore të zonës.	
Qëllimi kryesor dhe rëndësinë		Konsolidimi i aktivitetit turistik, atraksioni i vizitorëve dhe promovimi i aseteve natyrore.	
Në përputhje me:	Objektivi Strategjik	OS1: Rritje e konkurrencës së destinacioneve turistike alternative OS4: Sigurimi i kohezionit social	
	Programi Strategjike	PS 1.3 Partneritetet rajonale për ndërlidhjen e zonave turistike PS 4.5 Organizim komunitar i aktivizuar	
Kodi i Programit (sipas kategorizimit të COFOG-ut)		041 - Çështjet e përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës	
Sistemi territorial që ndikohet		Nuk preken sistemet territoriale	
Koston e përafërt		15,000,000 ALL	
Burimet e mundshme të financimit		Bashkia /	
Treguesi i vlerësimit/ ndjekjes		Përfundimi i projektit	
Palët e interesuara (partnerët)		Bashkia	
Gatishmërinë e projektit për zbatim		Projekt Ide	
Veprimet për implementimin e ty		Hartimi i Studimit , Ndërtimi i Projektit	
Kohëzgjatja		4 Muaj	
Fazat e Zbatimit	I: 2020	X	
	II: 2021-2022		
	III: 2023-2029		
	IV: 2030-2034		
Avantazhet/ Rezultatet e pritshme		Krijimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit. Konsolidimi i ekonomisë.	
Rreziqe të mundshme		Pamundësi mirëmbajtjeje dhe kontrolli.	
Ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore		Me shumë mundësi kërkohet ndryshimi i legjislacionit në lidhje me ekzekutimin e veprave dhe ushtrimin e aktiviteteve brenda liqenit.	



Nr. rendor	Titulli	8.	Krijimi i parqeve blegtorale model – të vizitueshme
Tipologjia		Zhvillim Rural – Turizëm	
Vendndodhja e projektit		Në zonën veriore të Bashkisë	
Përshkrim i shkurtër		Propozohet krijimi i një njësie blegtorale model dhe të vizitueshme në zonën jugore funksionale, me qëllim largimin e njëjësive blegtorale nga zona e banuar. Do të disponohen shërbime të përbashkëta (psh. veteriner) dhe infrastruktura (psh. të administrimit të mbetjeve). Do të jetë e vizitueshme.	
Qëllimi kryesor dhe rëndësinë		Përfundim i projektit / Rritje e numrit të faciliteteve blegtorale të vendosura në to dhe reduktim i faciliteteve të shpërndara	
Në përputhje me:	Objektivi Strategjik	OS2: Zhvillim i qëndrueshëm i sektorit bujqësor/ blegtoral	
	Programi Strategjike	PS 2.1 Përshtatje e prodhimit dhe të anëtarëve prodhues me kërkesat e tregut PS 2.2 Mbështetje e intergruar e bujqësisë dhe promovim i bashkëpunimit PS 2.3 Modernizim i infrastrukturës mbështetëse	
Kodi i Programit (sipas kategorizimit të COFOG-ut)		041 - Çështjet e përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës	
Sistemi territorial që ndikohet		Nuk preken sistemet territoriale.	
Koston e përafërt		30,000,000 ALL	
Burimet e mundshme të financimit		Bashkia / FZHR / Sipërmarrje private / Donatorë të ndryshëm	
Treguesi i vlerësimit/ ndjekjes		Përfundimi i projektit	
Palët e interesuara (partnerët)		Bashkia / OJQ / Sipërmarrje private	
Gatishmërinë e projektit për zbatim		Projekt Ide	
Veprimet për implementimin e ty		Hartimi i Studimit , Ndërtimi i Projektit	
Kohëzgjatja		2 Vjet	
Fazat e Zbatimit	I: 2020	X	
	II: 2021-2022	X	
	III: 2023-2029		
	IV: 2030-2034		
Avantazhet/ rezultatet e pritshme		Përmirësimin e kushteve të jetesës. Prodhimi më modern i blegtorisë. Përmirësim i imazhit estetik të zonës	
Rreziqe të mundshme		Pamundësi për përfundimin e projektit. Mirëmbajtje e mangët e njësisë blegtorale.	
Ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore		Nuk ka nevojë për ndryshime.	



Nr. rendor	Titulli	9.	Krijimi i fermës bujqësore model të vizitueshme dhe ndërtimi i facilitetit të përpunimit
Tipologjia		Zhvillim Rural - Turizëm	
Vendndodhja e projektit		Njësia veriore e Bashkisë	
Përshkrim i shkurtër		Propozohet zinxhir i integruari prodhimit dhe përpunimit të produkteve bujqësore të bashkisë. Ndërtim i facilitetit me qëllim standartizimin dhe përpunimin e lehtë të produkteve. Aktivitetet që do të zhvillohen do të jenë të gjitha miqësore ndaj mjedisit. Kjo arrihet nëpërmjet ripërdorimit të mbetjeve dhe përdorimit të energjisë me burime të rinovueshme dhe sistemit të ujitjes, pa ndikuar negativisht mjedisin. Gjithashtu, do të jetë e hapur për shoqërinë edhe me aktivitete trajnuese.	
Qëllimi kryesor dhe rëndësinë		Atraksioni i vizitorëve në zonë. Konsolidimi i aktivitetit bujqësor. Promovimi i formës alternative të prodhimit. Aktiviteti bujqësor do të jetë miqësor për mjedisin.	
Në përputhje me:	Objektivi Strategjik	OS2: Zhvillim i qëndrueshëm i sektorit bujqësor/ blegtoral	
	Programi Strategjike	PS 2.1 Përshtatje e prodhimit dhe të anëtarëve prodhues me kërkesat e tregut PS 2.2 Mbështetje e intergruar e bujqësisë dhe promovim i bashkëpunimit PS 2.3 Modernizim i infrastrukturës mbështetëse	
Kodi i Programit (sipas kategorizimit të COFOG-ut)		041 - Çështjet e përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës	
Sistemi territorial që ndikohet		Nuk preken sistemet territoriale.	
Koston e përafërt		13,000,000 ALL	
Burimet e mundshme të financimit		Bashkia / FZHR / Sipërmarrje private / Donatorë të ndryshëm	
Treguesi i vlerësimit/ ndjekjes		Përfundimi i projektit	
Palët e interesuara (partnerët)		Bashkia / OJQ / Sipërmarrje private	
Gatishmërinë e projektit për zbatim		Projekt Ide	
Veprimet për implementimin e ty		Hartimi i Studimit , Ndërtimi i Projektit	
Kohëzgjatja		1 Vit	
Fazat e Zbatimit	I: 2020	X	
	II: 2021-2022		
	III: 2023-2029		
	IV: 2030-2034		
Avantazhet/ Rezultatet e pritshme		Rritje e vizitueshmërisë, mbrojtja e mjedisit nëpërmjet aktiviteteve që nuk do ta rëndojnë atë. Trajnimi i aktiviteteve të prodhimit dhe përpunimit.	
Rreziqe të mundshme		Mungesa e promovimit dhe reklamimit. Pamundësia e përdorimit të mjeteve që nuk kanë ndikim pozitiv në mjedis.	
Ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore		Nuk ka nevojë për ndryshime.	



Nr. rendor	Titulli	10.	Krijimi i korsisë për biçikleta dhe sistemit të marrjes me qera të biçikletave
Tipologja		Turizëm	
Vendndodhja e projektit		Në të gjithë bashkinë Pustec	
Përshkrim i shkurtër		Kërkohet përshtatje e rrjetit rrugor (sinjalizim horizontal dhe vertikal). Krijim i korridoreve brenda Parkut Kombëtar të Prespës për qarkullimin e biçikletave. Krijim i infrastrukturës në ndihmë të funksionit të projektit me qëllim dhënien me qera të biçikletave. Promovim dhe reklamim	
Qëllimi kryesor dhe rëndësinë		Lidhje e rrjetit urban me Parkun Kombëtar. Promovim i lëvizshmërisë së qëndrueshme.	
Në përputhje me:	Objektivi Strategjik	OS1: Rritje e konkurrencës së destinacioneve turistike alternative OS3: Mbështetje e zhvillimit të qëndrueshëm të zonave të urbanizuara	
	Programi Strategjike	PS 1.1 Hartim dhe zbatim i politikave për promovimin e turizmit PS 3.3 Rigjenerimi të zonave urbane	
Kodi i Programit (sipas kategorizimit të COFOG-ut)		041 - Çështjet e përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës	
Sistemi territorial që ndikohet		Nuk preken sistemet territoriale	
Koston e përafërt		9,000,000 ALL	
Burimet e mundshme të financimit		Bashkia / Sipërmarrje private / Donatorë të ndryshëm	
Treguesi i vlerësimit/ ndjekjes		Përfundimi i projektit / Rritja e numrit të vizitorëve	
Palët e interesuara (partnerët)		Bashkia / Sipërmarrje private	
Gatishmërinë e projektit për zbatim		Projekt Ide	
Veprimet për implementimin e ty		Hartimi i Studimit, Ndërtimi i Projektit	
Kohëzgjatja		3 Muaj	
Fazat e Zbatimit	I: 2020	X	
	II: 2021-2022		
	III: 2023-2029		
	IV: 2030-2034		
Avantazhet/ Rezultatet e pritshme		Përdorim i biçikletës dhe reduktim i përdorimit të automjeteve. Konsolidim i lëvizshmërisë së qëndrueshme. Projektim i korridorit duke theksuar trashëgiminë natyrore të zonës. Rritja e vizitueshmërisë në zonë për shkak të infrastrukturës së re që do të krijohet dhe promovimi/ realizimi i aktiviteteve turistike alternative.	
Rreziqe të mundshme		Rreziku i ndikimit ose degradimit të zonave të caktuara me vlerë natyrore ose kulturore për shkak të rritjes së vizitueshmërisë ose aktiviteteve të papërputhshme. Pamundësi për përfundimin e projektit.	
Ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore		Nuk ka nevojë për ndryshime.	



Nr. rendor	Titulli	11.	Përmirësimi i cilësisë së infrastrukturës së telekomunikacionit dhe zgjerimi i rrjetit.
Tipologjia		Zhvillim Urban	
Vendndodhja e projektit		Bashkia Pustec	
Përshkrim i shkurtër		Konsolidim dhe përmirësim i efikasitetit të shërbimeve të infrastrukturës së telekomunikacionit. Përbushje kërkesave dhe sfidave të klientëve.	
Qëllimi kryesor dhe rëndësinë		Përmirësim i aksesit dhe cilësisë së telekomunikacioneve	
Në përputhje me:	Objektivi.Strategjik	OS3: Mbështetje e zhvillimit të qëndrueshëm të zonave të urbanizuara	
	Programi Strategjike	PS 3.2 Përmirësim dhe modernizim i infrastrukturës inxhinierike	
Kodi i Programit (sipas kategorizimit të COFOG-ut)		106 - Strehimi dhe komoditetet e komunitetit	
Sistemi territorial që ndikohet		Nuk preken sistemet territoriale.	
Koston e përafërt		10,000,000 ALL	
Burimet e mundshme të financimit		Bashkia / Sipërmarrje private / Donatorë të ndryshëm	
Treguesi i vlerësimit/ ndjekjes		Përfundimi i projektit / Rritja e numrit të vizitorëve	
Palët e interesuara (partnerët)		Bashkia / Sipërmarrje private	
Gatishmërinë e projektit për zbatim		Projekt Ide	
Veprimet për implementimin e ty		Hartimi i Studimit	
Kohëzgjatja		6 Muaj	
Fazat e Zbatimit	I: 2020	X	
	II: 2021-2022		
	III: 2023-2029		
	IV: 2030-2034		
Avantazhet/ Rezultatet e pritshme		Konsolidimi i ofrimit të shërbimeve nëpërmjet forcimit dhe zgjerimit të rrjetit ekzistues.	
Rreziqe të mundshme		Pamundësi për përfundimin e projektit.	
Ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore		Nuk ka nevojë për ndryshime.	



nr. rendor	Projekt	Përshikjet në programet strategjike	Kodi i Programit (sipas kategorizimit të COFOG-ut)	Fshatrat që i preket	Buxheti i nevojshëm (000 ALL)	Burimet e mundshme të financimit	Përgjegjës për zbatimin	Prioritet				Treguesi për matjen, monitorimin e zbatimit	Ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore	Shënime
								I: '20	II: '21-'22	III: '23-'29	IV: '30-'34			
Rigjenerim dhe sistemim urbane														
1	Sistemim urban e fshatit Pustec	PS3.3	062	Pustec	15.000	Bashkia / FSHZH / Donatorë të ndryshëm	Bashkia	x				Përfundimi i veprës / Vizitueshmeri me të madhe	Nuk ka nevojë për ndryshime.	Përfshin: - përmirësimin/krijimin e hapësirave publike (p.sh. sheshe, kënd lojrash) dhe pajisjet e tyre (materiale të dyshemesë, ndriçimi, stolat, bimësi-gjelbërimi, etj.) - shtim të gjelbërimit - Organizim dhe ndriçim i rrjetit rrugor të brendshëm - asfaltim dhe shtrim me gurë i rrugëve - përmirësimi i hyrjes në qytet.
2	Sistemim urban e fshatit Goricë e Vogël	PS3.3	062	Goricë e Vogël	5.000	Bashkia / FSHZH / Donatorë të ndryshëm	Bashkia		x			Përfundimi i veprës / Vizitueshmeri me të madhe	Nuk ka nevojë për ndryshime.	Përfshin: - krijimin e hapësirave të përbashkëta (p.sh. sheshe, kënd lojrash) - shtim të hapësirës së gjelbër - Asfaltim dhe ndriçim të rrugëve kryesore të brendshme - Përmirësimin e hyrjes në qytet - Lidhje me Qendren Informative të Parkut Kombëtar të Prespës & Shkollës & me mol.
Ndërtimi i rrjetit të kanaleve vaditës në pjesën e prisur si dhe rikostruktioni i pjesës së demtuar	Bashkia / FSHZH / Donatorë të ndryshëm	0		X			X	
Sistemim i përroit	Bashkia / FSHZH / Donatorë të ndryshëm	42.000.000	42.000.000					
Realizimi i programit të riciklimit	Bashkia / FZHR / Donatore të ndryshëm	4.500.000	1.500.000	1.500.000	1.500.000			
Rehabilitimi i venddepozitimit të mbetjeve	Bashkia / KRWM / Donatorë të ndryshëm	10.000.000		5.000.000	5.000.000			
Restaurimi i Kishes e Shën Kollit	Bashkia / Donatorë të ndryshëm	0						
Restaurimi i shtëpisë së shkruarit Sterjo Spase dhe kthimi në muze	Bashkia / Donatorë të ndryshëm	10.000.000		5.000.000	5.000.000			
Rikonstruksion i Muzeut të Vatrës të Luftës	Bashkia / Donatorë të ndryshëm	0						
Organizimi i festave vjetore dhe eventeve dhe mbështetje e grupeve kulturore	Bashkia / Donatorë të ndryshëm	0	X	X		X		
Program për informimin për çështjet e mjedisit natyror dhe kulturor	Bashkia / AKZM / Donatore të ndryshëm	300.000		150.000	150.000			
Fushatë ndërgjegjësimi për mbrojtjen e Liqenit dhe mjedisit	Bashkia / FSHZH / Donatorë të ndryshëm / AdZM Korçë	100.000	50.000	25.000	25.000			
Hartimi i Planit Sektorale në nivel Bashkia (PSNB)	Bashkia / FZHR / FSHZH / Donatore të ndryshëm	1.000.000		500.000	500.000			
Ngritje e zyrës për mbështetjen e produktve bujqësore dhe fermerëve	Bashkia / Donatorë të ndryshëm / Sipërmarrje private /	300.000	100.000	100.000	100.000			



Arsyetim	Burimet e mundëshme të financimit	Buxheti	I			II		
			2020	2021	2022	2020	2021	2022
	AZHBR							
Trajnimi - informimi i (a) fermerëve dhe (b) operatoreve të objekteve turistike	Bashkia / Donatorë të ndryshëm / Sipërmarrje private / QTTB Korçë / Universiteti i Korçës	0		x			x	
Rehabilitim-pasurim i tokave djerrë / Hartim i Planit për mbareshtrimin e tokave djerrë të Bashkisë.	Bashkia / Donatorë të ndryshëm / QTTB Korçë / Universiteti i Korçës	100.000.000				50.000.000		50.000.000
Tranjimi i peshkatarevë	Bashkia / FZHR / Donatorë të ndryshëm / Sipërmarrje private	700.000				350.000		350.000
Ndërtimi dhe funksionimi i tregut të prodhimeve bujqësore	Bashkia / FZHR / FZSH / Sipërmarrje private / Donatorë të ndryshëm	10.000.000				5.000.000		5.000.000
Ndërtimi nje pikë grumbullimi dhe përpunimi	Bashkia / FZHR / FZSH / Sipërmarrje private / Donatorë të ndryshëm	0						
Kualifikim i burimeve njerezore të punësuar në sektorin e turizmit	Bashkia / FZSH / Donatorë të ndryshëm / Sipërmarrje private	3.500.000	1.250.000			1.250.000		1.000.000
Përgatitja e një guide lokal turistike	Bashkia / Sipërmarrje private / Donatorë të ndryshëm	300.000				150.000		150.000
Krijimi i korsisë së biçikletave dhe sistemit të marrjes me qira të biçikletave	Bashkia / Sipërmarrje private / Donatorë të ndryshëm	3.500.000	3.500.000					
Ndërtimi i moleve dhe organizimi i intinerareve të liqenit	Bashkia / FZSH / Donatorë të ndryshëm / Sipërmarrje	25.000.000	9.000.000			8.000.000		8.000.000



Arsyetim	Burimet e mundëshme të financimit	Buxheti	I	II	
			2020	2021	2022
	private				
Sistemim plazhi në Zaroshkë	Bashkia / FSHZH / Donatorë të ndryshëm	10.000.000	10.000.000		
Sistemim plazhi në Pustec, Gollomboc dhe Goricë e Vogël	Bashkia / FZHR / FSHZH / Donatore të ndryshëm	30.000.000		15.000.000	15.000.000
Krijimi i itinerant për këmbësorët anës liqenit	Bashkia / FZHR / FSHZH / Donatore të ndryshëm	10.000.000	10.000.000		
Kualifikim i burimeve njerezore të administratës të Bashkisë	Bashkia / FZHR / Donatorë të ndryshëm / Ministria e Brendshme	500.000	200.000	150.000	150.000
Rikonstruksioni i godinës së bashkisë	Bashkia / FSHZH / Donatorë të ndryshëm	10.000.000		5.000.000	5.000.000
Krijimi, rifreskimi i vazhdueshëm i databaseve të ndryshme	Bashkia / FSHZH / Donatorë të ndryshëm	500.000		250.000	250.000
Ndërtimi i kopshtit	Bashkia / FSHZH / Donatorë të ndryshëm	8.000.000		4.000.000	4.000.000
Rikonstrukcioni i shkollës në Pustecit	Bashkia / FSHZH / Donatorë të ndryshëm	20.000.000	20.000.000		
Rikostrukcioni i shkollës	Bashkia / FSHZH / Donatorë të ndryshëm	7.000.000	7.000.000		
Rikostrukcioni i shkollës	Bashkia / FSHZH / Donatorë të ndryshëm	5.000.000	5.000.000		
Rikostrukcioni i shkollës	Bashkia / FSHZH / Donatorë të ndryshëm	8.000.000	8.000.000		
Rikostrukcioni i shkollës	Bashkia / FSHZH / Donatorë të ndryshëm	5.000.000	5.000.000		



Arsyetim	Burimet e mundëshme të financimit	Buxheti	I			II		
			2020	2021	2022	2020	2021	2022
	ndryshëm							
Krijim i shesheve në fshatrat të tjëra	Bashkia / FSHZH / Donatore të ndryshëm	0						
Krijimi i nje parku lojrash sportive	Bashkia / FSHZH / Donatorë të ndryshëm	5.000.000				2.500.000		2.500.000
Ndërtimi i hapësirave sportive në Pustec	Bashkia / FSHZH / Donatorë të ndryshëm	15.000.000	5.000.000			5.000.000		5.000.000
Përmiresimi i hapësirat sportive në Goricë e Vogël	Bashkia / FSHZH / Donatorë të ndryshëm	15.000.000	5.000.000			5.000.000		5.000.000
Ndërtimi dhe funksionimi i qendrës kulturore në Pustec	Bashkia / FSHZH / Donatorë të ndryshëm	1.500.000				750.000		750.000
Total		602.800.000	202.600.000			200.225.000		199.975.000

Tabela 4.2.2: Plani i investimeve sipas prioriteteve brenda tre vjeçarit i Bashkisë Pustec

Siç duket edhe nga tabela, arkëtimet vjetore, do të jenë në vlerën prej 202.600.000 Lekë për vitin e parë, 200.225.000 Lekë për vitin e dytë dhe 199.975.000 Lekë për vitin e tretë. Më poshtë, paraqitet diagrama në lidhje me ndarjen e arkëtimeve të investimeve sipas prioriteteve brenda tre vjeçarit.






Diagrama 4.2.1: Arkëtimet e investimeve sipas prioriteteve brenda tre vjeçarit për Bashkinë Pustec

Sic u përmend më lart, buxheti total i tre viteve sipas prioritetit të investimeve është në vlerën prej 602.800.000 Lekë. Në veçanti, nga totali i buxhetit të tre viteve, 194.300.000 Lekë ose në përqindje 32,23% përket investimeve për zhvillimin ekonomik, 176.600.000 Lekë ose 29,30% i përket investimeve për infrastrukturën e transporteve, 89.500.000 Lekë ose 14,85% i përket investimeve për infrastrukturën Sociale, 63.000.000 Lekë ose 10,45% i përket investimeve për infrastrukturën Sistemim urbane, 42.000.000 Lekë ose 6,79% i përket investimeve për infrastrukturën e trajtimit të ujërave të ndotura dhe të bardha, 14.500.000 Lekë ose 2,41% i përket investimeve për infrastrukturën e menaxhimit të mbeturinave, 11.000.000 Lekë ose 1,82% i përket investimeve për mirësimin e administratës në Bashki, 10.400.000 Lekë ose 1,73% i përket investimeve për mjedisin natyror dhe kulturor, 1.500.000 Lekë ose 0,25% i përket investimeve për infrastrukturën Vadtëse dhe Kulluese. Së fundmi, investimet për Infrastrukturën e telekomunikacionit, për Infrastrukturën energjetike dhe për Infrastrukturën e ujësjellësit për tre vjeçarin e pare nuk do kene rezultate pasi nuk do të kryhen investime mbi to.

Arsyetim	Buxheti	II: 21-22		
		I: 20 2020	2021	2022
Sistemim urbane	63.000.000	40.000.000	11.500.000	11.500.000
Infrastruktura Rrugore	176.600.000	30.000.000	73.300.000	73.300.000
Infrastruktura e ujësjellësit	0	0	0	0

Arsyetim	Buxheti	II: 21-22		
		I: 20 2020	2021	2022
Infrastrukturë energjetike	0	0	0	0
Infrastruktura e telekomunikacionit	0	0	0	0
Infrastrukturë Vaditëse dhe Kulluese	1.500.000	0	750.000	750.000
Infrastruktura e trajtimit të ujërave të ndotura dhe të bardha	42.000.000	42.000.000	0	0
Infrastruktura e menaxhimit të mbeturinave	14.500.000	1.500.000	6.500.000	6.500.000
Mjedisi natyror dhe kulturor	10.400.000	50.000	5.175.000	5.175.000
Zhvillimi ekonomik	194.300.000	33.850.000	80.350.000	80.100.000
Përmirësim i administratës në Bashki	11.000.000	200.000	5.400.000	5.400.000
Infrastrukturë Sociale	89.500.000	55.000.000	17.250.000	17.250.000
Total	602.800.000	202.600.000	222.225.000	199.975.000

Tabela 4.2.3: Plani i investimeve sipas prioriteteve, sipas llojit të investimit, brenda tre vjeçarit, i Bashkisë Pustec




Diagrama 4.2.2: Ndarja në përqindje e burimeve sipas llojit të investimeve, në investimet sipas prioriteteve të Bashkisë Pustec

Më poshtë paraqiten investimet që përbëjnë projekte - vepra me rëndësi kombëtare që kanë të bëjnë me Bashkinë e Devollit brenda trevjeçarit. Burimet e financimit ndryshojnë nga investimet e mësipërme.

Arsyetimi	Burimet e Financimit	Buxheti	I		
			2020	2021	2022
Rikonstruksion i rrugës Cerje - pika kufitare	ARRSH	0			
Përmirësimi i kryqëzimeve të rrugës SH79	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë/ B.E. / FSHZH/ Donatore të ndryshëm	0			
Promovim i ishullit i Maligradit	Bashkia / FZHR / DRKK / Donatore të ndryshëm / universitete të ndryshme të vendit dhe jashte shtetit	100.000.000	35.000.000	35.000.000	30.000.000
Restaurim - mbrojtje dhe promovim i monumenteve kulturore të tjera	Bashkia / FZHR / DRKK / Donatore të ndryshëm / universitete të ndryshme të vendit dhe jashte shtetit	7.000.000		3.500.000	3.500.000
Përmersimi i aksesit në monumentet e natyrës dhe kulturës dhe vendosja e sinjalistikës turistike	Bashkia / FSHZH / Donatorë të ndryshëm	1.800.000	600.000	600.000	600.000
Shpallje e monumenteve të reja kulturore	DRKK Korçë / Bashkia	1.000.000	1.000.000		
Funksionim i plotë i qendrës së informimit të vizitorëve në Bazarizë	Bashkia / AdZM Korçë / Donatorë të ndryshëm	8.000.000	8.000.000		
Krijimi i pikës kufitare në Cerje	Qeveria	0			
Promovim i Brezit të Gjëlber European	Bashkia / Donatore të ndryshëm	0			
Total		117.800.000	44.600.000	39.100.000	34.100.000

Tabela 4.2.4: Plani i investimeve, veprave të rëndësisë kombëtare, brenda trevjeçarit në Bashkinë e Pustecit

Bashkia Pustec përmes programit PBA përcakton objektivat e mëposhtme:

- Objektivi kryesor i PBA është përmirësimi i menaxhimit të shpenzimeve publike dhe përdorimi i fondeve.
- Objektiva për të arritur janë shpërndarja dhe përdorimi më efikas i fondeve: forcimi i lidhjes midis programeve të bashkisë dhe alokimin e burimeve si dhe të ketë një kornizë të qëndrueshme për programin afatmesëm brenda të cilit planifikohen buxhetet vjetore.

PBA e viteve 2018-2021 përfshin një numër projektesh që ose janë vënë ose pritet të vihen në zbatim. Më konkretisht, ka të bëjë:

- Dizajnimi, Menaxhimi, Drejtimi
- Furnizimi me ujë dhe kanalizimet
- Menaxhimi i mbeturinave dhe shërbimet publike lokale
- Infrastruktura dhe transporti rrugor
- Arti, kultura dhe turizmi
- Mbrojtja e mjedisit dhe menaxhimi i pyjeve
- Shërbimet sociale
- Arsimi



Objektivi i investimeve të mësipërme është përmirësimi i cilësisë së infrastrukturës rrugore dhe përmirësimi i cilësisë së jetës. Disa nga këto projekte duhet të përfundojnë deri në vitin 2022 edhe sipas Tabelës 4.2.2.

Megjithatë, sa i përket objektivave dhe treguesve të performancës Bashkia Pustec nuk ka dorëzuar tabelën e përshkrimit të programit PBA dhe kjo nuk lejon një pasqyrë më të qartë të shpenzimeve të programit. Prandaj duhet të përcaktojë objektivat dhe politikat që ajo synon të arrijë në periudhën afatmesme, e cila duhet të lidhet me financimet që marrin përmes Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2018-2020.

Sipas PBA, Bashkia Pustec për periudhën 2019-2021 parashikon një ristrukturim të të ardhurave në lidhje me mënyrën e blerjes. Shumat do të vijnë në Bashki nga nga tarifat, qiratë, taksat dhe burime të tjera të të ardhurave siç janë të ardhurat e trashëguara. Përveç kësaj, të ardhurat e tjera vijnë nga transfertat të pakushtëzuara, transfertat speciale dhe transfertat të detyrueshme. Kjo do të ndihmojë Bashkinë në alokimin dhe shpërndarjen e të ardhurave për vitet në vijim sa i përket shpenzimeve të parashikuara në kuadër të programeve komunale dhe të zhvillimit.

Nga analiza e mëparshme për Qarkun e Korçës dhe në veçanti për Bashkinë e Pustecit ka disa probleme të mëdha që duhet të adresohen në mënyrë që Bashkia të paraqesë tregues ekonomikë pozitivë. Së pari, Bashkia duhet t'i japë prioritet investimeve në infrastrukturën e transportit që do të kontribuojë në zhvillimin ekonomik të zonës, pasi që rrjetet më të mira rrugore do të çojnë në rritje në industri, bujqësi dhe turizëm dhe në zhvillimin e standardeve të jetesës. Përveç kësaj, bashkia duhet të synojë në investimet në infrastrukturën sociale dhe rigjenerimin urban. Kjo do të kontribuojë në ngritjen e standardit të jetesës në zone, rritjen e nivelit arsimor, si dhe rritjen e turizmit, një sektor që bashkia kërkon të fitojë siç ndodhet në Parkun Kombëtar të Prespës, një nga 15 parqet kombëtare të vendit. Së fundi, si një zonë thjesht bujqësore, bashkia duhet gjithashtu t'i japë përparësi investimeve në infrastrukturën e ujitjes, pasi ajo do të ndihmojë në rritjen e prodhimit dhe përfitimeve të ndërmarrjeve bujqësore dhe të gjithë njerëzve në përgjithësi pasi është sektori



më i rëndësishëm i ekonomisë së rajonit dhe banoreve në përgjithësi pasi është sektori më i rëndësishëm i ekonomisë së rajonit.

4.3. Ndryshimet në kuadrin ligjor dhe administrative në nivel vendor

Propozohen ndryshime administrative në organizimin dhe funksionimin e Bashkisë, të cilat janë paraqitur më hollësisht në kapitullin "Kapaciteti institucional". Qëllimi është që përmes strukturës së re të Bashkisë të arrihet funksionimi më efikas dhe më racional i departamentit të Bashkisë i cili është përgjegjës për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, ofrimin e shërbimeve bashkëkohore që korrespondojnë me nevojat aktuale dhe monitorimin më të mirë të projekteve dhe veprimeve, për të cilat bashkia ka përgjegjësinë për ti zbatuar.

Në veçanti, propozohet krijimi i një kompanie të zhvillimit komunal, e cila do të kontrollohet nga Këshilli Bashkiak, me objekt zhvillimin e Bashkisë, kryesisht përmes zbatimit të planit sektorial (PSNB) për zhvillimin e turizmit, dhe ofrimin e zgjidhjeve të integruara dhe shërbime këshilluese për Bashkinë, banorët dhe sipërmarrësit që ushtrojnë aktivitete në të. Ky format përzgjidhet pasi ofron fleksibilitet më të madh, përgjigje më efektive ndaj mundësive të ofruara dhe zhvillime në sferën kombëtare evropiane dhe zbatim më të shpejtë të veprimeve.

Në lidhje me legjislacionin e përgjithshëm dhe atë specifik aktual, propozohet përshtatja me çështjet e mëposhtme:

- Krijimi i një stacioni kufitar me Greqinë në Çerje.
- Krijimi dhe funksionimi i shoqatave të fermerëve.
- Krijimi dhe funksionimi i fermave blegtorale.
- Liçensimi dhe kategorizimi i shërbimeve të akomodimit të agroturizmit-ekoturizmit
- Promovimi i bujqësisë dhe blegtorisë organike (p.sh. ofrimi i stimujve financiarë, përjashtime nga taksat, koncesione për shfrytëzimin e tokës etj.).

Nga aplikimi i PPV rezulton hartimi i studimeve, miratimi i të cilave do të ketë pasoja juridike. Të tilla janë studimet e planifikimit hapësinor, si PDV dhe PSNB. Është gjithashtu e nevojshme të modifikohet Plani aktual i Menaxhimit të Parkut Kombëtar të Prespës në mënyrë që të përshtatet me VKM Nr. 57, datë 2019/06/02 "Për kriteret dhe mënyrën e zonimit të territorit të një zone të mbrojtur mjedisore" dhe të marrë në konsideratë në mënyrë më aktive Konventën Europiane për Peizazhin që u miratua në Firence në 20.12.2000.

Nëpërmjet zbatimit të PPV-së do të kërkohet shpallja e monumenteve të reja kulturore dhe përcaktimi i zonave të tyre të mbrojtura në bashkëpunim me shërbimet kompetente. Gjithashtu, propozohet ndryshimi i Planit Rajonal të Menaxhimit të Mbetjeve, me qëllim për të krijuar Pikën e transferimit të mbeturinave të Bashkisë Pustec.

Është nevojë urgjente për të ndryshuar lejen mbi aktivitetin mineral nr. 1660, datë 2016/10/05 (Lloji i mineralit Fe-Ni), e cila ka të bëjë me një sipërfaqe prej 3.509 km² në verilindje të qytetit Bilisht, me qëllim për të përjashtuar zonën brenda vijës jeshile, dhe e gjitha ajo zonë që përfshin kurorën e gjelbër të propozuar të qytetit, monumentin e Kalasë së Bilishtit dhe rezervuarin e Selvës.

Së fundi, për zbatimin e projekteve të caktuara, kryesisht atyre teknike (p.sh., përmirësimi dhe ndërtimi i rrugëve, konfigurimi i nyjeve, trajtimi i ujërave të zeza) do të kërkohet shpronësimi i tokës, fakt i cili do të ketë nevojë për iniciativa dhe procese administrative dhe legislative.

4.4. Indikatorët e monitorimit për zbatimin të PPV-së

Ky kapitull lidhet me monitorimin dhe vlerësimin e PPV-së, në lidhje me arritjen dhe progresin e zbatimit të objektivave të përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara për zbulimin e vonesave ose dështimeve dhe sugjerimin e zgjidhjeve për vendimmarrje dhe zbatimin e veprimeve për të siguruar ecurinë e suksesshme të PPV-së gjatë një afati kohor pesëmbëdhjetëvjeçar.

Monitorim vlerëson procesin e zbatimit të planit, me qëllim planifikimin e veprimeve të nevojshme për të siguruar monitorimin e suksesshëm të monitorimit të PPV i cili kryhet në bazë të të dhënave relevante që çdo institucion përkatës i ofron Sektorit për Planifikim dhe Zhvillim të Bashkisë.

Treguesit për monitorimin e zbatimit të PPV-së janë të listuara si më poshtë:

Treguesit për monitorimin e zbatimit të PPV-së	
1. Rigjenerim dhe sistemim urbane	
1.1.	Numëri i rigjenerimeve urbane të zbatuara
1.2.	Sipërfaqja e rigjenerimeve urbane të zbatuara (km ²)/ Sipërfaqe totale urbane (km ²)
1.3.	Metra trotuarësh të krijuara ose të sistemuara/ gjatësia e rrugëve lokale (m)
1.4.	Sipërfaqet e gjelbra të sistemuara (km ²)
1.5.	Sipërfaqe me mbjellje pemësh në trotuarët (km ²)
1.6.	Numri i apartamenteve / banesave të reja për çdo pesë vjet
1.7.	Numri i lejeve të reja të ndërtimit për banesa në përputhje me rregulloren e PPV-së, për çdo pesë vjet në vendbanimet e Bashkisë
1.8.	Ndërtime informale në terren për çdo pesë vjet
2. Infrastruktura Rrugore	
2.1.	Numri i km të rrugëve të reja/ rrjeti rrugor ekzistues (km)
2.2.	Numri i hapësirave për parkim/ Numri i banorëve
2.3.	Numri i hapësirave për parkim të organizuara (parkim bashkiak)/ Numri i banorëve
3. Infrastruktura e ujësjellësit & kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura	
3.1.	Gjatësia e rrjetit të ujësjellësit të ri (km)
3.2.	Gjatësia e rrjetit të ujësjellësit të ri/ Gjatësia e rrjetit të ujësjellësit ekzistues
3.3.	Gjatësia e rrjetit të ujësjellësit të ri/ Gjatësia e rrjetit të ujësjellësit të propozuar
3.4.	Numri i rikonstruksioneve ose përmirësimeve për çdo kategori të rrjetit ekzistues të ujësjellësit
3.5.	Numri i rikonstruksioneve ose përmirësimeve për çdo kategori të rrjetit ekzistues të kanalizimeve



Treguesit për monitorimin e zbatimit të PPV-së	
3.6.	Nr i banorëve që shërbehen nga rrjeti i kanalizimeve/ Total i popullsisë së bashkisë
3.7.	Gjatësia e rrjetit të kanalizimeve të ri/ Gjatësia e rrjetit të kanalizimeve të propozuar
4. Infrastrukturë Vaditëse	
4.1.	Gjatësia e rrjetit vaditës të ri (km)
4.2.	Gjatësia e rrjetit vaditës të ri/ Gjatësia e rrjetit vaditës ekzistues
4.3.	Gjatësia e rrjetit vaditës të ri/ Gjatësia e rrjetit vaditës të propozuar
4.4.	Numri i rikonstruksioneve ose përmirësimeve për çdo kategori të rrjetit vaditës ekzistues
4.5.	Gjatësia e rrjetit vaditës të ri/ Gjatësia e rrjetit vaditës të propozuar
5. Infrastrukturë e menaxhimit të mbetjeve	
5.1.	Numri i koshave/Territori gjeografik
5.2.	Numri i koshave të riciklimit/Territori gjeografik
5.3.	Volumi ditor i mbetjeve urbane (m ³)
5.4.	Evente për ndërgjegjësimin e e banorëve për çështjet e riciklimit/ vit
5.5.	Volumi total i mbetjeve të ricikluara
6. Infrastruktura Rrugore	
6.1.	Numri i km rrugore të reja/ rrjeti rrugor ekzistues (km)
6.2.	Numri i hapësirave për parkim/ Numri i banërove
6.3.	Numri i hapësirave për parkim të organizuara (parking bashkiak)/ Numri i banorëve
7. Infrastrukturë Sociale	
7.1.	Numri i njësive të shërbimit ambulator që krijohen/ rikonstruktohen/ përmirësohen
7.2.	Numri i njësive arsimore që përmirësohen / vit
7.3.	Sipërfaqe e terreneve shkollore që janë sistemuar, përmirësuar (km ²)
7.4.	Numri i programeve që u organizuan për arsim të të rriturve-të mësuarit të përjetëshëm/ vit
7.5.	Numri i njësive dhe infrastrukturës sportive të sistemuar ose përmirësuar ose zgjeruar / vit
7.6.	Numri i njësive dhe infrastrukturës kulturore të sistemuar ose përmirësuar ose zgjeruar / vit
7.7.	Numri i programeve vullnetare të organizuara / vit
7.8.	Numri i programeve për promovimin e kohezionit social / vit
8. Zhvillimi ekonomik	
8.1.	Numri i punonjësve të punësuar për zbatimin e Planit.
8.2.	Numri i përfituesve nga zbatimi i projekteve të planit
8.3.	Numër i subjekteve që pëfitojnë nga rigjenerimet urbane



Treguesit për monitorimin e zbatimit të PPV-së	
8.4.	Numri i subjekteve që pëfitojnë nga projektet për zhvillimin rural
8.5.	Numri i subjekteve të reja në sektorin bujqësor / vit
8.6.	Numri i subjekteve të reja në sektorin blegtoral / vit
8.7.	Numri i subjekteve të reja në sektorin agropërpunues/ vit
8.8.	Numri i subjekteve të reja në sektorin e turizmit-shërbimeve/ vit
8.9.	Numri i subjekteve të reja në sektorin industrial/ vit
8.10.	Numri i programeve të zbatuara për zhvillimin e biznesit vendas
8.11.	Numri i programeve të zbatuara për zhvillimin e punësimit vendas
8.12.	Numri i produkteve të çertifikuara të markës vendase
8.13.	Numri i produkteve të çertifikuara të markës vendase / vit
8.14.	Përqindja e shtimit të akomodimit për çdo natë në hotele
8.15.	Përqindja e shtimit të vizitorëve në zonat rekreative të bashkisë
8.16.	Përqindja e shtimit të vizitorëve në faqen elektronike në lidhje me reklamimin turistik të Bashkisë
8.17.	Evolucioni i sasisë së produkteve bujqësore të prodhuara (sasia për produkt të prodhuar)
8.18.	Numri i vendeve të reja të punës për çdo pesë vjet në aktivitetet ekonomike
8.19.	Numri i strukturave akomoduese turistike sipas llojit
8.20.	Numri i turistëve të kënaqur nga eksperiencia e tyre në territor
8.21.	Numri i turistëve vizitorëve / ekskursionistëve/ turistëve në muaj
8.22.	Qëndrimi mesatar i vizitorëve në territor
8.23.	Lloji i transportit të përdorur nga vizitorët
9. Mjedis natyror dhe kulturor	
9.1.	Numri i rikonstruksioneve të ndërtesave historike/ Totali i ndërtesave historike
9.2.	Gjatësia (km) e shtigjeve të pastruara dhe me sinjalistikë/ gjatësinë e shtigjeve totale
9.3.	Numri i programeve të zbatuara për sensibilizimin dhe mbrojtjen e mjedisit.
9.4.	Numri i eventeve kulturore të organizuara
9.5.	Numri i monumenteve të regjistruara
10. Përmirësim i administratës në Bashki	
10.1.	Numri i vizitorëve në faqen e internetit/ 6 mujor
10.2.	Numri i shërbimeve elektronike ndaj qytetarëve/ Numri i shërbimeve që mundet të disponohen në mënyrë elektronike
10.3.	Numrat e aplikacioneve të cilat u aktivizuan për shërbimin e qytetarëve.
10.4.	Numri i njësive "one stop shop"
10.5.	Numri i kërkesave që u shërbyen në mënyrë elektronike/ vit



Treguesit për monitorimin e zbatimit të PPV-së	
10.6.	Koha mesatare e shërbimit të qytetarit
10.7.	Numri kompjuterash/ punonjësve
10.8.	Numri i punonjësve që marrin pjesë në seminare/ vit
10.9.	Shpenzime për Investime/ Shpenzime totale
10.10.	Numri i indikatorëve që përdoren për monitorimin e cilësisë që përdoren
10.11.	Numri i bashkëpunimeve që u nënshkruan (ndërbashkiake, ndërkombëtare)
10.12.	Numri i veprimeve për promovimin e shërbimeve ndaj qytetarit
10.13.	Numri dhe kategori i njoftimeve ndaj qytetarit, institucioneve

Tabela 4.4.1: Treguesit për monitorimin e zbatimit të PPV-së

4.5. Evidentimi i faktorëve që mund të çojnë në nevojën e rishikimit të PPV-së

Në nenin 26 të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" referohen kushtet dhe faktorët që mund të kontribuojnë në rishikimin e PPV-së. Në mënyrë specifike PPV-të ndryshohen edhe kur kanë ndarje administrative dhe territoriale, ndryshime të paparashikuara demografike, sociale dhe ekonomike, ndryshimet e shkaktuara nga kriza sektoriale apo nga forca madhore, si dhe në rastet kur lind nevoja e harmonizimit me dokumentet e një niveli më të lartë planifikimi (p.sh. Planet sektoriale në nivel Qarku - PSNQ, Planet e detajuara për zona të rëndësishme kombëtare - PDZRK) apo të përafërimit me legjislacionin e Bashkimit Europian.

Meqenëse bashkia gjendet në zonën ndërkufitare, katëngjarët e preket nga zhvillimet e jashtme, më të gjera ekonomike dhe gjeopolitike (p.sh. projekte infrastrukturore, investime strategjike, programe financimi dhe burime ekonomike) që do të ndryshojnë kushtet lokale demografike, sociale dhe ekonomike.



Drejtoria e planifikimit dhe zhvillimit të zonës dhe strehimit, me veprat - veprimet që janë në zhvillim, të cilat i ka vendosur prioritet gjatë pesëmbëdhjetë vjeçarit të ardhshëm, (2019 dhe 2033), synon të realizojë vepra – veprime me buxhet total në vlerën prej 1.574.600.000 Lekë, duke shfrytëzuar burimet e forta të financimit (Programe Ndërkombëtare, Europiane dhe Amerikane, pjesëmarrja kombëtare, vetë burimet e Organizmave të Vetëadministrimit Vendor (Fondi Rajonal, Fondi i Komunitetit) dhe kapitale rezervë të vitit të kaluar). Theksohet fakti se për realizimin e veprave të ndërtimit, rindërtimit dhe atyre që kanë objekt të përafërt, hartimin e studimeve, ofrimin e shërbimeve si edhe për mblerjen e furnizimeve, për tre vjeçarin e ardhshëm, buxheti është në vlerën prej 1.054.000.000,00 Lekë.

Më poshtë paraqiten investimet e prioritetit të parë për vitet 2019-2020-2021.

Arsyetimi	Buxheti	I: 19	II: 20-21	
		2019	2020	2021
Sistemim urbane	63.000.000	40.000.000	11.500.000	11.500.000
Infrastruktura Rrugore	176.600.000	30.000.000	73.300.000	73.300.000
Infrastruktura e ujësjellësit	58.000.000	27.000.000	15.500.000	15.500.000
Infrastrukturë energjetike	0	0	0	0
Infrastruktura e telekomunikacionit	25.000.000	9.000.000	8.000.000	8.000.000
Infrastrukturë Vaditëse dhe Kulluese	1.500.000	0	750.000	750.000
Infrastruktura e trajtimit të ujërave të ndotura dhe të bardha	128.500.000	63.500.000	32.500.000	32.500.000
Infrastruktura të menaxhimit të mbeturinave	69.500.000	1.500.000	34.000.000	34.000.000
Mjedisi natyror dhe kulturor	122.200.000	38.650.000	44.275.000	39.275.000
Zhvillimi ekonomik	307.900.000	41.850.000	133.150.000	132.900.000
Përmirësim i administratës në Bashki	11.000.000	200.000	5.400.000	5.400.000
Infrastrukturë Sociale	90.800.000	55.000.000	17.900.000	17.900.000
Total	1.054.000.000	306.700.000	376.275.000	371.025.000

Tabela 5.1.2 : Plani i investimeve sipas prioriteteve, sipas llojit të investimit, brenda tre vjeçarit për Bashkinë Pustec

Për realizimin e veprave – veprimeve të sipërpërmendura, arritjen e qëllimeve, por, kryesisht për mbulimin e nevojave, kërkohen burime të cilat nuk janë gjithmonë të disponueshme. Për këtë arsye, çdo vit hartohet Programi i veprave sipas prioriteteve për çdo periudhë administrimi (Programi Teknik Vjetor). Ndërkohë, përveç zbatimit të këtij Programi, Shërbimi vazhdon të ketë probleme, pasi si problemin më kryesor ka realizimin e veprave – veprimeve, vonesën në pagesa të udhërpagesave, fakt i cili përfshin vonesa të mëdha kohore për përfundimin e veprimeve. Vonesa në pagesa i detyrohet, mbi të gjitha, fluksit jo të rregullt financiar të programeve, por edhe problemeve të kreditimeve të disponueshme të Bashkisë Pustec.

Gjithashtu, lind një problem i rëndësishëm gjatë fazës së realizimit, në rastet kur vlera e financimit të veprave zhvillimore është më e vogël se ajo e parashikuar paraprakisht, duke patur si rezultat nevojën për mbështetje financiare nga burime bashkiake. Duke patur parasysh mënyrën e funksionit

5. KAPACITETI INSTITUCIONAL

5.1. Vlerësimi i shpejtë i kapaciteteve institucionale të Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit Zhvillimit të Territorit (DPKZHT) të Bashkisë

Veprimet e Drejtorisë së planifikimit dhe zhvillimit të zonës dhe strehimit së Bashkisë Pustec kanë si marrës kryesorë (të drejtëpërdrejtë ose indirektë) qytetarët / banorët e Bashkisë Pustec. Së dyti, në grupin e përdoruesve të shërbimeve teknike të Bashkisë përfshihen edhe kontraktuesit dhe furnizuesit që “ekzekutojnë” punime për llogari të Shërbimit, si edhe shërbime të ndryshme të Bashkisë ose Ente të sektorit publik për llogari të të cilëve Shërbimi në fjalë ekzekuton aktivitete.

Aktivitetet e Drejtorisë së planifikimit dhe zhvillimit të zonës dhe strehimit, të Bashkisë Pustec zhvillohen në përputhje me rregullat ligjore siç specifikohen në legjislacionin në fuqi. Aktivitetet më të rëndësishme të Shërbimit përfshijnë programatizimin e veprave teknike, hartimin e studimeve dhe mbikqyrjen e ekzekutimit të veprave, çështje të planifikimit hapësinor / urban, zbatime urbane - kadastër, formimin – programatizimin dhe ndjekjen e punimeve të Sektorit, ndërsa paralelisht në kuadrin e kompetencave të Drejtorisë në fjalë, inkuadrohen edhe çështje të mbrojtjes së mjedisit, të shëndetit publik dhe administrimit të Cilësisë së Përgjithshme, hartimi i studimeve të qarkullimit dhe planifikimi i veprave dhe rregullave të qarkullimit dhe zbatimet e energjisë.

Theksohet fakti se aktivitetet që realizon Shërbimi në fjalë, në kuadrin e objektit që duhet të përmbushë nga aspekti ligjor, në shumicën e tyre përbëjnë ndërhyrje në hapësirë (vepra ndërtimi të infrastrukturave, vepra zëvendësimi, etj.) që financohen nga burime të ndryshme (Programe Financimi nga të tretët, pjesëmarrëje kombëtare, burimet e vetë organizmave të Administratës vendore, kapitale rezervë të vitit të kaluar) dhe i përkasin zhvillimit lokal dhe përmirësimit të infrastrukturave brenda dhe jashtë rrjetit urban. Përveç këtyre, ekzekuton edhe punime zbatimi (punë zyre), si për shembull nxjerrjen e lejeve, certifikatave të përdorimit etj.

Në veçanti, aktivitetet e Drejtorisë dhe output-et e prodhuara nga ajo formulohen analitikisht në tabelën e mëposhtme.

AKTIVITETI	OUTPUT-I VJETOR
Drejtorja e planifikimit dhe e zhvillimit të zonës dhe e strehimit:	<ul style="list-style-type: none"> • Kontroll i veprave të ndërtuara • Kontroll i arkitekturës dhe i planifikimit urban të veprave • Digjitalizim i hartave • Kontroll i rrjetit të veprave • Programatizim i zhvillimit të veprave dhe detyrave përta i përket planifikimit të investimeve publike • Mbajtje e arkivës teknike • Kontroll i realizimit të veprave • Lëshim Certifikatash –Vërtetimesh të llojeve të ndryshme • Hartim dhe mbikqyrje studimesh, me objekt mbrojtjen e mjedisit • Transporte dhe leje banimi • Përballje e nevojave urgjente

Tabela 5.1.1: Output-et e prodhuara të Drejtorisë së Shërbimeve Teknike



të problemeve tashmë ekzistuese, nuk ekzistojnë hapësira përmirësimi të efikasitetit dhe efektivitetit të aktiviteteve të Shërbimit pa rritjen e domosdoshme të burimeve.

Nga ana e qytetarëve, aktivitetet dhe shërbimet e ofruara të Drejtorisë në fjalë të Bashkisë Pustec nga aspekti sasior mbulojnë mjaftueshëm madhësinë e kërkesës. Ndërkohë, ekzistojnë mjaft ankesa nga qytetarët, që lidhen qoftë me problemet (dëme, mungesa në infrastruktura, rrjet rrugor, etj.) në qytet dhe ndikojnë në përditshmërinë e tyre, qoftë në cilësinë e shërbimeve dhe ofrimin e tyre, për mbulimin e të cilave Shërbimi bën përpjekje të vazhdueshme. Shumica e ankesave nga ana e qytetarëve, që lidhen me shërbimin e tyre, fokusohet në vonesat kohore të përgjigjes ndaj kërkesave të tyre, që lidhen veçanërisht me zëvendësimet e dëmeve teknike.

Në shërbimin në fjalë, regjistrohen mungesa të rëndësishme parësore përse i përket zbatimit të procedurave të programatizimit, ndjekjes dhe vlerësimit të veprimeve të tij. Këto mungesa rezultojnë, por njëkohësisht forcohen, edhe nga problemet që shqetësojnë, jo vetëm Drejtorinë në fjalë, por të gjithë Organizmin e Administratës Vendore të Bashkisë Pustec dhe u përkasin çështjeve të organizimit dhe administrimit, programatizimit, hierarkisë, prodhueshmërisë, koordinimit, madje edhe komunikimit të brendshëm ndërmjet Sektorëve dhe përgjithësisht, të strukturës organizative.

Zgjidhja e problemeve të sipërpërmendura, zbatimi i sistemeve dhe metodave të përmirësimi të efikasitetit të procedurave funksionale të Shërbimit, si edhe administrimi/përballja e faktorëve ekzogjenë (psh. vonesa në pagesa të urdhër-pagesave) që shkaktojnë probleme në realizimin dhe përfundimin e veprave, gjykohen si pika kyçe të përmirësimi të cilësisë dhe të efikasitetit të aktiviteteve të Drejtorisë së Shërbimeve Teknike të Bashkisë Pustec, me aks kryesor shërbimin më të mirë dhe më të shpejtë të qytetarit.

Përse i përket komunikimit të Drejtorisë me marrësit e saj, theksohet fakti se ekzistojnë pjesërisht mungesa. Përdoruesit e shërbimeve teknike (kontraktorë të Punëve Publike, furnitorë, etj.) informohen me të gjitha mënyrat e parashikuara nga ligji në lidhje me shërbimet e ofruara dhe veprimet e parashikuara të Drejtorisë në fjalë. Për informimin e grupeve të marrësve në lidhje me çështje të përgjithshme, Drejtoria e Shërbimeve Teknike e Bashkisë boton Njoftime për Shtyp ose edhe botohen çështjet e Këshillit Bashkiak. Ndërkohë, mungesa regjistrohen edhe në lidhje me informimin e të gjithë qytetarëve për llojet dhe numrin e shërbimeve të ofruara ose për veprat që ndodhen në fazë realizimi dhe, për pasojë, shkaktojnë probleme/pavolitshmëri në lëvizjen e tyre të përditshme (psh. rrjete të reja rrugore, ndërtesa të reja, etj.). Për rrjedhojë, informimi i Veprës së prodhuar të Drejtorisë së Shërbimeve Teknike përbën përparësi për Bashkinë, kryesisht për informimin e qytetarëve për mosfunksionime emergjente brenda rrjetit urban.

Kuadri ligjor

Duke shqyrtuar dispozitat sipas të cilave rekomandohen dhe funksionojnë drejtoritë e planifikimit urban dhe zhvillimit, ato përcaktohen nga Ligji 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar.

Ky ligj synon sigurimin e zhvillimit të qendrueshëm të zonës nëpërmjet përdorimit racional të tokës dhe burimeve natyrore. Ai vlerëson mundësitë reale dhe të ardhshme të zhvillimit të tokës në nivel lokal dhe kombëtar, duke balancuar burimet natyrore me kërkesën ekonomike dhe interesin publik dhe privat. Gjithashtu, synon të koordinojë përpjekjen për:

- i. Ruajtjen e burimeve natyrore, si toka, ajri, uji, pyjet, flora dhe fauna.
- ii. Krijimin e tokave të përzgjedhura për ndërtimin funksional.



- iii. Promovimin e ekonomisë, jetës sociale dhe kulturore në nivel lokal dhe kombëtar.
- iv. Ruajtjen e burimeve që ofrojnë një furnizim të mjaftueshëm.
- v. Ofrimin për sigurinë e jetës, sigurinë kombëtare, rendin publik dhe shëndetin publik.
- vi. Promovimin e zhvillimit të barabartë rajonal për sigurimin e ndarjes së qendrueshme të popullsisë.

Më konkretisht, në nenin 14 të Ligjit 107/2014, përcaktohen kërkesat minimale për numrin dhe specializimin e nëpunësve, përsa i përket planifikimit urban dhe kontrollit të zhvillimit. Më konkretisht, përmendet se:

1. Çdo bashki duhet të institucionalizojë organe, kompetenca e të cilave do të jetë ekzekutimi i aktiviteteve që kryhen, përsa i përket planifikimit hapësinor dhe kontrollit të zhvillimit, ashtu siç ato përcaktohen nga legjislacioni në fuqi dhe dispozitat e ligjit në fjalë.
2. Duhet të tregohet vëmendje për parimet e vetëadministrimit lokal, me qëllim që profesionistët të kenë kualifikimet përkatëse dhe eksperiencën e punës në sektorët përkatës për ekzekutimin e detyrave që parashikohen në ligjin në fjalë. Numri minimal i profesionistëve që duhet të ketë çdo njësi vendore vetëadministrimi duhet të përcaktohet nga Këshilli Ministror në bazë të madhësisë së popullsisë të njësive të administratës vendore, por në asnjë rast ky numër nuk duhet të jetë më i vogël se gjashtë profesionistë.
3. Formimi akademik i profesionistëve për çdonjërin prej katër sektorëve që përcaktohen në paragrafin 2 të nenit në fjalë përcaktohet kështu:
 - a. Për planifikimin territorial: planifikimi urban, hapësinor dhe territorial dhe administrimin, urbanistikë apo planifikim urban dhe specialitete të tjera të përafërta, në përputhje me legjislacionin për arsimimin.
 - b. Për kontrollin e zhvillimit: specialitetet që përcaktohen në hapësirën (a) të paragrafit në fjalë, juridik, arkitekturë, inxhinieri ndërtimi, topogjeodezi.
 - c. Për mbrojtjen mjedisore: administrim i mjedisit urban, inxhinieri mjedisore dhe agromjedisor, arkitekturë dhe planifikim fushe, gjeologji, inxhinieri pyjore.
 - d. Për administrimin e amzës: GIS dhe topogjeodezi, ose në rast mungese, planifikim urban territorial, urbanistikë, planifikim urban, inxhinieri ndërtimi, ose arkitekturë me arsim dhe eksperiencë në GIS dhe topogjeodezi.
4. Në rastet kur nuk është e mundur të përmbushen kërkesat e paragrafeve 2 dhe 3 të nenit në fjalë, vetëadministratat vendore do të duhet të ushtrojnë planifikimin e tyre territorial dhe zhvillimin nëpërmjet ngarkimit të punës te ndërqeverisja vendore, në zbatim të legjislacionit.

Autoritetet vendore urbanistike ushtrojnë kompetencat e tyre në të gjithë sipërfaqen e tyre administrative.

Organizimi – Struktura – Potenciali Njerëzor & Infrastruktura e Logjistikës

Drejtoria e planifikimit dhe zhvillimit të zonës dhe strehimit, ka një strukturë unike dhe nuk formohet nga Sektorë/Zyra të mëvetësishme.

Në vija të përgjithshme, megjithë mungesën e sektorëve të rëndësishëm në strukturën e drejtorisë në fjalë, mungesën e procedurave të standartizuara dhe të dokumentuara të programatizimit, ndjekjes dhe vlerësimit të aktiviteteve dhe zbatimin e një plan veprimi vjetor dhe jo afatmesëm, nuk

duket se ekzistojnë probleme serioze të organizimit dhe administrimit në mjedisin e brendshëm të drejtorisë në fjalë.

Ndërkohë, drejtorja në fjalë, si një prej sektorëve jetikë të Organizmit të Administratës Vendore, ndikohet logjikisht nga problemet organizative të gjërave që shqetësojnë Bashkinë. Për shembull, mungesa e personelit shkencor të specializuar në pozicionet kyçe të Organizmit, mungesa e komunikimit të brendshëm dhe informimit, ose edhe zbatimi i programatizimit afatgjatë, e bëjnë joefikas mekanizmin e prodhimit të Veprës së Bashkisë, duke penguar njëkohësisht edhe veprimet e Drejtorisë.

Nga totali i personelit të Bashkisë, njëzet e dy (22) janë nëpunës të personelit të drejtorisë në fjalë. Më konkretisht, në Drejtorinë e Bashkinë, 15 nëpunës kanë arsim të lartë dhe nëpunësit e tjerë kanë arsim të mesëm dhe njohje të gjuhëve të huaja (anglisht). Gjithashtu, të gjithë nëpunësit kanë, të paktën njohuri bazë të përdorimit të kompjuterit dhe programeve të tij.

Tabela në vijim formulon analitikisht numrin e nëpunësve të Drejtorisë së Bashkisë sipas nivelit të Arsimit.

Struktura Administrative e Bashkisë	Numri i Nëpunësve	Të diplomuar me arsim të lartë	Të diplomuar me arsim të mesëm
Bashkia Pustec	22	15	7
Totali	22	15	7

Tabela 5.1.3: Potenciali Njerëzor sipas Sektorit dhe Nivelit Akademik i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të zonës dhe strehimit për Bashkinë Pustec (Burimi: Bashkia Pustec)

Përsa i përket personelit ekzistues të Drejtorisë, gjykohet se është pjesërisht i mjaftueshëm për funksionimin e saj, nga aspekti i formimit shkencor, sipas sektorit të aktiviteteve, pasi të punësuarit, disponojnë eksperiencën dhe njohuritë për realizimin dhe rregullimin e të gjithë aktiviteteve të drejtorisë.

Përsa pajisjeve mekanike, Drejtorja e planifikimit të zonës dhe strehimit nuk është mjaftueshëm e pajisur përsa i përket mjeteve përkatëse. Theksohet se përsa i përket pajisjeve mekanike brenda ndërtesës (sisteme ngrohjeje, ajër i kondicionuar, mbrojtjeje nga zjarri, etj.), nuk janë depozituar të dhëna.

Në lidhje me pajisjet teknike, nuk ekzistojnë të dhëna të mjaftueshme me qëllim që të bëhet vlerësimi i gjendjes së pajisjeve.

Përsa i përket telekomunikacioneve, në shërbimin e Bashkisë Pustec ekziston akses në internet për të gjithë kompjuterat me shpejtësi 50Mbps, por edhe lidhje me rrjetin publik. Nuk ekziston rrjet lokal ndërmjet kompjuterave të Bashkisë. Përsa i përket pajisjeve përkatëse, nuk janë depozituar të dhëna. Në përgjithësi, theksohet fakti se nevoja e optimizimit të kompjuterizimit të Drejtorisë së planifikimit dhe zhvillimit të zonës dhe e strehimit si edhe e të gjithë Bashkisë.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhëna në lidhje me vendosjet e ndërtesave, pajisjet mekanike dhe teknike si edhe programet kompjuterike të Bashkisë Pustec.



INFORMATIZIMI		
Lloji i pajisjes (Hardware, Periferike)	Numri	
Kompjutera	N/A	N/A
Ekrane	N/A	
Tastiera	N/A	
Maus kompjuteri	N/A	
Printera	N/A	
UPS	N/A	
Lloji i pajisjes (Rrjet - Komunikacion)	Numri	
Modem	N/A	
Hub	N/A	
Akses në Internet	Po	N/A
Rrjet lokal	Jo	
Lloji i pajisjes (Software)	Disponon	Numri i përdoruesve
WINDOWS 7	Po	N/A
WINDOWS 8.1	Po	N/A

Tabela 5.1.4: Vendorsjet e ndërtesave – Pajisje mekanike – Informatizimi i Bashkisë Pustec (Burimi: Bashkia Pustec)

Të dhëna ekonomike

Shërbimi nuk ka buxhetin e vet. Financat e saj përshihen në njësinë e mëposhtme të Kapitullit në fjalë, ku edhe formulohen Të Ardhurat dhe Shpenzimet e Bashkisë Pustec, në total. Theksohet se të dhënat për koston e realizimit të aktiviteteve të Shërbimit Teknik nuk mund të përjashtohen për shkak se në Bilanc – Situacionet e rezultateve të përdorimit, kosto e realizimit shfaqet në total për të gjithë Bashkinë. Ndërkohë, nga të dhënat e mëposhtme duket se një pjesë e madhe e të ardhurave të Bashkisë përdoret për mbulimin e shërbimeve urbane dhe investimeve.

Në tabelat e mëposhtme paraqiten të dhëna në lidhje me gjendjen ekonomike (të ardhurat - shpenzimet) të Bashkisë së re të zgjeruar Pustec.

Të ardhurat

Në vitin 2016, Bashkia Pustec ka të ardhura/buxhet në vlerën prej 49.793.000 lekë. Respektivisht, në vitin 2017, të ardhurat/buxheti i Bashkisë ishte në vlerën prej 69.998.000 lekë, ndërsa paraqitet ndryshim vjetor i klasës prej 40,58% në lidhje me vitin e kaluar. Të ardhurat e Bashkisë për vitet 2016-2017 në total janë në vlerën prej 119.791.000 lekë.



Për 1000 lekë

Bashkia Pustec	2016	2017	Totali 2016-2017	Ndryshimi vjetor (%)
Të ardhura	49.793	69.998	119.791	40,58%

Tabela 5.1.5: Të ardhurat/ Buxheti i Bashkisë Pustec gjatë viteve 2016-2017 (Burimi: Bashkia Pustec)

Përsa i përket çështjeve ekonomike të Bashkisë, dhe në veçanti të të ardhurave, këto vijnë kryesisht nga të ardhurat nga taksat, të ardhurat nga shpërblimet, transfertat ndërqeveritare, si edhe të ardhurat nga burime të tjera.

Llojet e të ardhurave	Viti 2016	Përqindja % 2016	Viti 2017	Përqindja % 2017
Të ardhura nga taksat	1.553	3,12%	875	1,25%
Të ardhura nga shpërblimet	2.310	4,64%	2.747	3,92%
Transferta ndërqeveritare	44.395	89,16%	50.847	72,64%
Të ardhura nga burime të tjera	1.535	3,08%	15.529	22,18%
Totali	49.793	100,00%	69.998	100,00%

Tabela 5.1.6: Të ardhurat e Bashkisë sipas llojit të të ardhurave gjatë viteve 2016-2017 (për 1000 leke)

Siç konstatojmë të ardhurat nga 49.793.000,00 Lekë në vitin 2016 ishin në vlerën prej 69.998.000,00 Lekë në vitin 2017. Kjo rritje e madhe i detyrohet mos përthithjes së transfertave ndërqeveritare të vitit 2016, duke sjellë si rezultat transferimin e tyre në vitin 2017. Më analitikisht dhe përsa i përket llojit të të ardhurave dhe kontributit të tyre në të ardhurat totale, për vitin 2016, 89,16% e totalit të të ardhurave vjen nga transfertat ndërqeveritare, 3,12% nga të ardhurat nga taksat, 4,64% nga të ardhurat nga shpërblimet dhe 3,08% nga të ardhurat nga burime të tjera si të ardhurat e trashëguara. Në vitin 2017, 72,64% e totalit të të ardhurave vjen nga transfertat ndërqeveritare, 1,25% nga të ardhurat nga taksat, 3,92% nga të ardhurat nga shpërblimet dhe 22,18% nga të ardhurat nga burime të tjera si të ardhurat e trashëguara. Të dhënat e sipërpërmendura paraqiten edhe në diagramët që vijojnë, ku paraqitet gjithashtu ecuria e të ardhurave, si edhe përqindja e tyre e kontributit në totalin e të ardhurave për vitet respektive.






Diagrama 5.1.1: Të ardhurat e Bashkisë gjatë viteve 2016-2017




Diagrama 5.1.2: Të ardhurat e Bashkisë sipas llojit të të ardhurave gjatë viteve 2016-2017

Niveli i ulët i arkëtimit të të ardhurave të Bashkisë tregon nivelin e ulët të zhvillimit ekonomik të zonës, por edhe shkallën e vogël të sipërmarrjeve që kontribuojnë në ecurinë e të ardhurave.

Më poshtë paraqiten shpenzimet e Bashkisë gjatë viteve 2016 dhe 2017. Kategoritë kryesore të shpenzimeve i përkasin investimeve, pagave, shpenzimeve funksionale, sigurisë sociale, mbrojtjes sociale dhe transporteve.



Për 1000 Leke

Kategoritë e shpenzimeve	Viti 2016	Përqindja % 2016	Viti 2017	Përqindja % 2017
Shërbime të përgjithshme	30.609,00	61,47%	31.491,00	44,99%
Sektori parësor – transporte	3.133,00	6,29%	22.307,00	31,87%
Shërbime ndaj të tretëve	0,00	0,00%	1.000,00	1,43%
Shpenzime për shfaqje kulturore	0,00	0,00%	0,00	0,00%
Arsim	6.651,00	13,36%	5.965,00	8,52%
Shpenzime për politikën sociale	9.401,00	18,88%	9.233,00	13,19%
Total	49.794,00	100,00%	69.996,00	100,00%

Tabela 5.1.7: Shpenzimet e Bashkisë gjatë viteve 2016-2017

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatojmë se për vitin 2016 shpenzimet totale të vitit ishin në vlerën prej 49.794.000,00 Lekë, ndërsa për vitin 2017 pati një rritje të madhe të shpenzimeve, për shkak të rritjes së buxhetit të investimeve, që pati si rezultat vlerën prej 69.996.000,00 Lekë. Më analitikiht, përse i përket vitit 2016 vëllimi kryesor i shpenzimeve i përket shërbimeve të përgjithshme me përqindje totale prej 61,47%, vijojnë shpenzimet e politikës sociale me përqindje 18,88%, arsimi me përqindje totale 13,36% dhe vijojnë transportet dhe investimet e tjera. Përse i përket vitit 2017, vëllimi kryesor i shpenzimeve i përket shërbimeve të përgjithshme me përqindje totale prej 44,99%, vijojnë sektori parësor dhe transportet me përqindje 31,87%, shpenzimet e politikës sociale me përqindje totale 13,19%, dhe vijojnë arsimi, shërbimet ndaj të tretëve dhe më konkretisht strehimi, zhvillimi komunal dhe ofrimi i ujit dhe investime të tjera. Rritje e rëndësishme e shpenzimeve vërehet në sektorin parësor dhe më konkretisht në transportet. Theksohet fakti se përgjatë viteve 2016-2017 nuk pati investime për shfaqje kulturore, si edhe gjithashtu shpenzimet për banim, ofrimin e ujit dhe për zhvillimin komunal ishin zero.




Diagrama 5.1.3: Shpenzimet e Bashkisë gjatë viteve 2016 - 2017

Bashkia Pustec	2016	2017	Totali 2016-2017
Të ardhura	49.793,00	69.998,00	119.791,00
Shpenzime	49.794,00	69.996,00	119.790,00
Rezultati neto pozitiv	-1,00	2,00	1,00

Tabela 5.1.8: Të ardhurat – shpenzimet e Bashkisë Pustec gjatë viteve 2016-2017 (për 1000 Lekë)

Duke krahasuar totalin e të ardhurave me totalin e shpenzimeve konstatohet se Bashkia Pustec bën balancim të të ardhurave dhe shpenzimeve dhe kjo do të thotë se nuk mban rezerva.

Duke marrë parasysh recesionin e përgjithshëm ekonomik të Organizmit të Administratës Vendore të Bashkisë Pustec, në veçanti gjendja ekonomike e Shërbimit gjykohet si relativisht jo e kënaqshme.

Një prej faktorëve shkaktarë kryesore konsiderohet mungesa e input-eve që rrjedhin nga rëndesa ekonomike (detyrimet) e marrësve për ndërtimin dhe riparimin e trotuareve, mungesë e cila i detyrohet dobësisë ose mungesës së iniciativës për arkëtimin e tyre nga vetë Autoriteti Bashkiak. Përveç të tjerave, Drejtoria e Shërbimeve Teknike bën përpjekje për të shfrytëzuar sistematikisht thuajse të gjithë burimet e mundshme të të ardhurave, që lidhen me futjen në skema financiare dhe Programe të Qarkut, të vendit si edhe në programe të huaja (B.E., SHBA).

Drejtoria në fjalë nuk disponon metodë / mekanizëm sistematik për vlerësimin e efikasitetit të shërbimeve dhe aktiviteteve të saj. Përkundrazi, për madhësinë e efikasitetit duket se ekzistojnë vetëm vlerësime empirike, të cilat bazohen ekskluzivisht në kritere cilësore. E njëjta gjë vlen edhe për përcaktimin dhe vlerësimin e përzjerjes civile.

5.2. Zhvillimi i kapaciteve dhe marrëveshjet e zbatimit

Përfundime – Propozime

Përsa i përket gamës së shërbimeve, pjesërisht shfaqen mungesa, edhe pse bëhen përpjekje të koordinuara për ofrimin e barabartë të shërbimeve për të gjithë qytetarët, pa dallime dhe kufizime. Këto mungesa bëhen më shumë të ndjeshme për individët me nevoja të veçanta (njerëzit me aftësi të kufizuara), të cilët edhe pse përdorin shërbimet teknike në shkallë të mjaftueshme, për shkak të kushteve ekzistuese të qarkullimit, kalueshmërinë e kanë të vështirë ose të kufizuar në shumë pika qendrore të qytetit, ndërmjet të cilave edhe në Bashki, ku ndodhet edhe drejtoria në fjalë. Gjithashtu, regjistrohet shkallë relative e nën-shërbimit të të gjithë qytetarëve dhe të marrësve të tjerë të Shërbimit, për shkak të mos decentralizimit të shërbimeve të ofruara të Drejtorisë, që bën të pashmangshme nevojën e pjesëmarrjes së prëdoruesve në hapësirat e Bashkisë.

Përveç mungesave të sipërpërmendura që konstatohen, në lidhje me shërbimin e mjaftueshëm të grupeve të marrësve nga Drejtoria në fjalë e Bashkisë Pustec, vërehen mungesa edhe në mbulimin e nevojave të qytetarëve.

Nga sa përmendet më sipër, është e dukshme mungesa e përcaktimit të qartë dhe të fokusuar – nga ana e Drejtorisë – e nevojave të veçanta të qytetarëve. Investigimi dhe regjistrimi i nevojave të marrësve dhe formulimi i imazhit të qartë për kërkesën e përgjithshme të shërbimeve të ndryshme teknike ndihmon në planifikimin racional të Shërbimit dhe në kryerjen sa më efektive të aktiviteteve të saj, me bosht kryesor përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara.

Njëkohësisht, për shërbimin më të mirë të qytetarëve dhe të grupeve të tjera të prëdoruesve të shërbimeve të Drejtorisë në fjalë, gjykohet e domosdoshme kryerja e drejtëpërdrejtë e një sërë ndërhyrjeve përmirësuese. Për shembull, duhet të gjenden hapësirat e përshtatshme urbane për sigurimin e vendeve të parkimit, të rehabilitohen problemet e qarkullimit, duke rishqyrtuar edhe një herë planifikimin e qarkullimit të qytetit, dhe të përmirësohen sipërfaqet e rrugëve brenda kufijve të Bashkisë. Njëkohësisht, duhet të bëhet mirëmbajtje në rrjetet publike rrugore, riparime të dëmeve

në rrugë, përmirësime në trotuare, që në disa raste thuajse nuk ekzistojnë fare, duke vështirësuar në këtë mënyrë lëvizjen e qytetarëve dhe të grupeve të sëmura të qytetarëve. Duhet të ndërtohen facilitete të reja bashkëkohore sportive si edhe të forcohen ndjeshëm edhe në numër infrastrukturat e argëtimit dhe të gjelbërimit (sheshe, parqe, kënde lojërash për fëmijë, etj.). Në ndërhyrjet e rëndësishme me prioritet të drejtëpërdrejtë konsiston edhe kujdesi për lëvizjet e përditshme të individëve me nevoja të veçanta brenda rrjetit urban. Së fundmi, në lidhje me mbrojtjen e mjedisit, duhet të bëhen përpjekje për riciklimin dhe ripërdorimin – shfrytëzimin e materialeve dhe për përmirësimin e gjelbërimit urban.

Nga ana e tyre qytetarët mund të marrin pjesë duke dhënë mbështetjen e tyre në përmirësimet e sipërpërmendura, duke kufizuar në mënyrë të rëndësishme përdorimin e automjeteve të tyre private, duke bërë ndarjen e mbeturinave në banesat e tyre dhe, mbi të gjitha, duke u kujdesur për mbrojtjen e gjelbërimit urban (ose jo).

Për vazhdimin e veprave, arritjen e qëllimeve, por, kryesisht për mbulimin e nevojave, kërkohen burime të cilët nuk janë gjithmonë të disponueshëm. Për këtë arsye, hartohet çdo vit Programi i veprave të prioritetit për çdo periudhë administrative (Programi Teknik Vjetor). Përveç zbatimit, ndërkohë, të këtij Programi, vazhdon që Shërbimin ta shqetësojë, si problemi kryesor i realizimit të veprave, vonesa në pagesa e urdhër-pagesave, fakt i cili sjell edhe vonesa të rëndësishme kohore në përfundimin e veprave. Vonesa në pagesa i detyrohet, mbi të gjitha, fluksit financiar jo të rregullt të programeve, por edhe problemeve të kreditimeve të disponueshme të Bashkisë Pustec.

Gjithashtu, rezulton një problem i rëndësishëm gjatë fazës së realizimit, në rastet kur vlera e financimit të veprave zhvillimore është më e vogël se ajo e parashikuar, duke sjellë si pasojë nevojën e mbështetjes financuese nga burime bashkiake.

Ashtu siç u përmend edhe në kapitullin e mëparshëm, duke patur parasysh mënyrën e funksionimit të problemeve tashmë ekzistuese, nuk ekzistojnë hapësira përmirësimi të efikasitetit dhe efektivitetit të aktiviteteve të Shërbimit, pa rritjen e domosdoshme të burimeve. Faktor përcaktues do të jetë zbatimi i Sistemit të Administrimit nëpërmjet qëllimeve të matjes nga Drejtoria në fjalë, për vënien e qëllimeve më të sakta dhe të qarta dhe përcaktimin e “performancës” së qëllimeve.

Gjithashtu, gjykohet i domosdoshëm zbatimi, nga ana e Drejtorisë në fjalë, e Sistemit të Administrimit EMAS, duke mbajtur të dhëna si për procedurat funksionale ashtu edhe administruese. Në kuadrin e zbatimit të Sistemit konkret, do të duhet të ekzistojë informimi i domosdoshëm i të gjithë të përfshirëve, por në përputhje me ato që parashikohen, do të duhet të kryhet kontroll nga një Audit i certifikuar.

Gjithashtu, pika kritike për përmirësimin e cilësisë dhe të efikasitetit të shërbimeve teknike përbëjnë nga njëra anë planifikimi dhe zbatimi i Sistemeve të Cilësisë, si ai i Certifikimit të Mjaftueshmërisë Administrative të shërbimeve të Bashkisë dhe nga ana tjetër aktivizimi i njësisë së Kontrollit të Brendshëm. Theksohet se, në këtë drejtim, gjykohet e qëllimshme dhe e domosdoshme mbështetja paralele e Shtetit në kuadrin e reformës administrative, që do të sjellë përshpejtimin e procedurave që kërkojnë kohë. Në veçanti, rol të rëndësishëm ka kodimi tematik i dispozitave, ligjeve, urdhërave etj, pa nevojën e nxjerrjes së qarkoreve sqaruese apo ndryshimeve, dhe regjistrimi i dispozitave të mëparshme.

Gjithashtu, do të duhet të parashikohen nga njëra anë procedura të shpejta të kryerjes dhe gjykimit të çështjes dhe nga ana tjetër vënia e dënimeve më të rrepta si për shembull për pushtimin arbitrar



të pronës së paluajtshme komunale, administrimi dhe zgjidhja e të cilës do të dojë më shumë se një dyvjeçar.

Në rritjen e shkallës së kënaqësisë së qytetarëve do të kontribuonte në mënyrë aktive përmirësimi i efikasitetit dhe efektivitetit të aktiviteteve të Drejtorisë në fjalë, që, siç u përmend edhe më lart, është i mundur, duke patur sigurisht parasysh disponueshmërinë e burimeve të domosdoshme, të zbatimit të Sistemeve të Cilësisë, aktivizimit të Njësisë së Kontrollit të Brendshëm si edhe të mbështetjes së shtetit.

Për më tepër, hapësira përmirësimi të procedurave funksionale të Drejtorisë mund të rezultojnë me vendosjen e sistemit të vlerësimit të shërbimeve, në bazë të indekseve të efikasitetit, mjet i cili do të ndeshet me probleme të rëndësishme, mbi të gjitha, pasi regjistrohen mungesa të rëndësishme parësore përsa i përket zbatimit të procedurave të programatizimit, ndjekjes dhe vlerësimit të veprimeve të Shërbimit në fjalë. Këto mungesa rezultojnë, por njëkohësisht edhe forcohen, nga problemet që shqetësojnë, jo vetëm Drejtorinë në fjalë, por të gjithë Organizmin e Administratës Vendore të Bashkisë Pustec dhe i përkasin çështjeve të organizimit dhe administrimit, programatizimit, hierarkisë, prodhueshmërisë, koordinimit dhe komunikimit të brendshëm ndërmjet Sektorëve dhe, në përgjithësi, strukturës organizative.

Zgjidhja e problemeve të sipërpërmendura, zbatimi i sistemeve dhe metodave të përmirësimit të efikasitetit të procedurave funksionale të Shërbimit, si edhe administrimi / përballja e faktorëve ekzogjenë (psh. vonesa në pagesa të urdhër-pagesave) që shkaktojnë probleme në realizimin dhe përfundimin e veprave, gjykohen si pika kyçe të përmirësimit të cilësisë dhe efikasitetit të veprimtarive të Drejtorisë në fjalë, me bosht kryesor shërbimin më të mirë dhe më të shpejtë të qytetarit.

Përsa i përket komunikimit të Drejtorisë me marrësit e saj, theksohen pjesërisht mungesa. Përdoruesit e shërbimeve teknike (kontraktorë të Punëve Publike, furnitorë, etj.) informohen me të gjitha mënyrat ligjore të parashikuara në lidhje me shërbimet e ofruara dhe veprimet e parashikuara të Drejtorisë në fjalë. Për informimin e grupeve të marrësve në lidhje me çështje të përgjithshme, Drejtorja e Shërbimeve Teknike do të duhet të botojë Njoftime për Shtyp ose edhe çështje të Këshillit Bashkiak. Ndërkohë, regjistrohen mungesa në lidhje me informimin e të gjithë qytetarëve për llojet dhe numrin e shërbimeve të ofruara ose për vepra që janë në fazën e realizimit të tyre dhe, për pasojë, shkaktojnë probleme/acarime në lëvizjen e përditshme (psh. rrjete të reja rrugore, ndërtime të reja, etj.). Për rrjedhojë, informimi i Veprës së prodhuar e Drejtorisë në fjalë, përbën prioritet për Bashkinë, kryesisht për informimin e qytetarëve për mosfunksionet emergjente brenda rrjetit urban.

Nga ana tjetër, përsa i përket informimit të Shërbimit në lidhje me kërkesat dhe nevojat e qytetarëve, do të duhet të rekomandohet Zyra e Shërbimit të Qytetarëve, me qëllim që të ekzistojë zgjidhje e çfarëdolloj problemi dhe kërkesë të qytetarëve brenda një periudhe kohore të logjikshme, duke patur njëkohësisht parasysh mundësinë e "pjesëmarrjes" së marrësve – qytetarëve në procesin e marrjes së vendimeve të Shërbimit. Për shembull, në rastet e Veprave – Veprimeve të mëdha, në lidhje me buxhetin dhe rëndësinë e tyre, Bashkia Pustec do të duhet të zhvillojë procese këshillimi.

Përsa i përket organizimit dhe strukturës së Drejtorisë në fjalë, kërkohet një riorganizim, për shkak të decentralizimit të kompetencave, përmirësimit të cilësisë së shërbimeve të ofruara dhe shërbimit më të mirë të qytetarëve.

Më konkretisht, Drejtoria do të duhet të vijojë me krijimin e zyrave dhe sektorëve të mëposhtëm në kuadrin e vënies së qëllimeve për nevojat e shërbimit dhe të efikasitetit:

- Zyra e Drejtorisë,
- Zyra e Sigurisë së Kalueshmërisë për personat invalidë
- Sektori i Programatizimit të Zhvillimit – Cilësisë dhe Efikasitetit
- Sektori i Veprave Teknike – Kadastrës - Shërbimeve
- Sektori i Mjedisit
- Sektori i Urbanistikës
- Sektori i Planifikimit të Trafikut dhe Rregullimeve
- Sektori i Veprave Elektromekanike dhe Zbatimeve Energjike
- Sektori i Poshteve - Pemëve
- Sektori i Furnizimeve



Theksohet nevoja e krijimit dhe funksionimit të Zyrave dhe Sektorëve të sipërpërmendur për shkak të decentralizimit të kompetencave, përmirësimit të efikasitetit dhe efektivitetit të aktiviteteve në funksion dhe forcimit të veprimeve të kujdesit social të Bashkisë. Për më tepër, funksionimi i tyre është me rëndësi të madhe për përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit të të gjitha veprimeve të Organizmit të Vetëadministrimit Vendor. Gjithashtu, theksohet se mund të ekzistojë bashkim i sektorëve të sipërpërmendur, në varësi të nevojave dhe burimeve të disponueshme të drejtorisë në fjalë.

Në kuadrin e organizimit të gjerë të Bashkisë, rol të rëndësishëm kanë bashkëpunimet e Drejtorisë me entet e jashtme, për përfundimin më të shpejtë të çështjeve dhe problemeve. Në vija të përgjithshme, nuk shfaqen probleme në koordinim, gjatë bashkëpunimit të Drejtorisë së Shërbimeve Teknike me Entet e sipërpërmendura. Ndërkohë, ndonjëherë gjatë bashkëpunimeve, kryesisht të Drejtorisë me Entet e sektorit publik, regjistrohen, edhe pse jo në shkallë të rëndësishme, probleme konfuzioni të kompetencave, kryesisht, gjatë procesit të marrjes së vendimeve. Këto probleme supozohen në bazë si të shumëllojshmërisë dhe kompleksitetit të aktiviteteve ashtu dhe të shumëllojshmërisë së kuadrit të paqartë ligjor, elementë që shqetësojnë të gjithë Sistemin e Administratës Vendore dhe të Administratës Publike.

Siç u përmend edhe në kapitullin e mëparshëm, në përputhje me kërkesat që përcaktohen nga Ligji 07/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, Drejtoria e planifikimit dhe zhvillimit të zonës dhe strehimit e Bashkisë Pustec, i përmbush pjesërisht kushtet e kërkuara.

Nevoja më bazë, përsa i përket personelit të Drejtorisë, fokuson mbulimin e pozicioneve organike boshe me personel dinamik, siç parashikohet në legjislacionin në fuqi. Përveç këtyre, gjykohet gjithashtu e nevojshme plotësimi i drejtorisë me kuadro të lartë të Administratës, të cilët nga njëra anë disponojnë specializim shkencor të dokumentuar dhe të konsoliduar dhe nga ana tjetër njohuri dhe eksperiencë në marrjen teknike të vendimeve.

Përsa i përket personelit ekzistues të Drejtorisë, gjykohet i mjaftueshëm për funksionimin e saj, pasi të punësuarit, disponojnë eksperiencën dhe njohuritë e duhura për përfundimin dhe rregullimin e të gjithë aktiviteteve të saj. Ndërkohë, gjykohet emergjente nevoja e trajnimit të vazhdueshëm për personelin, dhe madje, në Programe të specializuara të formimit shkencor sipas sektorit të kompetencave. Duhet të njihet si pikë kyçe riorganizimi për Shërbimin, mbi të gjitha, nga drejtuesit



politikë dhe pas faktorëve të shërbimit, përmirësimi i personelit, për arritjen e të cilit rol përcaktues ka pjesëmarrja e rregullt e personelit në programe trajnimi.

Më poshtë paraqiten programet e trajnimit, të cilat do të ndihmojnë në mënyrë përcaktuese në përmirësimin e funksionit të Drejtorisë:

- Programe në çështje konkurseshe për furnizimet dhe vepra
- Programe kompjuterizimi dhe ruajtje të arkivës
- Programe mësimi dhe formimi të programeve të veçanta logjistike (ArcGIS, AutoCAD, CorelDRAW, Adobe Photoshop, MS Office, SCADA κλπ.)

Përsa i përket infrastrukturave të ndërtesave dhe atyre materiale-tekniqe të Drejtorisë në fjalë, theksohet nevoja e mirëmbajtjes së faciliteteve ekzistuese si edhe përmirësimi i tyre nëse kërkohej, në periudha të rregullta kohore. Më konkretisht, theksohet nevoja e mirëmbajtjes së ndërtesës në pjesën e brendshme dhe të jashtme (lyerje) dhe mirëmbajtja e kornizave të dritareve (në pjesën e brendshme dhe të jashtme), të cilat do të ndihmojnë në ekonomizimin e energjisë dhe për pasojë në reduktimin e shpenzimeve të Bashkisë. Gjithashtu, vlerësohet me prioritet të drejtëpërdrejtë konfigurimi i hapësirave ekzistuese të shërbimit ose edhe përdorimi i një hapësire të re brenda ndërtesës, nëse kjo kërkohej, me qëllim që të arrihet modernizimi i mjedisit të punës dhe të konsolidohet prodhueshmëria e shërbimit, dhe gjithashtu të mbulohen nevojat kryesore të arkivimit.

Siç u përmend edhe në kapitullin e mëparshëm, nuk ekziston mjaftueshmëri përsa i përket automjeteve të shërbimit për rregullimin e kompetencave të drejtorisë. Për këtë arsye, gjykohej e domosdoshme blerja e automjeteve të shërbimit, të reja ose të përdorura, sipas nevojave të shërbimit. Më konkretisht, është emergjente blerja ose marrja me qira e automjeteve të mëposhtme:

1. Automjete shërbimi për pasagjerë që do të përdoren për lëvizjen e të punësuarve të shërbimit
2. Automjete shërbimi 4X4 për transportin nga vendi ku do të zhvillohen punimet
3. Kamionë për transportin e materialeve të ndërtimit
4. Ekskavator
5. Kamionë ngarkim-shkarkim
6. Transformatorë
7. Ngarkues

Theksohet se, karakteristikat teknike dhe numri i automjeteve të shërbimit përcaktohen në bazë të nevojave, si edhe të burimeve të disponueshme të shërbimit.

Përsa i përket pajisjeve teknike të drejtorisë në fjalë, gjykohej e domosdoshme blerja e kompjuterave të teknologjisë së fundit dhe e pajisjeve të tjera periferike, si printera, makineri shumëfunktionale, plotter etj., si edhe e pajisjeve që ndihmojnë në aksesin më të shpejtë në internet (Router – Modem). Gjithashtu, gjykohej e domosdoshme blerja e lejes së përdorimit të programeve të reja logjistike dhe përmirësimi i botimeve të fundit për llojet ekzistuese të programeve logjistike.

Më poshtë, paraqitet tabela me pajisjet teknike që kërkohen për funksionimin racional të Drejtorisë në fjalë.



PAJISJE TEKNIKE QË KËRKOHEN
Lloji i pajisjes
Kompjutera të teknologjisë së fundit (përfshihen pajisjet e tjera periferike si tastierë, maus, ekran)
Server
Printera
Pajisje me shumë funksione
Telefona
Router - Modem
Plotter
GPS
UPS
USB - Flash për ruajtjen e materialeve – Hard Disk i jashtëm
Programe logjistike
MS WINDOWS 2010
MS Office 2007 që 2010
ArcGIS
AutoCAD
CoreIDRAW
Adobe Photoshop
Adobe Acrobat Reader
SCADA

Tabela 5.2.1: Pajisjet teknike që kërkohen për funksionimin e drejtorisë

Përsa i përket kostos së investimeve për rindërtimin e Bashkisë dhe të Drejtorisë së Veprave Publike, Administrimit Territorial dhe Kontrollit, nga të dhënat e mbledhura, është e kuptueshme se Drejtoria e planifikimit dhe zhvillimit të zonës dhe strehimit e Bashkisë Pustec në pesëmbëdhjetë vjeçarim e ardhshëm do të ketë nevojë për të rinovuar dhe plotësuar pajisjet mekanike, si edhe gjithashtu për të rinovuar pajisjet kompjuterike.

Duke patur parasysh se analiza jonë bëhet në bazë të pesëmbëdhjetë vjeçarit, në vijim do të duhet të përcaktohen nevojat e Bashkisë dhe në veçanti të Drejtorisë së Planifikimit Hapësinor dhe Kontrollit të Projekteve Investuese, përsa i përket si potencialit njerëzor ashtu edhe infrastrukturave materiale-teknike, për të gjithë spektrin kohor të analizës. Përsa i përket pajisjeve teknike (Hardware, Software, pajisje të tjera) si kompjutera, Laptop, printera, UPS etj., mund të themi ato kanë një cikël jete pesëvjeçar, pasi pas përfundimit të pesëvjeçarit pajisjet konsiderohen të vjetra dhe kanë nevojë për instalim me qëllim që të mund t'u përgjigjen nevojave të çdo bashkie.

Siç është analizuar tashmë, investimet e parashikuara gjatë periudhës kohore 2018-2032 pritet të jenë në vlerën nga 306,70 milionë Lekë në 107,625 milionë Lekë.





Ankesimi	Bashkëti	I: 19			II: 20-21			III: 22-28					IV: 29-33
		2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028		
Sistemim urbane	63,000,000	40,000,000	11,500,000	11,500,000	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Infrastruktura Rrugore	176,600,000	30,000,000	73,300,000	73,300,000	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Infrastruktura e ujësjellësit	58,000,000	27,000,000	15,500,000	15,500,000	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Infrastruktura energjetike	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Infrastruktura e telekomunikacionit	25,000,000	9,000,000	8,000,000	8,000,000	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Infrastruktura Vdiqëse dhe Kulturore	1,500,000	0	750,000	750,000	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Infrastruktura e trajtimit të ujërave të nërcitura dhe të bardha	176,500,000	63,500,000	32,500,000	32,500,000	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Infrastruktura e menaxhimit të mbeturinave	69,500,000	1,500,000	34,000,000	34,000,000	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Mjedis natyror dhe kulturor	172,200,000	38,650,000	44,275,000	44,275,000	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Zhvillimi ekonomik	307,900,000	41,850,000	133,150,000	132,900,000	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Përmirësim i administratës në Bashki	11,000,000	200,000	5,400,000	5,400,000	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Infrastruktura Sociale	90,800,000	55,000,000	17,900,000	17,900,000	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	1,054,000,000	306,700,000	376,275,000	371,025,000	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Tabela 5.2.2: Investime të parashikuara në Bashkinë Pustec gjatë pesëmbëdhjetë vjeçarit të ardhshëm

Duke patur parasysh,

1. Potencialin njerëzor gjatë pesëmbëdhjetë vjeçarit të ardhshëm, pritet të forcohet dhe të zëvendësohet me potencial të ri, me kualifikime të rritura dhe konsiderohet diçka e sigurt se veprimi në fjalë do të sjellë një rëndësi shtesë të klasës 10%-12%, element i cili do të formulohet në vazhdim.
2. Pajisjet mekanike kërkojnë konsolidim dhe rinovim, dhe konsiderohet fakt se gjatë pesëmbëdhjetë vjeçarit të ardhshëm, do të duhet të ekzistojë një cikël i plotë rinovimi i pajisjeve në fjalë, fakt i cili do të sjellë një rëndësi shtesë të klasës 7%-8% në investimet e bashkive në fjalë.
3. Pajisjet kompjuterike, siç është regjistruar dhe zhvilluar edhe më lart, pritet të zëvendësohen gjatë pesëmbëdhjetë vjeçarit të ardhshëm, të paktën tre herë, duke patur parasysh kohëzgjatjen e jetës së tyre për shkak të intesitetit të teknologjisë, kanë një kohëzgjatje pesë vjeçare.
4. Infrastrukturat e ndërtesave, kërkojnë rinovim ose edhe zëvendësim dhe strategjia në fjalë gjatë pesëmbëdhjetë vjeçarit të ardhshëm, është fakt se do të sjellë nevojën e investimeve edhe në këtë sektor.

Paralelisht me investimet e sipërpërmendura, shpenzim i rëndësishëm do të konsistojë edhe rinovimi i personelit me personel të ri, që do të ketë më shumë kualifikime, fakt i cili do të përmirësojë shërbimet e ofruara të bashkive, por do të rrisë edhe koston funksionale të bashkisë. Në tabelën paraqitet rritja në fjalë e koston funksionale dhe e potencialit njerëzor gjatë pesëmbëdhjetë 15vjeçarit të ardhshëm.

SHPERBLIME & SHPENZIME PËR PERSONELIN E BASHKISË PUSTEC			
	SASIA	VLERA E NJËSISË	SHUMA E SHPENZIMIT
2019	1	9.700	9.700 €
2020	2	10.185	20.370 €
2021	2	10.694	21.389 €
2022	2	11.229	22.458 €
2023	3	11.790	35.371 €
2024	3	12.380	37.140 €
2025	3	12.999	38.997 €
2026	2	13.649	27.298 €
2027	1	14.331	14.331 €
2028	1	15.048	15.048 €
2029	1	15.800	15.800 €
2030	1	16.590	16.590 €
2031	1	17.420	17.420 €
2032	1	18.291	18.291 €
2033	2	19.205	38.411 €
TOTALI			348.613 €

DËSHMI: Konsiderojmë se shpenzimet e personelit do të jenë në vlerën përkatëse të totalit të Bashkisë Pustec në vitin e bazës në vlerën prej 97.000 €, do të rriten çdo vit në vlerën 5% gjatë gjithë kohëzgjatjes së viteve që kemi përlogaritur. Kjo rritje do të vijë si për shkak të rritjes së shpërblimeve, ashtu edhe për shkak të rritjes së numrit të personelit, për shkak të punësimit.

Tabela 5.2.3: Parashikimi i shpenzimeve të personelit për shkak të rinovimit të tij



Në kuadrin e riorganizimit të përgjithshëm të Bashkisë Pustec, propozohet krijimi i sektorëve të veçantë përsa i përket strukturës organizative të Bashkisë Pustec. Më konkretisht, propozohet krijimi i:

- Sektorit të Mbrojtjes Civile
- Sektorit të Turizmit
- Sektorit të Prodhimit Bujqësor dhe Informimit të Fermerëve
- Qendrës së Shërbimit të Qytetarëve
- Sektorit të Kujdesit në distancë (mund të inkuadrohet në sektorin e Kujdesit Social)

Sektorët e sipërpërmendur janë me rëndësi të madhe për Bashkinë Pustec dhe krijimi i tyre do të kontribuojë në decentralizimin e kompetencave të Bashkisë, në përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të aktiviteteve ekzistuese dhe në konsolidimin e veprimeve të kujdesit social të Bashkisë Pustec dhe në përgjithësi në përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit të të gjitha veprimeve të Organizmit të Administratës Vendore.

Në kuadrin e organizimit të gjerë të Bashkisë, është me rëndësi kërkimi i bashkëpunimeve të sektorëve të propozuar me entet e jashtme, për përfundimin më të shpejtë të çështjeve, sipas rastit.



ANEKS

1. DIREKTIVAT/TOR PËR PLANIN SEKTORIAL

TERMAT E REFERENCËS për studimin: “Plani Sektorial për Zhvillimin Turistik në nivel Bashkie ”

I. HYRJE- ZONA E STUDIMIT

Aktiviteti turistik përbën me shumë mundësi burimin më të rëndësishëm të të ardhurave në Bashkinë Pustec dhe një prej karakteristikave më kryesore të identitetit të saj që është duke u krijuar. Paralelisht, vlerësohet se nëpërmjet zhvillimit të turizmit dhe të aktiviteve që lidhen me të (psh. argëtim, aktivitetet të kohës së lirë) do të promovohet zhvillimi i sektorit parësor.

Një sërë karakteristikash dhe cilësish të Bashkisë shprehin mundësinë e tërheqjes së vizitorëve dhe turistëve nga jashtë dhe brenda vendit. Të tilla janë:

- Pozicioni strategjik gjeografik i zonës, ndërsa kufizohet me Greqinë dhe Maqedoninë e Veriut.
- Burimet e disponueshme dhe të njohura të mjedisit natyror dhe kulturor. Bashkia shfaq një sërë monumentesh kulturore dhe historike me karakter fetar dhe historik, disa prej të cilave datojnë që nga shekulli i 13-të dhe 14-të. Disponon florë dhe faunë të pasur të zonës dhe mirëpret specie të veçanta në liqen, livadhe, pyje. Paralelisht, identifikohen mjaft bregdete shkëmbore që janë ende të pashfrytëzueshme.
- Vlera e veçantë ekologjike dhe lokale,
- Njohja e rëndësisë së saj në nivel kombëtar (Parku Kombëtar i Prespës) dhe ndërkombëtar (Parku Ndërkufitar i Prespës me Greqinë dhe Maqedoninë e Veriut, Rezerva e Biosferës së Prespës së Ohrit nga UNESCO) dhe
- Inkuadrimi në rrjete bashkëpunimi.

Për këtë arsye, fshati Zaroshkë është futur në programin e zhvillimit PIZHR të 100 fshatrave, ndërsa e gjithë zona është njohur si vend përparësie për zhvillimin turistik. Së fundmi, një prej qëllimeve strategjike të Bashkisë, në përputhje me PPV është zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit.

Ndërkohë, që të arrihet zhvillimi turistik dhe të shfrytëzohen mundësitë që paraqet Bashkia, konsiderohet i domosdoshëm zbatimi i planit të integruar që do të njohë dhe do të propozojë ndërthurjen e përshtatshme të veprimeve dhe ndërhyrjeve për forcimin dhe diferencimin e produktit turistik. Në këtë kuadër, propozohet hartimi i Planit Sektorial në nivel Bashkie (PSNB)

II. QËLLIMSHMËRIA DHE REZULTATE TË PRITSHME TË PLANIT SEKTORIAL

Qëllim i PSNB është zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit në përmjet forcimit dhe promovimit të formave të reja, alternative të turizmit, si ekoturizmi, agroturizmi, turizmi arsimor, turizmi turistik. Paralelisht, kjo synon hapjen e gjerë të Bashkisë nëpërmjet tërheqjes së vizitorëve dhe shkencëtarëve si edhe bashkëpunimin me bashkitë dhe vendet fqinje. Qëllime të veçantë përbëjnë:



- Krijimi i identitetit të ri dhe forcimi i konkurrencës.
- Sigurimi i administrimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe kulturore.
- Përmirësimi i infrastrukturave turistike dhe krijimi i atyre të reja.
- Krijimi i vendeve të reja të punës.
- Zhvillimi dhe shfrytëzimi i mëtejshëm i produkteve vendase që theksojnë gastronominë e zonës.

Rezultatet e pritshme nga hartimi dhe zbatimi i PSNB-së për zhvillimin turistik do të jenë përmirësimi i cilësisë së jetës dhe të ardhurave vendase të banorëve, mbajtja e banorëve të rinj por edhe tërheqja e banorëve të rinj të përhershëm, si edhe zhvillimi i ekonomisë vendase.

III. PËRMBAJTJA E STUDIMIT

Studimi i PSNB do të hartohet për të gjithë sipërfaqen e Bashkisë, ndërsa pritet që t'i jepet theks i veçantë vendbanimeve në Goricën e Vogël, Pustec dhe Zaroshkë, si qendra ofrimi të shërbimeve turistike si edhe në zonat përreth poleve të tërheqjes së vizitorëve dhe infrastruktura të rëndësishme.

Studimi i PSNB për zhvillimin rural duhet të bazohet në kuadrin ligjor ekzistues dhe të jetë në harmoni të plotë me dispozitat dhe parashikimet e tij, ndërsa gjithashtu duhet të marrë parasysh kuadrin më të gjerë të projektimit, strategjitë kombëtare dhe rajonale përkatëse, si edhe propozimet dhe kushtet e PPV për Bashkinë

Në fazën e parë do të realizohet analiza dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese dhe i problemeve që identifikohen në Bashki. Në veçanti, në këtë seksion studiohen:

- Karakteristikat e kërkesës turistike aktuale .
- Projeksioni i kërkesës turistike.
- Klasifikimi i produktit turistik.
- Vlerësime dhe akomodues të territorit.
- Segmentet kryesore që do të synohen në të ardhmen
- Lokalitetet turistike dhe karakteristikat e tyre.
- Aktivitetet, kryesore dhe dytësore, që mund të zhvillohen sipas produktit turistik.
- Mbrojtja e peizazhit dhe shpallja e zonave të rëndësishme kombëtare.
- Rregullimi dhe kontrolli i përdorimeve të tokës si edhe kushtet e ndërtimit për infrastrukturën turistike.
- Aksesimi në zonë dhe itineraret turistike.
- Mirëmbajtja e infrastrukturës rrugore dhe transporti publik.
- Infrastruktura dhe shërbimet publike që shërbejnë për zhvillimin turistik.
- Analiza SWOT e sektorit.

Në fazën e dytë paraqiten qëllimet strategjike, përparësitë dhe masat e kërkuara që rezultojnë në përputhje me nevojat e zonës, si rezultat i analizës së realizuar në fazën e parë.

Në veçanti, do të bëhen propozime si më poshtë vijon:

- Përcaktimi i formave alternative të turizmit dhe promovimi i praktikave të tyre, të cilat janë të pajtueshme me mjedisin në fjalë, ndërsa paralelisht do të ndihmojnë në reduktimin e sezonalitetit.



2. DIREKTIVAT/ToR PËR PDV

TERMAT E REFERENCËS për studimin "Ndërtim i infrastrukturës për akomodimim kolektiv të krerëve të Bashkisë "

Hyrje

Blegtoria është një aktivitet tradicional ekonomik në Bashkinë Pustec dhe shumë banorë janë të përfshirë në këtë aktivitet në një masë më të madhe ose më të vogël. Aktiviteti i blegtorisë bie ndesh me përdorime të tjera të tokës dhe kryesisht me banim, duke degraduar cilësinë e përditshme të jetës dhe turizmin, duke qenë një pengesë e mundshme për zhvillimin e turizmit, sepse objektet blegtorale janë të vendosura brenda rrjetit rezidencial. Në të njëjtën kohë, vështirësohet zhvillimi i mëtejshëm të blegtorisë. Për më tepër, për shkak të mbikullotjes në kullota të veçanta, pranë vendbanimeve dhe nga mungesa e infrastrukturës së menaxhimit të mbeturinave, ndryshojnë karakteristikat fizike dhe degradon mjedisi natyror në një zonë që është nën mbrojtjen ndërkombëtare.

Një nga objektivat strategjike të PPV për komunën Pustec është zhvillimi i qëndrueshëm i sektorit bujqësor në përgjithësi dhe i blegtorisë në veçanti i kombinuar me menaxhimin racional të kullotave dhe në ekuilibër me zonat e mbrojtura. Një instrument në këtë drejtim është krijimi i parqeve blegtorale përmes zhvillimit dhe miratimit të Planit të Detajuar Vendor (PDV).

Synimi/ Qëllimi i Studimit

Studimi mbi krijimin e një parku blegtoral synon:

- Sigurimin e kushteve më të mira për mirëqenien e kafshëve
- Kushtet më të mira pune për blegtorët
- Bashkëpunim të blegtorëve në nivelin e përdorimit të parkut blegtoral të përbashkët
- Mbrojtje më efektive të mjedisit
- Përmirësim estetik të peizazhit urban
- Menaxhim të plotë shkencor, shfrytëzim dhe përmirësim të potencialit të kullotave
- Prodhim më shumë dhe më cilësor të produkteve blegtorale
- Krijimin e vendeve të reja të punës
- Përmirësimin e të ardhurave të blegtorëve që vijnë nga operimi i organizuar i parkut blegtoral dhe ushqimi i balancuar, zvogëlimi i humbjeve për shkak të përmirësimit të kushteve të jetesës dhe higjenës

Përfitimet që rrjedhin nga zhvillimi dhe zbatimi i PDV për parkun blegtoral bazohen në forcimin dhe zhvillimin e ekonomisë lokale, rritjen e të ardhurave të blegtorëve, mbrojtjen e mjedisit.



Zona e Studimit

Është përzgjedhur për t'u pilotuar një park blegtoral në pjesën veriore të Bashkisë. Ai ndodhet në një distancë e shkurtër nga Rruga Nacionale SH79, duke e bërë atë lehtësisht të arritshëm për punëtorët, si dhe për transportin e produkteve dhe lëndëve të para, ndërsa në të njëjtën kohë nuk është direkt i dukshëm për ata që kalojnë në rrugë. Në të njëjtën kohë, ndodhet pranë pikës kufitare, duke i bërë më të favorshme kushtet për bashkëpunim dhe marketingun e produkteve. 2 pikat e tjera të cilat propozohen me të njëjtin funksion në territorin e Bashkisë gjenden në afërsi me fshatrat Gollomboc dhe Lajthize.



Figura 1. Struktura për blegtorinë kolketive në Goricen e Madhe





Figura 2. Struktura për blegtorinë kolketive në Gallomboc



Figura 3. Struktura për blegtorinë kolketive në Lajthizë



Përmbajtja e studimit

a) Dokumenti për analizën e zonës

Studimi i PDV për krijimin e parkut blegtoral duhet të jetë plotësisht në përputhje me kornizën ekzistuese ligjore dhe si dhe të marrë parasysh planifikimin më të gjerë hapësinor, dhe konkretisht planet kombëtare sektoriale dhe propozimet e PPV të hartuara për Bashkinë. Do të bëhet një analizë dhe vlerësim i situatës aktuale në këtë vend dhe në zonën përreth si dhe lidhur me potencialin blegtoral të Bashkisë. Më konkretisht, studimi do të përfshijë:

- Kuadrin më të gjerë hapësinor dhe ligjor
- Karakteristikat cilësore dhe sasiore të prodhimit blegtoral dhe punësimit në këtë sektor në Bashki
- Percaktimin e kufijve të zonës së studimit dhe dokumentimin e zgjedhjes specifike
- Vlerësimin e ndërhyrjeve të mëparshme - paraqitjen e shembujve dhe praktikave të ngjashme, lokale apo më gjerë.
- Përshkrimin i detajuar i gjendjes aktuale të zonës dhe zonës përreth e cila do të përfshijë:
 - Të shënohen përdorimet aktuale të tokës, karakteristikat operative dhe qarkulluese.
 - Të përshkruhet peizazhi natyror dhe regjistrim i problemeve ekzistuese mjedisore.
 - Regjistrim i infrastrukturës ekzistuese teknike (rrjetet e shërbimeve, rrugët, etj) dhe gjendjes së tyre.
 - Eksplorim Gjeologjik: Të kontrollohet përshtatshmëria gjeologjike e zonës së studimit, me qëllim që të shënohet nëse toka është e përshtatshme, e papërshtatshme ose e përshtatshme nën disa kushte, me qëllim për të siguruar mjedis të strukturuar nga rreziqet natyrore ose rreziqet që vijnë nga ndërhyrjet dhe aktivitetet e njeriut.

Raporti teknik i studimit duhet të shoqërohet me tabelat e nevojshme dhe grafikët të cilët do të ilustrojnë elementet kryesore të analizës.

Baza kartografike do të përfshijë të paktën si më poshtë vijon:

- Harta të shkallës 1:500 deri 1:1.000, ku do të reflektohet situata aktuale, parcelat e tokës, përdorimet ekzistuese të tokës, ndërtesat dhe infrastruktura (rrjete të ujësjellësit, energjisë, rrugëve, etj), kufijtë, përmasat dhe emërtimet. Këto harta do të shoqërohen edhe nga tabela kadastrale ku do të shënohet pronësia aktuale.
- Përveç kësaj do të dorëzohen edhe harta, në të cilat do të përshkruhen përshtatshmëria e tokës dhe gjendja ndërtesave ekzistuese.

Është e nevojshme që raportin teknik të shoqërohet edhe me analiza fotografike e zonës së studimit.

b) Hartimi i zonës në studim.

Regjistrohen karakteristikat gjeometrike (vendndodhja dhe kufijtë e pronës) të sipërfaqes të parkut blegtoral dhe statusi i pronësisë dhe angazhimet që rrjedhin prej tij.



c) Strategjia e zhvillimit të zonës

Bazuar në analizën dhe vlerësimin e situatës aktuale, zhvillohet strategjia e propozuar për zonën e ndërhyrjes, ku specifikon, drejton, plotëson rekomandime të PPV. Identifikohen objektivat strategjike dhe specifike dhe identifikohen zona, fushat në të cilat studimi do të ndërhyjë.

d) Propozime me përkufizime territoriale

Propozimet lidhur me zhvillimin e parkut blegtoral do të përfshijnë:

- Propozimet për përdorimet e propozuara të tokës dhe funksionet/aktivitete lejuara, te kushtezuara dhe ndaluara.
- Propozimet për infrastrukturën e nevojshme: rrjete rrugore, rrjete të furnizimit me ujë, rrjete të kanalizimit, rrjetet të zjarrfikësive, rrjete të ndriçimit elektrik, sisteme të ujitjes së gjelbër, impiante të trajtimit të ujërave të zeza, menaxhim energjetik, ndërtesë për administratën e sipërmarrjeve të parkut, etj.
- Propozimet për zona të përbashkëta (p.sh. parqe të gjelbërta, hapësira për parking, trotuare) dhe infrastrukturën sociale (p.sh. ndërtesë të administratës, stacion për zjarrfikëse, ekspozita produktesh, hapësira për organizimin e prezantimeve). Shënohet se duhet të sigurohet qasje e barabartë dhe e pavarur për të gjithë.
- Vendndodhjet e propozuara të ndërtesave dhe vëllimet e tyre indikative.
- Metoda e aplikimit të instrumenteve për drejtimin e zhvillimit.

e) Rregullorja ePDV-së

Në Rregullore do të duhet të përmbahet:

- Shpjegimet e kodeve që do të përdoren për kategoritë/nënkategoritë/funksionet e përdorimit të tokës, sistemet dhe kategori të tjera.
- Do të duhet të përcaktohen dhe analizohen faktorët dhe variablat e zhvillimit (p.sh. distanca, lartësia maksimale, parcela minimale, etj.) dhe të vendosen linjat e ndërtimit.
- Rregullat e mbrojtjes së mjedisit, peizazhit, dhe burimeve natyrore, në mënyrë që të sigurohet se zhvillimi i propozuar nuk do të ndikojë negativisht.
- Përcaktimi i zonës së mbrojtjes së elementeve ujorë që gjenden në zonën e studimit.
- Të drejtat dhe kufizimet, siç ato burojnë nga kuadri i propozuar i zhvillimit.
- Rregullat për rrjetin rrugor dhe rrjetin e transportit. Do të duhet të përcaktohen kategoritë e rrjetit rrugor, karakteristikat e tyre teknike dhe të përcaktohen parametrat e lëvizshmërisë dhe transportit.

Së fundi, do të duhet të ketë përdorim të lirë të ambienteve edhe nga persona me aftësi të kufizuara.

Harta dhe informacionin gjeohapësinor të integruar në platformën GIS (në përputhje me standardin e Regjistrit Kombëtar të Planifikimit të Territorit).

f) Plani i Veprimit

Do të përfshijë analizën e kostos, si dhe treguesit e ndjekjes së projektit.



Afatet e punës dhe ndarja në faza

Studimi i PDV për parkun blegtoral të Bashkisë Pustec vlerësohet të përfundojë brenda 3 muajve dhe në një fazë. Vijnë brenda 20 ditëve vëzhgimet dhe komentet nga Bashkia, Qarku dhe të gjithë aktorët, si dhe banorët dhe profesionistët e sektorit bujqësor. Më pas, Autoriteti Kontraktor jep udhëzimet përfundimtare mbi përshtatjen e studimit dhe, brenda 20 ditëve nga dërgimi i tyre Kontraktuesit, bëhen dorëzimet përfundimtare, në format elektronik dhe të printuar. Pason procesi i miratimit bazuar në legjislacionin aktual dhe publikimi në RKPT. Dorëzimi do të bëhet në format elektronik dhe të printuar.

Profilat e Ekspertëve, kushtet dhe detyrat

Për hartimin e këtyre PDV-ve nevojitet një Grup Punë i përbërë nga të paktën këto ekspertë:

- Arkitekt/ Planifikues urban
- Inxhinier/ Ekspert transporti
- Inxhinier Ndërtimi
- Inxhinier Topograf
- Ekspert Mjedisi (me liçencë mjedisi)
- Ekonomist (me eksperiencë në çështje të Planifikimit Urban)

Konsulenti, duhet të sigurojë një grup kompakt, me eksperiencë të ngjashme, i aftë në realizimin eficient të qëllimit të punës të këtyre Termave të Referencës.

Konsulenti duhet të dëshmojë:

- aftësi në adresimin e çështjeve kryesore nga një këndvështrim multi-disiplinor;
- njohje të mirë të territorit, veçanërisht të zonave rurale, dhe problematikave përkatëse.

Planet e Detajuara Vendore do të hartohen në bazë GIS, ndaj Konsulenti duhet të sigurojë dhe një njohje të mirë të programeve bazë dhe eksperiencë në punë të ngjashme.

Konsulenti, për një përshkrim më të mirë të qasjes ndaj kësaj detyre të shprehur në këto terma reference mund të paraqesë staf tjetër mbështetës gjatë fazës së Propozimit Teknik.

Përmbledhja e stafit duhet të japë të dhëna të detajuara në lidhje me numrin e personave që do të jenë të angazhuar për të hartuar çdo PDV dhe kohën që secili prej ekspertëve do të shpenzojë në këtë punë.



TERMAT E REFERENCËS për studimin «Organizimi plazheve në Zaroshkë dhe Kallamas»

Hyrje

Turizmi alternativ përbën potencialisht një sektor me mundësi të mëdha zhvillimi në Bashkinë Pustec. Kjo mundësi mund të ndihmojë në rritjen e të ardhurave lokale dhe të formësojë një identitet të ri dhe të fortë. Gjithashtu, vlerësohet se përmes zhvillimit të turizmit alternativ dhe aktiviteteve të lidhura me të (p.sh. rekreacioni, aktivitetet sportive) do të nxitet zhvillimi i sektorit bujqësor. Së fundi, një nga objektivat strategjike të Bashkisë në përputhje me PPV është zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit.

Për të arritur këtë, nga PPV propozohen një sërë ndërhyrjesh dhe infrastrukturash. Disa prej tyre kanë të bëjnë me liqenin dhe pjesën e bregut të liqenit, duke përfshirë organizimin e plazhit dhe zonave me aktivitete mbështetëse.

Liqeni i Madh i Presës përbën karakteristikën dhe tiparin dominues të Bashkisë dhe përcakton identitetin e saj. Është lidhur drejtpërsëdrejti me historinë dhe zhvillimin kulturor të rajonit, si dhe me profilin social dhe ekonomik të këtyre vendbanimeve.

Qëllimi i Studimit

Studimi ka të bëjë me përgatitjen e PDV për projektimin e dy zonave në bregun e liqenit si zona rekreacioni në Zaroshkë dhe Kallamas. Do të përfshijnë krijimin e një plazhi në mënyrë sa më natyrale, që nuk do të ndryshojë bimësinë ekzistuese si edhe krijimin e zonave në vazhdim me plazhet në të cilat do të akomodohen aktivitete mbështetëse dhe shërbime (hapësira të gjelbra, sportive, rekreative).

Qëllimi është nga njëra anë zhvillimi dhe ofrimi i një infrastrukture moderne dhe të përshtatshme për zhvillimin e turizmit alternativ dhe nga ana tjetër përmirësimi i gjendjes natyrore të zonës ripariene.

Me përfundimin e këtij projekti pritet:

- përmirësimi i situatës së Liqenit - tokës dhe i marrëdhënies së banorëve dhe vizitorëve me elementin e ujit
- tërheqja e vizitorëve të rinj dhe turistëve - përmirësimi i vendbanimeve fqinje
- pasurimi dhe përmirësimi i shërbimeve turistike dhe rekreative në bashki
- përforcimi i identitetit të bashkisë
- menaxhimi i qëndrueshëm i mjedisit natyror.

Rajoni i Studimit- Gjendja Aktuale

Në fshatin Zaroshkë, zona ndodhet në pjesën bregdetare në veri lindje të vendbanimit. Distanca është rreth 1.2 km nga qendra e vendbanimit. Është një zonë e madhe e pashfrytëzuar prej 1.8 km. dhe 1.2Ha, e cila paraqet interes të veçantë estetik dhe mjedisor. Sipas situatës ekzistuese, vendi nuk strehon ndonjë aktivitet, ndërsa përdorimi i tokës është përcaktuar si Livadh. Zona përreth përfshijet nga pyje me bimësi të lartë dhe të ulët.

Në zonën e Kallamas, njësia ndodhet në jug të vendbanimit përgjatë bregdetit, në distancë më pak se një kilometër nga qendra e vendbanimit. Është një njësi që shtrihet në 1.7 ha dhe



është e mbuluar nga një sistem natyror, dhe sipas gjendjes ekzistuese, nuk ka shfrytëzim të avantazheve mjedisore që paraqiten nga njësia. Përbëhet nga një ekosistem natyror të shquar, i cili kërkon menaxhim të duhur gjatë remodeling si plazh.

Zhvillimi i projektit përmes studimit të PDV-së, do të jetë rezultat i iniciativës dhe investimeve bashkiake. Do të përfshijë, përtej ridefinimit të liqenit, vendndodhjen e aktiviteteve turistike, të rëndësishme për promovimin e bashkise.



Figura 1: Organizimi i bregut të liqenit në Zaroshtë



Figura 2: Organizimi i bregut të liqenit në Kallamas



Përmbajtja e studimit

a) Dokumenti për analizën e zonës

Studimi i PDV i një poli turistik duhet të jetë plotësisht në përputhje me kornizën ekzistuese ligjore, dhe duhet të marrë parasysh planifikimin më të gjerë hapësinor dhe në veçanti planet kombëtare sektoriale dhe propozimet e PPV të përgatitura për Bashkinë.

Do të bëhet një analizë dhe vlerësim i situatës aktuale. Në më shumë detaje, studimi do të përfshijë:

- Kuadrin më të gjerë hapësinor dhe ligjor.
- Pasqyrimi i zonës së studimit (kufijtë e pronës, statusi i pronësisë) dhe caktimin e kufijve të zonës ekonomike.
- Përshkrim i detajuar i situatës aktuale të zonës e cila do të përfshijë:
 - Përdorime të tokës
 - Mënyrë për aksesin e zonës nga vendbanimet përreth
 - Infratrunktura inxhinierike ekzistuese
 - Situata e mjedisit dhe peisazhit dhe probleme që përballen
 - Eksplorim Gjeologjik: Të kontrollohet përshtatshmëria gjeologjike e zonës së studimit, me qëllim që të shënohet nëse toka është e përshtatshme, e papërshtatshme ose e përshtatshme nën disa kushte, me qëllim për të siguruar mjedis të strukturuar nga rreziqet natyrore ose rreziqet që vijnë nga ndërhyrjet dhe aktivitetet e njeriut.

Raporti teknik i studimit duhet të shoqërohet me tabelat e nevojshme dhe grafikët të cilët do të ilustronë elementet kryesore të analizës.

Baza kartografike do të përfshijë të paktën si më poshtë vijon:

- Harta të shkallës 1:500 deri 1:1.000, ku do të reflektohet situata aktuale, parcelat e tokës, përdorimet ekzistuese të tokës, ndërtesat dhe infrastruktura (rrjete të ujësjellësit, energjisë, rrugëve, etj.), kufijtë, përmasat dhe emërtimet. Këto harta do të shoqërohen edhe nga tabela kadastrale ku do të shënohet pronësia aktuale.
- Përveç kësaj do të dorëzohen edhe harta, në të cilat do të përshkruhen përshtatshmëria e tokës dhe gjendja ndërtesave ekzistuese.

Është e nevojshme që raportin teknik të shoqërohet edhe me analiza fotografike e zonës së studimit.

b) Strategjia e zhvillimit të zonës

Bazuar në analizën dhe vlerësimin e situatës aktuale dhe kuadrin të përgjithshëm të planifikimit në nivel kombëtar, është zhvilluar një strategji për organizimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të zonave turistike. Prioritet duhet t'i kushtohet sigurimit të aksesit dhe infrastrukturës teknike, ruajtjes së resurseve dhe metabolizmit ciklik në përgjithësi, respektimit të peisazhit dhe zhvillimit të një sërë aktiviteteve.

c) Propozime me përkufizime territoriale

Propozimet do të përfshijnë:

- Propozimet për përdorimet e propozuara të tokës dhe funksionet/aktivitete lejuara, të kushtezuara dhe ndaluara.
- Propozimet për infrastrukturën e nevojshme: rrjete rrugore, rrjete të furnizimit me ujë, rrjete të ndriçimit elektrik, sisteme të ujitjes së gjelbër, mbrojtja nga zjarri, etj.
- Propozimet për zona publike (p.sh. hapësira të gjelbërta, vendparkime). Shënohet se duhet të sigurohet qasje e barabartë dhe e pavarur për të gjithë.
- Vendndodhjet e propozuara të ndërtesave dhe vëllimet e tyre indikative.
- Mënyrat e zbatimit dhe instrumentet për drejtimin e zhvillimit.

d) Rregullorja ePDV-së

Në Rregullore do të duhet të përmbahet:

- Shpjegimet e kodeve që do të përdoren për kategoritë/nënkategoritë/funksionet e përdorimit të tokës, sistemet dhe kategori të tjera.
- Do të duhet të përcaktohen dhe analizohen kushtet dhe variablat e zhvillimit (p.sh. intensiteti, distancat, lartësia maksimale, etj.) dhe të vendosen vijat e ndërtimit.
- Rregullat e mbrojtjes së mjedisit dhe peizazhit, në mënyrë që të sigurohet se zhvillimi i propozuar nuk do të ndikojë negativisht.
- Të drejtat dhe kufizimet, siç ato burojnë nga kuadri i propozuar i zhvillimit.
- Rregullat për rrjetin rrugor dhe rrjetin e transportit.

Së fundi, do të duhet të ketë përdorim të lirë të ambienteve edhe nga persona me aftësi të kufizuara.

Harta dhe informacionin gjeohapësinor të integruar në platformën GIS (në përputhje me standardin e Regjistrimit Kombëtar të Planifikimit të Territorit).

e) Plani i Veprimit dhe Plani i Investimeve

Do të regjistrohet në një tabelë plani i veprimit të studimit që do të përfshijë projekte/veprime konkrete, me referencë koston e vlerësuar, burimet e financimit, diagramën kohore të zbatimit, dhe treguesit e vlerësimit/monitorimit.

Në përputhje me planin e veprimit do të hartohet plani i investimeve kapitale me kosto ndërtimi dhe operative për infrastrukturën e propozuar.

Afatet e punës dhe ndarja në faza

Afati kohor për zbatimin e PDV vlerësohet në 3 muaj dhe studimi do të hartohet në një fazë.

Vijon procesi i konsultimit që zgjat 1 muaj, gjatë të cilit paraqiten me çdo mënyrë të përshtatshme vërejtje dhe komente nga Bashkia, Qarku dhe të gjitha palët e interesuara, si dhe banorët e biznesmenët e Qarkut. Më pas, Autoriteti Kontraktor jep udhëzimet përfundimtare mbi përshtatjen e studimit dhe, brenda 20 ditëve nga paraqitja e tyre Kontraktues, bëhen dorëzimet përfundimtare, të printuara dhe digjitale. Pason procedura e miratimit, bazuar në legjislacionin aktual dhe publikimi në RKPT.

Profilat e Ekspertëve, kushtet dhe detyrat

Për hartimin e këtyre PDV-ve nevojitet një Grup Pune i përbërë nga të paktën këto ekspertë:

- Arkitekt/ Planifikues urban



- Inxhinier/ Ekspert transporti
- Inxhinier Ndërtimi
- Inxhinier Topograf
- Inxhinier Mjedisor

Konsulenti duhet të sigurojë një grup kompakt, me eksperiencë të ngjashme, i aftë në realizimin eficient të qëllimit të punës të këtyre Termave të Referencës.

Konsulenti duhet të dëshmojë:

- aftësi në adresimin e çështjeve kryesore nga një këndvështrim multi-disiplinor;
- njohje të mirë të territorit, veçanërisht të zonave rurale, dhe problematikave përkatëse.

Planet e Detajuara Vendore do të hartohen në bazë GIS, ndaj Konsulenti duhet të sigurojë dhe një njohje të mirë të programeve bazë dhe eksperiencë në punë të ngjashme.

Konsulenti, për një përshkrim më të mirë të qasjes ndaj kësaj detyre të shprehur në këto terma reference mund të paraqesë staf tjetër mbështetës gjatë fazës së Propozimit Teknik.

Përmbledhja e stafit duhet të japë të dhëna të detajuara në lidhje me numrin e personave që do të jenë të angazhuar për të hartuar çdo PDV dhe kohën që secili prej ekspertëve do të shpenzojë në këtë punë.



TERMAT E REFERENCËS për projektin «Qendër Kulturore në Pustec»

Hyrje

Kuadër kyç për zhvillimin e Bashkisë së Pustecit janë drejtimet e rigjenerimit urban dhe promovimi i rajonit. Bashkia ka një interes të veçantë, pasi gjithashtu përbën një total hapësinor me potencial të rëndësishëm zhvillimor në aspektin ekonomik, social dhe kulturor. Kultura njihet si një element i domosdoshëm për arritjen e objektivave strategjike të Bashkisë. Ajo është vendosur në qendër të politikave të zhvillimit të qëndrueshëm, pasi shoqëria e Bashkisë ka nevojë për një rishikim shoqëror me fokus qytetarët e saj.

Situata aktuale pasqyron pamundësinë për të nxjerrë në pah profilin kulturor të zonës, pasi objektet dhe aktivitetet shoqërore mungojnë. Në veçanti, qyteti Pustec është një qendër e rëndësishme lokale për shkak të karakterit të saj shumëdimensional dhe vendndodhjes së aktiviteteve dhe shërbimeve të rëndësishme për të gjithë Bashkinë. Rëndësia e një qendre kulturore është veçanërisht e rëndësishme për promovimin e trashëgimisë së rajonit dhe për forcimin e institucioneve dhe veprimeve shoqërore. Në këtë kontekst, për të forcuar multifunksionalitetin e Bashkisë, propozohet që në qytetin Pustec të organizohet një hapësirë kulturore. Në veçanti, qendra kulturore do të presë aktivitete që do të nxisin veprimin e komunitetit, duke rritur identitetin kulturor të rajonit.

Qëllimi i Studimit

Qëllimi i PDV është krijimi i ambienteve sociale ku do të strehohet qendra kulturore.

Nëpërmjet zhvillimit - organizimit të kësaj zone do të arrihet:

- Forcimi i krijimit artistik dhe intelektual
- Promovimi i aktiviteteve kulturore
- Promovimi dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore
- Krijimi i shërbimeve kulturore që duket se nuk janë të plota
- Sigurimi i të drejtave kulturore të qytetarëve



Rajoni i Studimit - Gjendja Aktuale



Figura 1. Ngritja e Qendres Kulturore dhe Tregut Ushqimor

Hapësira e krijimit dhe vendosjes së qendrës kulturore është rreth 0.25 Ha. Ajo është e vendosur në veri-lindje të qytetit të Pustecit, brenda zonës së ndërtuar ku do të strehohet tregu vendas. Trualli brenda kësaj zone në gjendjen aktuale i përket sistemit urban. Zona më e gjerë është kryesisht rezidenciale, me shumë banesa, pa ndonjë përdorim dhe shërbime të rëndësishme në rajonin më të gjerë. Ky pozicion është veçanërisht qendror për shkak të afërsisë me qendrën dhe frontin bregdetar. Në të njëjtën kohë, ajo përshkohet nga akse rrugore qendrore të qytetit.

Zhvillimi i saj do të jetë rezultat i iniciativës private dhe investimeve dhe do të përfshijë hapësira dhe infrastruktura publike dhe private.

Përmbajtja e studimit

a) Dokumenti për analizën e zonës

Studimi i PDV i një tregu lokal duhet të jetë plotësisht në përputhje me kornizën ekzistuese ligjore, dhe duhet të marrë parasysh planifikimin më të gjerë hapësinor dhe në veçanti planet kombëtare sektoriale dhe propozimet e PPV të përgatitura për Bashkinë.

Do të bëhet një analizë dhe vlerësim i situatës aktuale. Në më shumë detaje, studimi do të përfshijë:

- Kuadrin më të gjerë hapësinor dhe ligjor.
- Pasqyrimi i zonës së studimit (kufijtë e pronës, statusi i pronësisë) dhe caktimin e kufijve të zonës ekonomike.
- Përshkrim i detajuar i situatës aktuale të zonës e cila do të përfshijë:

- Përdorime të tokës
- Mënyrën e qasjes në zonë dhe në rajonin përreth
- Infrastrukturën aktuale teknike
- Situatën dhe gjendjen e mjedisit dhe peizazhit dhe problemet që përballen
- Eksplorim Gjeologjik: Të kontrollohet përshtatshmëria gjeologjike e zonës së studimit, me qëllim që të shënohet nëse toka është e përshtatshme, e papërshtatshme ose e përshtatshme nën disa kushte, me qëllim për të siguruar mjedis të strukturuar nga rreziqet natyrore ose rreziqet që vijnë nga ndërhyrjet dhe aktivitetet e njeriut.

Raporti teknik i studimit duhet të shoqërohet me tabelat e nevojshme dhe grafikët të cilët do të ilustrojnë elementet kryesore të analizës.

Baza kartografike do të përfshijë të paktën si më poshtë vijon:

- Harta të shkallës 1:500 deri 1:1.000, ku do të reflektohet situata aktuale, parcelat e tokës, përdorimet ekzistuese të tokës, ndërtesat dhe infrastruktura (rrjete të ujësjellësit, energjisë, rrugëve, etj), kufijtë, përmasat dhe emërtimet. Këto harta do të shoqërohen edhe nga tabela kadastrale ku do të shënohet pronësia aktuale.
- Përveç kësaj do të dorëzohen edhe harta, në të cilat do të përshkruhen përshtatshmëria e tokës dhe gjendja ndërtesave ekzistuese.

Është e nevojshme që raportin teknik të shoqërohet edhe me analiza fotografike e zonës së studimit.

b) Strategjia e zhvillimit të zonës

Bazuar në analizën dhe vlerësimin e situatës aktuale dhe kornizën gjithëpërfshirëse, formulohet strategjia për organizimin e qëndrueshëm dhe zhvillimin e poleve ekonomike. Theksi dhe prioriteti duhet t'i kushtohet sigurimit të aksesit dhe infrastrukturës teknike, kursimeve të burimeve dhe metabolizmit ciklik në përgjithësi, respektit për peizazhin dhe mundësisë së zhvillimit të një sërë aktiviteteve.

c) Propozime me përkufizime territoriale

Propozimet do të përfshijnë :

- Propozimet për përdorimet e propozuara të tokës dhe funksionet/aktivitete lejuara, të kushtezuara dhe ndaluara.
- Propozimet për infrastrukturën e nevojshme: rrjete rrugore, rrjete të furnizimit me ujë, rrjete të ndriçimit elektrik, sisteme të ujitjes së gjelbër, *πυροπροστασία*, etj.
- Propozimet për zona të përbashkëta (p.sh. hapësira të gjelbërta, vendparkime). Shënohet se duhet të sigurohet qasje e barabartë dhe e pavarur për të gjithë.
- Vendndodhjet e propozuara të ndërtesave dhe vëllimet e tyre indikative.
- Τρόπος εφαρμογής instrumentet për drejtimin e zhvillimit.

d) Rregullorja ePDV-së

Në Rregullore do të duhet të përmbahet:



- Shpjegimet e kodeve që do të përdoren për kategoritë/nënkategoritë/funksionet e përdorimit të tokës, sistemet dhe kategori të tjera.
- Do të duhet të përcaktohen dhe analizohen kushtet dhe variablat e zhvillimit (p.sh. intensiteti, distancat, lartësia maksimale, etj.) dhe të vendosen vijat e ndërtimit.
- Rregullat e mbrojtjes së mjedisit dhe peizazhit, në mënyrë që të sigurohet se zhvillimi i propozuar nuk do të ndikojë negativisht.
- Të drejtat dhe kufizimet, siç ato burojnë nga kuadri i propozuar i zhvillimit.
- Rregullat për rrjetin rrugor dhe rrjetin e transportit.

Së fundi, do të duhet të ketë përdorim të lirë të ambienteve edhe nga persona me aftësi të kufizuara.

Harta dhe informacionin gjeohapësinor të integruar në platformën GIS (në përputhje me standardin e Regjistrat Kombëtar të Planifikimit të Territorit).

e) Plani i Veprimit dhe Plani i Investimeve

Do të regjistrohet në një tabelë plani i veprimit të studimit që do të përfshijë projekte/veprime konkrete, me referencë koston e vlerësuar, burimet e financimit, diagramën kohore të zbatimit, dhe treguesit e vlerësimit/monitorimit.

Në përputhje me planin e veprimit do të hartohet plani i investimeve kapitale me kosto ndërtimi dhe operative për infrastrukturën e propozuar.

Afatet e punës dhe ndarja në faza

Afati kohor për zbatimin e PDV vlerësohet në 3 muaj dhe studimi do të hartohet në një fazë. Vijon procesi i konsultimit që zgjat 1 muaj, gjatë të cilit paraqiten me çdo mënyrë të përshtatshme vërejtje dhe komente nga Bashkia, Qarku dhe të gjitha palët e interesuara, si dhe banorët e biznesmenët e Qarkut. Më pas, Autoriteti Kontraktor jep udhëzimet përfundimtare mbi përshtatjen e studimit dhe, brenda 20 ditëve nga paraqitja e tyre Kontraktues, bëhen dorëzimet përfundimtare, të printuara dhe digjitale. Pason procedura e miratimit, bazuar në legjislacionin aktual dhe publikimi në RKPT.

Profilat e Ekspertëve, kushtet dhe detyrat

Për hartimin e këtyre PDV-ve nevojitet një Grup Punë i përbërë nga të paktën këto ekspertë:

- Arkitekt/ Planifikues urban
- Inxhinier/ Ekspert transporti
- Inxhinier Ndërtimi
- Inxhinier Topograf
- Inxhinier Mjedisor

Konsulenti duhet të sigurojë një grup kompakt, me eksperiencë të ngjashme, i aftë në realizimin eficient të qëllimit të punës të këtyre Termave të Referencës.

Konsulenti duhet të dëshmojë:

- aftësi në adresimin e çështjeve kryesore nga një këndvështrim multi-disiplinor;
- njohje të mirë të territorit, veçanërisht të zonave rurale, dhe problematikave përkatëse.



Planet e Detajuara Vendore do të hartohen në bazë GIS, ndaj Konsulenti duhet të sigurojë dhe një njohje të mirë të programeve bazë dhe eksperiencë në punë të ngjashme.

Konsulenti, për një përshkrim më të mirë të qasjes ndaj kësaj detyre të shprehur në këto terma reference mund të paraqesë staf tjetër mbështetës gjatë fazës së Propozimit Teknik.

Përmbledhja e stafit duhet të japë të dhëna të detajuara në lidhje me numrin e personave që do të jenë të angazhuar për të hartuar çdo PDV dhe kohën që secili prej ekspertëve do të shpenzojë në këtë punë.



TERMAT E REFERENCËS për studimin «Tregu e produkteve vendore në Pustec»

Hyrje

Sektori agro-ushqimor është një sektor me mundësi të mëdha për zhvillim në Bashkinë e Pustecit. Ai mund të ndihmojë në rritjen e të ardhurave lokale dhe në formësimin e një identitet të ri dhe të fortë. Gjithashtu, vlerësohet se përmes zhvillimit dhe promovimit të këtij sektori do të promovohet zhvillimi i sektorit primar. Së fundi, një nga objektivat strategjike të Bashkisë sipas PPV është ngritja ekonomike dhe bujqësore e zonës.

Në veçanti, qyteti i Pustecit është një qendër e rëndësishme lokale për shkak të karakterit të tij shumëdimensional dhe vendndodhjes së aktiviteteve dhe shërbimeve të rëndësishme në të gjithë bashkinë. Rëndësia e një tregu lokal është shumë vendimtare si për sipërmarrjen, ashtu edhe për promovimin e tipareve lokale të një zone në kombinim me zhvillimin e zonave rurale. Në këtë kontekst, një treg lokal është instrumenti që do të kontribuojë në zhvillimin e fshatrave si dhe të ekonomisë lokale. Për të nxjerrë në pah avantazhet konkurruese të bashkisë dhe rritjen e shumë funksionimit të saj propozohet organizimi i infrastrukturës së operacioneve tregtare dhe ekonomike përmes përcaktimit të një zone tregtare, e cila do të përfshijë tregun lokal.

Qëllimi i Studimit

Qëllimi i PDV është krijimi i një zone tregtare të organizuar dhe funksionale, e cila do të përqendrohet në produktet lokale. Kompanitë vendore të produkteve luajnë një rol të rëndësishëm për zhvillimin lokal, i cili nxitet dhe forcohet nga mbështetja e komunitetit lokal.

Përmes zhvillimit - organizimit të kësaj zone do të arrihet:

- promovimi i prodhimeve vendore
- Zbatimi i aktiviteteve të marketingut
- promovimi dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore
- krijimi i shërbimeve kulturore që paraqiten me mangësi
- krijimi i një marke tregtare
- krijimi i vendeve të reja të punës



Rajoni i Studimit- Gjendja Aktuale



Figura 1. Ngritja e Qendres Kulturore dhe Tregut Ushqimor

Zona e vendosjes së tregut ka një sipërfaqe prej rreth 0.25 Ha. Ajo gjendet e vendosur në veri-lindje të qytetit të Pustecit, brenda zonës me ndërtime. Trualloi brenda kësaj zone në gjendjen aktuale i përkasin sistemit urban. Zona më e gjerë është kryesisht rezidenciale, me shumë banesa, pa ndonjë përdorim dhe shërbime të rëndësishme në rajonin më të gjerë. Ky pozicion është veçanërisht kyç për shkak të afërsisë si në drejtim të qendrës ashtu edhe frontit bregdetar. Në të njëjtën kohë, ajo përshkohet edhe nga akse rrugore qendrore të qytetit.

Zhvillimi do të jetë rezultat i iniciativës private dhe investimeve dhe do të përfshijë hapësira dhe infrastruktura publike dhe private.

Përmbajtja e studimit

a) Dokumenti për analizën e zonës

Studimi i PDV i një tregu lokal duhet të jetë plotësisht në përputhje me kornizën ekzistuese ligjore, dhe duhet të marrë parasysh planifikimin më të gjerë hapësinor dhe në veçanti planet kombëtare sektoriale dhe propozimet e PPV të përgatitura për Bashkinë.

Do të bëhet një analizë dhe vlerësim i situatës aktuale. Në më shumë detaje, studimi do të përfshijë:

- Kuadrin më të gjerë hapësinor dhe ligjor.
- Pasqyrimi i zonës së studimit (kufijtë e pronës, statusi i pronësisë) dhe caktimin e kufijve të zonës ekonomike.
- Përshkrim i detajuar i situatës aktuale të zonës e cila do të përfshijë:
 - Përdorime të tokës
 - Mënyra e qasjes në këtë zonë dhe në mjedisin përreth



- Infrastruktura aktuale teknike
- Gjendja e mjedisit dhe peisazhit dhe problemet që shfaqen
- Eksplorim Gjeologjik: Të kontrollohet përshtatshmëria gjeologjike e zonës së studimit, me qëllim që të shënohet nëse toka është e përshtatshme, e papërshtatshme ose e përshtatshme nën disa kushte , me qëllim për të siguruar mjedis të strukturuar nga rreziqet natyrore ose rreziqet që vijnë nga ndërhyrjet dhe aktivitetet e njeriut.

Raporti teknik i studimit duhet të shoqërohet me tabelat e nevojshme dhe grafikët të cilët do të ilustrojnë elementet kryesore të analizës.

Baza kartografike do të përfshijë të paktën si më poshtë vijon:

- Harta të shkallës 1:500 deri 1:1.000, ku do të reflektohet situata aktuale, parcelat e tokës, përdorimet ekzistuese të tokës, ndërtesat dhe infrastruktura (rrjete të ujësjellësit, energjisë, rrugëve, etj), kufijtë, përmasat dhe emërtimet. Këto harta do të shoqërohen edhe nga tabela kadastrale ku do të shënohet pronësia aktuale.
- Përveç kësaj do të dorëzohen edhe harta, në të cilat do të përshkruhen përshtatshmëria e tokës dhe gjendja ndërtesave ekzistuese.

Është e nevojshme që raportin teknik të shoqërohet edhe me analiza fotografike e zonës së studimit.

b) Strategjia e zhvillimit të zonës

Bazuar në analizën dhe vlerësimin e situatës aktuale dhe në kornizën gjithëpërfshirëse, formulohet strategjia për organizimin e qëndrueshëm dhe zhvillimin e poleve ekonomike. Theksi dhe prioriteti duhet t'i kushtohet sigurimit të qasjes dhe infrastrukturës teknike, kursimeve të burimeve dhe metabolizmit ciklik në përgjithësi, respektit për peizazhin dhe mundësisë së zhvillimit të një sërë aktiviteteve.

c) Propozime me përkufizime territoriale

Propozimet do të përfshijnë:

- Propozimet për përdorimet e propozuara të tokës dhe funksionet/aktivitete lejuara, të kushtezuara dhe ndaluara.
- Propozimet për infrastrukturën e nevojshme: rrjete rrugore, rrjete të furnizimit me ujë, rrjete të ndriçimit elektrik, sisteme të ujitjes së gjelbër, πυροπροστασία, etj.
- Propozimet për zona të përbashkëta (p.sh. hapësira të gjelbërta, vendparkime). Shënohet se duhet të sigurohet qasje e barabartë dhe e pavarur për të gjithë.
- Vendndodhjet e propozuara të ndërtesave dhe vëllimet e tyre indikative.
- Mënyra e aplikimit të instrumenteve për drejtimin e zhvillimit.

d) Rregullorja ePDV-së

Në Rregullore do të duhet të përmbahet:

- Shpjegimet e kodeve që do të përdoren për kategoritë/nënkategoritë/funksionet e përdorimit të tokës, sistemet dhe kategori të tjera.



- Do të duhet të përcaktohen dhe analizohen kushtet dhe variablat e zhvillimit (p.sh. intensiteti, distancat, lartësia maksimale, etj.) dhe të vendosen vijat e ndërtimit.
- Rregullat e mbrojtjes së mjedisit dhe peizazhit, në mënyrë që të sigurohet se zhvillimi i propozuar nuk do të ndikojë negativisht.
- Të drejtat dhe kufizimet, siç ato burojnë nga kuadri i propozuar i zhvillimit.
- Rregullat për rrjetin rrugor dhe rrjetin e transportit.

Së fundi, do të duhet të ketë përdorim të lirë të ambienteve edhe nga persona me aftësi të kufizuara.

Harta dhe informacionin gjeohapësinor të integruar në platformën GIS (në përputhje me standardin e Regjistrat Kombëtar të Planifikimit të Territorit).

e) Plani i Veprimit dhe Plani i Investimeve

Do të regjistrohet në një tabelë plani i veprimit të studimit që do të përfshijë projekte/veprime konkrete, me referencë koston e vlerësuar, burimet e financimit, diagramën kohore të zbatimit, dhe treguesit e vlerësimit/monitorimit.

Në përputhje me planin e veprimit do të hartohet plani i investimeve kapitale me kosto ndërtimi dhe operative për infrastrukturën e propozuar.

Afatet e punës dhe ndarja në faza

Afati kohor për zbatimin e PDV vlerësohet në 3 muaj dhe studimi do të hartohet në një fazë. Vijon procesi i konsultimit që zgjat 1 muaj, gjatë të cilit paraqiten me çdo mënyrë të përshtatshme vërejtje dhe komente nga Bashkia, Qarku dhe të gjitha palët e interesuara, si dhe banorët e biznesmenët e Qarkut. Më pas, Autoriteti Kontraktor jep udhëzimet përfundimtare mbi përshtatjen e studimit dhe, brenda 20 ditëve nga paraqitja e tyre Kontraktues, bëhen dorëzimet përfundimtare, të printuara dhe digjitale. Pason procedura e miratimit, bazuar në legjislacionin aktual dhe publikimi në RKPT.

Profilat e Ekspertive, kushtet dhe detyrat

Për hartimin e këtyre PDV-ve nevojitet një Grup Pune i përbërë nga të paktën këto ekspertë:

- Arkitekt/ Planifikues urban
- Inxhinier/ Ekspert transporti
- Inxhinier Ndërtimi
- Inxhinier Topograf
- Inxhinier Mjedisor

Konsulenti duhet të sigurojë një grup kompakt, me eksperiencë të ngjashme, i aftë në realizimin eficient të qëllimit të punës të këtyre Termave të Referencës.

Konsulenti duhet të dëshmojë:

- aftësi në adresimin e çështjeve kryesore nga një këndvështrim multi-disiplinor;
- njohje të mirë të territorit, veçanërisht të zonave rurale, dhe problematikave përkatëse.

Planet e Detajuara Vendore do të hartohen në bazë GIS, ndaj Konsulenti duhet të sigurojë dhe një njohje të mirë të programeve bazë dhe eksperiencë në punë të ngjashme.



Konsulenti, për një përshkrim më të mirë të qasjes ndaj kësaj detyre të shprehur në këto terma reference mund të paraqesë staf tjetër mbështetës gjatë fazës së Propozimit Teknik.

Përmbledhja e stafit duhet të japë të dhëna të detajuara në lidhje me numrin e personave që do të jenë të angazhuar për të hartuar çdo PDV dhe kohën që secili prej ekspertëve do të shpenzojë në këtë punë.



3. RAPORTI I DËGJESËS PUBLIKE

Bashkia e Pustecit më datë 12.04.2019 në orën 13:00, realizoi dëgjesën e III-të publike, ku u prezantuan dokumentet e “Harimit të Planit të Përgjithsëm Vendor”, për të cilin pjesëmarrës ishin stafi i bashkisë dhe më konkretisht z. Edmond Themelko – Kryetar Bashkie, Përfaqësues të tjerë të Bashkisë. Përfaqësues nga studio “GAIA SA Meleton” ishin si në vijim Georgios Bellas, Zv Drejtor Ekzekutiv, Elton Toska, Manaxher Vendor i Projektit, Elena Petsani, Urbaniste dhe Evgjenia Karanasiopoulou, Inxh. Gjeologe. Pjesëmarrës të tjerë në dëgjesë ishin: fermerë, përfaqësues biznesesh, përfaqësues të OJF-ve të ndryshme, ekspertë të fushave të ndryshme, etj. Në vijim, z. Elton Toska prezantoi të pranishmit në panel dhe znj. Elena Petsani prezantoi rendin e ditës si më poshtë:

- Faza III-te - Plani i Zhvillimit dhe Rregullorja e Planit
- Vizioni
- Objektiva Strategjike
- Zonat me rëndësi kombëtare
- Zonat me rëndësi ekonomike
- Planifikimi i territorit në sisteme territoriale, zona dhe njësi
- Rregullat e zhvillimit për qendrën e Bashkisë dhe të gjithë territorin e saj
- Projektet sipas sektorit
- Projektet- rigjenerim & sistemim urbane
- Projektet Pilot

Me vijim të prezantimit u hap diskutimi me publikun, ku u shprehën mendime, sugjerime dhe komente në lidhje me prezantimin e Fazës së III-të për PPV të Bashkisë Pustec. Në vijim gjatë diskutimit u ngritën kryesisht sugjerime si më poshtë.

- Lidhja ujore ne Liqenin e Prespes të Madhe midis tre Shteteve qe preken nga ky liqen.
- Permireshimi dhe rikonstruksioni i infrastruktures vaditëse në tokat bujqësore të Bashkisë.
- Hartimi i një studimi për mbrojtjen e biodiversitetit të Parkut Kombëtar të Prespës.
- Nëse disa nga propozimet e Planit mundet të integrohen edhe në Planin e Menaxhimit të Parkut Kombëtar të Prespës, pasi ka ardhur koha per rishikimit e tij.

Për lidhjen midis Bashkisë të Pustecit dhe Greqisë me një pike doganore në Cerje. Për hartimin e PPV për bashkinë e Pustecit janë marrë parasysh parashikimet e Planit të Menaxhimit si dhe të gjitha projektet janë adomoduar tek zonat e lejuara për zhvillime. Të gjitha propozimet nga konsultimi do të merren parasysh dhe do te propozohen projekte gjatë fazës të III-të në të cilën finalizohet dhe lista e projekteve të propozuara për zhvillimin e integruar dhe qendrushëm të bashkisë.





Foto 1: Pjesëmarrje në degjësën publike e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Pustec, datë 12.04.2019, prezantimi i materialit të fazës së III-të



Dëgjesa Publike III-të					
Hartimi i Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë e Pustecit					
Bashkia Pustec					
Nr. Rendor	Emri	Mbledhëri	Institution/Profesion	Email	Telefon
1.	Ilioni	Deziner	Trutari, b.djshce shpirtore/almu	ilioni.pustec@pshq.com	+355 68 28 22 26
2.	Ornelo	Deziner	Pjest. Projektim Dnyla	Ornelo.pustec@pshq.com	068 24 39 599
3.	Ilion Kocaj		Udhëzues teknik	ilion.kocaj@pshq.com	068 24 39 686
4.	Elvira Çauq	Çauq	Udhëzues teknik	elvira.cauq@pshq.com	068 24 39 686
5.	Ilion Kocaj		Udhëzues teknik	ilion.kocaj@pshq.com	068 24 39 686
6.	Ilion Kocaj		Udhëzues teknik	ilion.kocaj@pshq.com	068 24 39 686
7.	Ilion Kocaj		Udhëzues teknik	ilion.kocaj@pshq.com	068 24 39 686
8.	Ilion Kocaj		Udhëzues teknik	ilion.kocaj@pshq.com	068 24 39 686
9.	Ilion Kocaj		Udhëzues teknik	ilion.kocaj@pshq.com	068 24 39 686
10.	Ilion Kocaj		Udhëzues teknik	ilion.kocaj@pshq.com	068 24 39 686
11.	Ilion Kocaj		Udhëzues teknik	ilion.kocaj@pshq.com	068 24 39 686
12.	Ilion Kocaj		Udhëzues teknik	ilion.kocaj@pshq.com	068 24 39 686
13.	Ilion Kocaj		Udhëzues teknik	ilion.kocaj@pshq.com	068 24 39 686
14.	Ilion Kocaj		Udhëzues teknik	ilion.kocaj@pshq.com	068 24 39 686
15.	Ilion Kocaj		Udhëzues teknik	ilion.kocaj@pshq.com	068 24 39 686
16.	Ilion Kocaj		Udhëzues teknik	ilion.kocaj@pshq.com	068 24 39 686
17.	Ilion Kocaj		Udhëzues teknik	ilion.kocaj@pshq.com	068 24 39 686
18.	Ilion Kocaj		Udhëzues teknik	ilion.kocaj@pshq.com	068 24 39 686
19.	Ilion Kocaj		Udhëzues teknik	ilion.kocaj@pshq.com	068 24 39 686
20.	Ilion Kocaj		Udhëzues teknik	ilion.kocaj@pshq.com	068 24 39 686
21.	Ilion Kocaj		Udhëzues teknik	ilion.kocaj@pshq.com	068 24 39 686
22.	Ilion Kocaj		Udhëzues teknik	ilion.kocaj@pshq.com	068 24 39 686
23.	Ilion Kocaj		Udhëzues teknik	ilion.kocaj@pshq.com	068 24 39 686
24.	Ilion Kocaj		Udhëzues teknik	ilion.kocaj@pshq.com	068 24 39 686
25.	Ilion Kocaj		Udhëzues teknik	ilion.kocaj@pshq.com	068 24 39 686

Foto 2: Listpresenca për pjesëmarrje në degjësën publike e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Pustec, datë 12.04.2019, prezantimi i materialit të fazës së III-të



4. RAPORTI I FORUMIT I BASHKËRENDIMIT PËR PLANIFIKIMIN NË NIVEL VENDOR

TAKIMI I DYTË NË KUADËR TË HARTIMIT TË PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR, BASHKITË: MALIQ, DEVOLL, PUSTEC

Referuar VKM-së Nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit" e ndryshuar, sipas VKM nr. 232, dt. 17.04.2019, Neni 2 përcakton se: "Forumi për bashkërendimin e planifikimit" është një mekanizëm për të nxitur diskutimet strategjike të përfaqësuesve: të autoritetit përgjegjës për hartimin e dokumentit të planifikimit, pushtetit vendor, pushtetit qendror dhe ekspertëve; për të arritur koordinimin e çështjeve të planifikimit për një zonë, njësi vendore, rajon apo territorin në përgjithësi". Forumi nuk është entitet vendimmarrës, miratues apo zgjidhës i konflikteve. Forumi për Bashkërendimin e Planifikimit Vendor konstituohet pas ndërmarrjes së nismës për hartimin e dokumentit të planifikimit vendor, me urdhër të drejtorit të Agjencisë.

FBPV-ja drejtohet nga drejtuesi i Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit dhe përbëhet nga drejtuesi i organit përgjegjës për planifikimin në njësinë vendore që ka ndërmarrë nismën, përfaqësuesi planifikues i bashkive kufitare dhe përfaqësuesi planifikues i qarkut. Sipas rastit, FBPV-ja mund të ketë në përbërjen e tij edhe përfaqësues të grupeve të interesit.

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit më datë 09.04.2019 (ditën e martë), në orën 12:30, realizoi takimin e FBPV ku u diskutua mbi Planin e Zhvillimit dhe Rregulloren Lokale të bashkive: Maliq, Devoll, Pustec. Pjesëmarrësit në takimin e FBPV-së:

- Stafi i AKPT-së
 - Fiona Mali – Drejtore e Planifikimit Vendor;
 - Malvina Ferra – K/Kordinatore;
 - Ermal Pashollari – Koordinator;
 - Ridiena Sulaj
- Stafi i Bashkive:
 - Remzi Kutrolli – Koordinator projektsh, Bashkia Devoll;
 - Kostika Qazolli –Urbanist DPKZHT, Bashkia Maliq;
 - Vaska Argjiri – Specialist DPKZHT, Bashkia Pustec.
- Stafi i Bashkive Kufitare:
 - Zhaneta Lubonja – Drejtor DPKZHT, Bashkia Korçë;
- Stafi i Ekipit Konsulent:
 - Jorgo Bellas – Drejtues grupi, GAIA;
 - Elena Petsani – Planifikuese urbane, GAIA;
 - Elton Toska – Menaxher lokal i projektit, GAIA;
 - Diana Bardhi - Kordinatore, GAIA;

• Përfaqësues nga institucione të tjera:

- Olisa Ndrecka – specialiste, MIE;
- Ela Bodi – specialiste, MIE;



- Anesti Teneqexhi – Specialist Urbanistike, Qarku i Korçës;
- Guri Seferi – Ekspert i jashtëm, për projektin 100 Fshatrat, që janë pjesë e bashkive;
- Rexhina Merkohitaj – Praktikante, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
- Emanuela Sulaj – Praktikante, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
- Almin Hoxhaj – Specialist, ARRSH;
- Eduart Cani – projekti CSBL, GIZ.

Rreth takimit të FBPV:

Hapjen e takimit e bëri Drejtoresha e Planifikimit Vendor, AKPT, Znj. Fiona Mali duke theksuar shkurtimisht rëndësinë dhe arsyet e organizimit të Forumit për Bashkërendimin e Planifikimit në Nivel Vendor. Më pas u vijua me prezantimin e studios konsulente për bashkitë e Lot 3 – Maliq, Pustec dhe Devoll.

Prezantimi i PPV Maliq, Pustec dhe Devoll

Prezantimi u bë nga Z. Jorgo Bellas, i cili fillimisht bëri një përmbledhje të propozimeve specifike për bashkitë Maliq, Pustec dhe Devoll sipas temave respektive të përgjithshme të mëposhtme:

- Profilet e bashkive;
- Përkthimi i vizionit për secilën bashki në objektiva dhe strategji;
- Zhvillimet e propozuara për secilën bashki në aspektin e infrastrukturës, ekonomisë dhe turizmit;
- Përdorimi i tokës i propozuar për të tre bashkitë;

Duke u fokusuar në disa aspekte kryesore për secilën bashki:

- Për bashkinë e Devollit u vendos theksi në prezencën e Zonave të Mbrojtura që ndodhen në territorin e bashkisë, për mbrojtjen dhe konsolidimin e tokave bujqësore, për mungesën e tendencave të zhvillimeve të reja kryesisht në qytetin e Bilishtit por edhe në zonat rurale si edhe për zonat buferike përreth trupave ujorë;
- Për bashkinë e Maliqit u vendos theksi në propozimet për zhvillimin e turizmit, mbrojtjen dhe konsolidimin e tokave bujqësore, prezencën dhe ndikimin e aksit rrugor Korçë – Pogradec dhe rëndësia e lidhjes me bashkinë e Gramshit, krijimi i liqenit artificial të Moglicës nga ndërtimi i digës, në vitet në vijim;
- Për bashkinë e Pustecit u vendos theksi në nxitjen e zhvillimit të turizmit në të gjithë bashkinë, ruajtjen e karakterit “të gjelbër” dhe ekologjike të bashkisë, praninë e zonave të mbrojtura, nevoja për krijimin e një aksi rrugor i cili lidh liqenin e Prespës si edhe për investimet në të gjithë fushat e tjera të infrastrukturave, nxitjen e zhvillimit të aktiviteteve kulturore dhe sociale, etj.

Diskutim mbi PPV Maliq, Pustec dhe Devoll

Diskutimi i kryer u zhvillua në mënyrë të përgjithshme për të gjithë bashkitë duke u përqëndruar në pikat si më poshtë:

Z. Guri Seferi:

Z. Seferi u shpreh se bashkia e Devollit dallohet për potencialet e larta që ajo ka për kultivimin e bimëve



medicinale dhe etero-vajore, potencial i cili duhet të dalë edhe nga Plani në formën e një industrie të lehtë agropërpunuese. Gjithashtu një aspekt tjetër i rëndësishëm, i nevojshëm për të nxitur zhvillimin e bashkisë Devoll, është edhe përmirësimi i infrastrukturës së transportit dhe kryesisht: krijimi i një unaze për fshatrat Dardhë (Korçë) – Arrzë – Miras si edhe krijimi i një lidhjeje me Greqinë, në zonën e Gramozit.

Qarku Korçë:

Prezenca e një pjese të malit të Moravës në territorin e bashkisë Devoll shikohet me rëndësi të lartë për zhvillimin e turizmit në zonë. Edhe me bashkinë e Korçës po punohet për promovimin e këtij elementi si një destinacion të vetëm dhe unik, pa kufij bashkiak, duke përforcuar në këtë mënyrë edhe ndërveprimin nëpërmjet dy bashkive.

Bashkia Devoll:

Bashkia e Devollit e shikon gjithë zonën e liqenit të Prespës së Vogël si një destinacion unik, duke theksuar se është shumë i rëndësishëm bashkëpunimi me bashkitë kufitare të shteteve fqinje si: Greqia dhe Maqedonia e Veriut. Një rëndësi shumë e veçantë në plan duhet t'i kushtohet zhvillimit të turizmit dhe sporteve ujore. Gjithashtu bashkia e Devollit shikon me prioritet mënyrën e zonimit të qytetit të Bilishtit në kuadrin e përdorimit të tokës, duke propozuar që zona buferike nga lumi i Devollit në kufirin urban të qytetit të kthehet në një zonë argëtimi dhe jo urbane apo shërbime.

AKPT:

Përreth liqeneve të Prespës së Madhe dhe Prespës së Vogël duhet të piketohen ato qendra të banuara të cilat mund të furnizojnë me shërbime dhe të shërbejnë si pole mbështetëse për turizmin. Nga ana e kompanisë konsulente u argumentua se në bashkinë e Devollit, si pole të tilla funksionojnë fshatrat Tren dhe Zagradec të cilët kanë edhe lidhje të mirë me qytetin e Bilishtit. Përsa i përket bashkisë së Pustecit, si pol i tillë shërben fshati Zaroshkë, i cili është i përshatshëm edhe për krijimin e plazheve publike. Znj. Mali gjithashtu propozoi për bashkitë Devoll dhe Pustec, për Zonat e Mbrojtura, krijimin e itinerareve dhe akseve rrugore ekologjike dhe të paasfaltuara për të patur një impakt më të ulët në mjedis.

Ky propozim u argumentua nga kompania konsulente se në kushtet klimaterike në të cilat ndodhen bashkitë në fjalë, nuk janë të përshatshme këto lloj rrugësh dhe gjithashtu kanë një kosto të lartë mirëmbajtjeje.

AKZM:

Përfaqësuesi i Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, u shpreh se Parku i Prespës është i pajisur me një Plan Menaxhimi, i cili duhet të respektohet gjatë zonimit të bashkisë si edhe në përdorimet e lejuara dhe të ndaluara të tokës. Gjithashtu në territorin e bashkisë Maliq, ndodhet Pylli i Fazanëve, për të cilin z. Xhepa u shpreh se mund të jetë me vlerë edhe një propozim për futjen e tij në Rrjetin e Zonave të Mbrojtura, duke u kthyer në Park Natyror.

GIZ, projekti CSBL:

Përfaqësuesi i projektit CSBL, të GIZ, i cili është i fokusuar në territorin e bashkisë Pustec, në Parkun e Prespës, u shpreh se edhe zhvillimet e propozuara nga kompania konsulente dhe bashkia, të cilat e shikojnë bashkinë e Pustecit si një bashki "të gjelbër" dhe me zhvillim të ulët dhe sa më miqësore ndaj



mjedisit, vjen në harmoni edhe me parimet e programit CSBL. Në vijim të dy palët do të qëndrojnë në kontakt për shkëmbime të mëtejshme të materialeve deri në finalizimin e planit.



Foto 1: Takimi i dytë i FBPV më 09.04.2019 në kuadër të hartimit PPV për bashkitë Maliq, Devoll, Pustec.

